[23]

PARKALESE PRË MENATEN

THEOSIT

Nd' ëmërë të së Jatit, të Birit e të Shpirtit Shëjt. Amin.

Zot' īmë, Theòs īmë, u kamë bes të gjëndemi përpara tij. Andaj të adhoronjë e të thōmë se të dua mīrë me gjith zëmërën time. Të hiripsinjë[5] se më kriose e më bëre të krështē, se më mbajte dōrën sipërë e më lē i shëndoshëm e i tërë ndë ktë nat e bën' e arrura të shihnja dritën e rē të ksaj dit. Të hiripsinjë edhe prë të tjerat mīrëbëme çë pata ka dora jote ndë gjith motin e gjelljes time.

Nani të shtronjë përpara mbaru sa të mund kenë qënë o të jenë bënat time e kamë penxërë e ënda të ghadhënjenjë sa më ndulëxhenxje mundinjë e të i bënjë pjes shpirtëravet çë lëngonjin ndë purghatuorin. U të truhemi të më japçë [24] hirën të mos të t' fëtesinjë më kurraj e mbi gjith prana ndë ktë dit.

PRA THUA

Ini Jatë çë jē ndë qiell, shëjtëruorë qoftë ëmëri it, ardhëtë rregjëria jote, qoft' e bërë duania jote si mbë qiell ashtu ndë dhē. Bukën tënë ditullore ëmna sod neve, ndële neve dëtirëtë tona, porsi na ndëlenjëmi dëtirëmit tënë. Mos na le mbë tendacjōn, keqashit lefterojna. Amin.

Agëzuosh, o Marie, çë me hirë e pjono jē. Inë Zot ẽ me tij. E bekuome jē ti ndë gjith grā e bekuome ësht Pema e barkut tënd, Jesui. Shëjte Mari, jëm e Theosit, parkales prë nē të mbëkatëruomit, nani e ndë herën e të vëdeqes tënë. Amin.

Kamë bes mbë Theosin, Jatë i fōrëmadh, çë kriosi qiellin e dhenë, e mbë Jesu Krishtin, Birin të së tij, cili qe konxhipisurë prë bëme e urtërī të Shpirtit Shëjt. U lē ka Mëria Virgjërë. Dhuroi ndën Ponx Pillathin. Qe i ngriqurë, vëdiq e qe varrisurë. U zdhrip ndë pis, të tretën dit u ngjallë ka të vëdekurit. U hip ndë qiell, ulet tek e djathta e të Jatit fōrëmadh. [25] Prana kā të vinjë të judhikonjë të gjallëtë e të vëdekurit. Kamë bes ndë Shpirtin Shëjt, mbë shëjten Qish kathóllike, mbë bashkërīnë e shëjtevet, mbë ndëlemën e mbëkatëvet, të ngjallturën e gjithvet, gjellën të paserposëme. Amin.

Ëngjëll' i Theosit, çë inë Zot më të dha po të më ruonje, tas çë ai pati aq lipisī prë mua, truhemi[6] edhe tij çë, prë nderë të fixit çë të qe dhënë, marrëçë ti të më ndritsh, të më ruoç, të më dreqtoç, të më pastroç e të më mbāç pa kondra mbëkatashi. Amin.

Agëzuosh, o Rregjëresh, Jëm lipisie, ëmbëlësia e gjelljes, ellpiza jonë, agëzuosh. Na, të shkret bil t' Evsë, tij thërresëmi, mbë tij shërtonjëmi tue rëkuorë e tuke qārë ndë ktë llak lotëshi. Andaj poka ti,

[5] hiripsinjë] hirispsinjë.
[6] truhemi] truheme.

o ndihorja jonë, prīrë mbë nē ato lipisjare tënde sī e Jesun, bekuome pemë të barkut tënd, neve, pas këtij eksīllë, bufto, o lipisjare, o e urëtë, o je ëmbël Virgjërë Marie. Amin.

Bëmë hirë, e Virgjërë e shëjtëruome, të mund laudhofça tij ndë gjith gjellën time. Ëm pather fuqī e virtut kundër' armiqvet tënd. Amin.

Qoft' i bekuorë, laudhuorë e hiripsurë inë Zot Theosi, mbë [26] gjith shëjtit e tij. Amin.

Këtu thua Kumanduomet e Nomit të tinë Zoti e të së shëjtes Qish, po si gjënden të shkruojtura tek serposëma e këtij livëri, prana

Parkalesën

Zot' imë, bëmë hirin të kemë bes, të ellpizonjë mbë tij e të të dua mirë me gjith zëmërën time. Madh, rrit e dhez mbë mua besën, ellpizën e karitatën e bëj të kemë dhëmbime të madhe, të gialle e të vërtetëme fëtesashit e të të taksinjë pa ndërruome të mos mbëkatëronemi mẽ. Ëm hirën edhe çë u mund të lusëça po si të nget e lemë të qasemi pather mbë Shëjtet Sakramende, po si perqet[7] një krështeu i dreqtë e i mirë.

Qoft' e bekuorë Virgjëra Marie, cila qe konxhipisurë pa mosnjë mbëkat. Amin.

PARKALESE

prë shërbiset ndrishe çë mund bënjë i krështeu mbrënda ndë dit

Përpara të vëhet të shërbenjë, thot

Zot' imë, dërgo bekuomen tënde mbi këto shërbeme çë marr u t' i bënjë me ndihmen të duanies tënde. Amin. [27]

Parë të vëhet[8] të harë

Zoti Theos, jip bekuomen tënde këtij të ngrëni çë u marr po të mbahemi mbë fuqīnë çë më lipset prë të ruomen e gjelljes e prë shërbemen e Zotrësate.

Pas ngrëni

Zot, të hiripsinjë prë të ngrënëtë çë më dhe e të parkalesinjë të bëç të më siell shëndetën të Shpirtit të kurmit.

[7] perqet. Cattiva lettura dell'albanese *përket*.
[8] *vëhet] vuhet.*

Kurë çë shokëronet Sakramendi ndonjë të i sëmūrmi

Jip, o[9] zot, këtij të i sëmurmi gjith atë çë mund i lipëset prë doksen tënde e prë shëndetën e shpirtit e të kurmit së tij.

Prë ndë names ditën

Theos imë, lefterōmë ka gjith fëtesat, dhezëm ndë zëmërë tëndin trīshëjt namurë e le të bëhet mbë mua jotja trīdreqte duanī.

Kurë ngasën këmbōrën ndë herën e mbrëmnes ndë të prëmëten, thuhen pes Ini Jatë *e pes* Agëzuosh o ti Marie *po si janë tek Fjeta 24, ndë Psuomet të Jesu Krishtit*. [28]

PARKALESAT E MBRËMNES

Bëj nishanin e Kriqes tue thënë

Nd' ëmërë të së Jatit, eç. 23[10].

Të adhoronjë, Theos īmë, e mīrë të dua me gj[i]th zëmërën time. Të hiripsinjë pse më kreose, bën e u leva anamesa të krështerëvet e më mbajte mbë gjēllë këtë dit. Ëm hirin të njoh gjith fëtesat time mbjatu dreq si mun të i njoh mbë herën e vëdeqes e bëj të kemë nani dhëmbimen të thellë e të vërtetëme çë të mund kishnja nd' at herë.

Kurë jē arrurë këtu, penxōnë një cop herë mbëkatat çë mund kesh bërë ditën me bëna, me thëna e me trū e ato ndër cilat kē zakōnë të bieç kuazi ka dit o ka herë. Prana thua

Pafçë meje lipisī, o Zot. U metanosemi e dhëmbemi me të thellin e zëmërës time pse të fëtesa. Metanosemi e dhëmbemi jo vet prë të mīrëtë çë zbora e prë të ligëtë çë ghadhënjeva tue u mbëkatëruorë, moj metanosemi mbi gjith pse kamë fëtesurë një Theos keq i madh e keq [29] i mīrë, po si jē ti. Zot' īmë i lipisjarë, nani taksinjë, me hirën tënde, të mos bie ndë mbëkata mẽ kurraj, jo prë trëmbimen pse ti mund më gjërtoç, moj pse të dua mīrë mbi gjith shërbiset. Kufirmarë ti, o Zot, çë atidreqa timen të mire duanī çë mora, mbamë ndë ktë nat pa fëtesa e lefterōmë gjith të keqashit.

LUSE BESJE

Kamë bes pa ëhojo se ësht një Theos, cili paguonë të dreqëtit e të shtrëmburit: të parëtë me të mirën e parrajsit, të ditëtë me të ligën e të pisjes. Kamë bes mbë një Theos çë njoh mbë trī vet, Jātë, Bīrë e Shpirt i Shëjt. Kamë bes se i Biri u bẽ njeri ndë prëhërë të pafëtes të Maries Virgjërë prë bëme

[9] o] e
[10] 23] 19.

e prë virtut të Shpirtit Shëjt. Si burr vëdiq mbi kriqe prë tonat mbëkata e ndë të tretën dit u ngjallë prë vetëhenë. Kamë bes këto e gjith të tjerat vërteta të së shëjtes tëne bes, pse Theosi, keq i vërtetëm, ja kallëzoi së shëjtes Qish e prë names të asaj na i përhapën e i porsīnë neve. [30]

LUSE ELLPIZJE

Theos īmë, pse ti mundën sa të duaç e jē keq i lipisjarë e i vërtetëm e i besullorë, u ellpizonjë se ti më ndëlënë mbaru gjith fëtesat çë bëra e më jep hirën të gjëllinjë e të vëdes mīrë e më jep edhe parrajsin çë më takse prë bëmat e trīmadhe të Jesu Krishtit, ndose mbero u pafça qellurë mīrë e dreq po si perqet një të krështeu. U, me ndihëmen e të së tëndit shëjt hīrë, të taksinjë të bënjë gjith sa më kumandōnë lexha jote të bënjë.

LUSE KARITATJE

Theos imë, u të dua mīrë mbi gjith shërbiset çë ti kreose. Të dua prë të mirat çë pata njer' nani ka ti e prë ato çë ellpizonjë të kemë. Jo vet, moj mbi gjith të dua mīrë pse ti jē një Zot keq i madh, i dreqtë, i lipisjarë e prë me u dashurë. U prë nderë tënde dua mīrë edhe afërin e gjitonin tīmë si vetëhënë time.

Trīshëjte Trinitat, ëm hirën të mīrë shkonjë jetën sa të rronjë e mīrë prana të vëdes. Jip, o Zot, pushuomen të stoneonëme shpirtërave të vëdekurvet e mbllidhi ndë doksen tënde qiellesore. [31]

Shëjtja Marie, qofç prë pather e bekuorë ka gola ime. Bekōjm edhe ti prë të madhen lipisī tënde e derdh mbë mua një pik asīç hiri me k' të bëgati Theosi ndë fanëmirin kred të kunxhicjons' [s]ate pa mosnjë fëtes.

ESERÇIX

prë të gjegjurë me dhivocjonë të shëjten Mesh

Mẽ parë se të zëhet Mesha thua këtë

PARKALES

Trīlarëti[11] Theos çë jē kroi ji mburuom e pa serpos të gjith të miravet, bëmë hirën të mund të mbërparinjë bashk me priftin shëjtin sakrifix çë bënet te kjo Mesh e të të jap atë nderë e atë dokse çë perqet tëndes theosore fōrëmadhī.

U skamallisinjë se fare gjẽ mundinjë prë mua të vetëhënë, o Zoti Krisht. Me tij mbero, çë jē Salvaturi īmë e çë mbërpare prë pjes meje tit Āti, u vinjë të adhoronjë, të bekonjë e të laudhonjë

[11] Trīlarëti] Trrīlarëti

theosoren fōrëmadhī të trīshëjtes Trīnitat. Ndihëm, o Zot, me hirën tënde, dërto timet penxere, shpirtin e zëmërën time, ashtu të mund [32] gjegjinjë me gjith rreverenxjen e dhivocjonën çë duhet këtë mistikosëme e shëjte Mesh.

Kurë bënë kriqen prifti, e bënë edhe ti

Nd' ëmërë të së Jatit, të Birit e të Shpirtit Shëjt. Amin.

Theos īmë, ti çë jē imja fuqī e imja vetëm ellpize, ëm fuqī të mundinjë timëtë armiq e lefterojëm ka të tiret gënjeshtra. U, tue mundurë ata, vinjë të skamallisinjë mirërīnë tënde e vinjë të doksonjë trīshëjtin ëmërë tënd.

Kurë Prifti thot Skamallīnë

Njota se jamë ndër këmb tënde i pjono errësīrë e turp e skamallisinjë se jamë i mbushurë me fëtesa gjith shortashi të rënda, çë bëra me penxere, me bëna e me thëna. O, trīshëjte Marie, ëngjëll çë më ruonë, shëjte e shëjtëra çë më ndihëni, parkalesëni prë mua ashtu sa të jemë i ndëlierë ka gjith këto fëtesa.

Ndër të hiturën e Meshsë

Pastrojëm, o Zot, me ndihëmen e hirës' [s]ate theosore, ashtu sa të mund mbërparinjë tij bashk me shëjten Qish ato [33] laudhime çë ajo të dërgōnë e të kēmë lipisīnë çë të pienjë, tue të parkalesurë edhe të më prothinjë e të bënjë të mirën e gjith të krështerëvet.

Kurë thot Kyrie eleison

Jat' i stoneōnë, paç lipisī ka u i mbëkatëruori. Birë i Theosit, lefterorë i dheut, paç lipisī ka u i fëtesuri. Shëjti Shpirt, shëjtorërë i shpirtëravet, paç lipisī ka u i pjono me fëtes.

Ndë Doksen

O imi Theos, kurë të meritonjë u të mbashkinjë zanjën time atire t' ëngjëlëvet po të t' laudhonjë, të t' bekonjë e të t' doksinjë prë gjith motin pa serpos? Ëm, prë kaq, të parkalesinjë, ndë mot çë qëndronjë i ghonovārë ndë ktë dhē, ëm' atë duanī, cila ësht mẽ e prëmisëturë duanies' [s]ate, pa cilën mosnjerī këtu ndënë mund kētë ambënī, e mos më le të bie ndë mbëkata çë mund m' e nxierën.

Ndër parkalesat

Triforti Theos, ruoj me sī të lipisjarë tënden Qish e mirr vesh lusat çë ajo [34] të mbërparën prë names të priftit. I përgjunjurë e i çerëprëtrollurë, o Zot, të parkalesinjë të japçë edhe mua po sa të lipën ajo, dua të thomë ndëlemen e të timavet mbëkata, theosëmin namurë, virtutat gjith e rrighalet e dhënat çë më lipsen mẽ. U të parkalesinjë të më gjegjëçë prë parthënëtë e tët Biri Jesu Krishtit, cili ësht Salvaturi īmë çë gjëllīnë e rregjërōnë atje lart me tij e me Shpirtin Shëjt prë gjith jetën. Amin.

Tek Epistolla

Cila kesh t' ish njohura ime, o trīdashuri Zot, pse ti bën e u leva ndër prëhërin e të shëjtes Qish e tek shëjti pagëzim më more prana prë bīrë! Si mund të hiripsinjë prë një pasitē ashtu të madhe, cila qe arnjisuorë aq të tjerëve çë thomse keq mẽ mīrë se u mund të u kishin përgjegjurë?

A, Zot' īmë, tas çë gjith të mirat vinjë të ghadhënjenjë, çë prë mbëkatën i kamë zbjerr, ndose mbero bëfsha besërisht gjith të taksurat çë prë mua të qenë të bëra, u çë nani i përtërinjë me gjith namurin e zëmërës time. [35]

Tek Vangjeli

O imi Theos, Theos vërtetje e lipisie, sa ësht i ëmbul[12] zigoi it, sa ësht e ëmbël lexha jote, cila anamesa prikulëvet e ksaj jet na qellën pa mosnjë uhojo[13] ndër stoneonëmen lumsie. Dhezëm, o Theos īmë i miri, dhez krahnoin tīmë me shëjtin tënd namurë. Ëm një vërtetëm butësī, një vërtetëme umilltat zëmërje. Qeten ahiena pasjonat e mallet çë më luftonjin ashpërisht e çë nani mund trashigonjë atë ambënī koshenxje, cilën ti vjove atirëve çë të shërbenjin besërisht e me mallë.

Thuhet Kam bes *si ësht tek fjeta 24*

Tek Ofërtori

Theos īmi, të ofërinjë këtë sakrifix të kurmit e të gjakut të Jesu Krishtit prë nishānë se u të njoh, po si me të edhe kamë ndenxjonë të lezonjë rënden barr të timavet mbëkata e të mund kemë ka ti hirën të shkonjë gjellën e të bënjë vëdeqen të mīrë e tue bënurë sa më thot shëjti nomë çë më dhē ti.

T' e ofërinjë edhe prë pjes të timëvet gjërī, miq e armiq, po të mund kenë ata ka lipisia [36] jote gjith atë hirë çë i lipset. Ndëj edhe një ruomez, o imi Jesus, mbi shpirtërat e përghatuorit. Një pikëz

[12] ëmbul. Subito dopo, ëmbël. Esempio di variatio.
[13] uhojo. Variatio rispetto al regolare ëhojo.

vet të tëndit gjak keq i shpërblëmë sosën të shuonjë prë mbjatu ato lambsa grisullore. Tilqi, prë virtutën e këtij Sakrifixi aq i nderëm, tilqi mbë parrajs e nxiri ka vllepet çë dhuronjin e bëj të trashigonjin pāmen tënde prë pather, cila i lumsōnë e ësht ajo vërteta çë ata shpirtëra me mallë e shërtime dhishëronjin.

Ndër luse të priftit

Mbllidh, o imi [Th]eos, me lusën çë të dërgōnë prifti, timen edhe e jip trīmadhit Peshpëk të së shëjtes Qish e neve gjithvet ato hira çë na lipsen prë mz̃ të madhen dokse të së trīshëjtit ëmërë tënd.

Tek Ajosi[14]

Trīlarëti Theos, krioserë të qiellit e të dheut, përpara kuji ka një kriathirë kā të çerëprëtrollet, prë nderë të Jesu Krishtit, Birit tënd, ndritëm trutë e dhezëm zëmërën ashtu sa mz̃ mīrë njohça, bekofsha, [37] doksofça e dafsha tij. U prana, pse njoh se nëng meritonjë të rrī përpara madhëries tënde e palimëte e nëng mund të laudhonjë e të bekōnjë po sa ti meritōnë o më shum' allmonu se të tjerat kriathira, përzienjë zanjën time zanjave t' ëngjëlvet e të shëjtevet e vete tue thënë me të thelle umilltat: "Shëjt, Shëjt, Shëjt jē ti, Zot, Theos i ushtërivet. Qielli e dheu ësht i pjot me doksen tënde. Dokse të Jatit, dokse të Birit, dokse Shpirtit Shëjt. Amin".

Theos keq i fuqisëm e i madh, beko këtë trīshëjt sakrifix të lartarit e prīrë një ruome namuri tëndes Qish. Shëjtëroje e bëj të kētë pather vitorje mbi armiqt' e saj. Mba pather doksōrë e të fuqisëm trīmadhin Peshpëk, peshpëkun tënë e gjith njerzit çë gjënden e gjëllinjin ndë prëhërin të saj e të së tëndes trīshëjte bes.

Ndë kultuomen të së gjallëvet

Pafç lipisī meje, o Zot, mz̃ i ligu ndë gjith ata çë të kanë bes, po si edhe prë gjith ata çë gjënden përpara këtij lartari me duanī të shokëronjin [38] tëndin sakrifix. Mirr vesh lusat, ruoj lipset e ndëj dorën e ndihëmen tënde prej timëvet gjërī, miq, armiq, prind, shok o njerz çë më bëtin mīrë ndaj shpirtit e ndaj kurmit. Pafç lipisī prë gjith ata njerz çë nëng të njohën e nëng të kanë bes. Ndriti trūtë, hapi sitë e bëj të shohën e të xënë sa njer' nani nëng njohëtin, pse nëng gjegjëtin e nëng panë. Pafç lipisī prë të mbëkatëruomit çë të fëtesënjin, prë të krështētë çë të shërbenjin ftohurisht. Jip atirevet[15] çë gjënden[16] pa fëtes të mënonjin pather mbë hirën tënde; atirëve çë janë të tanduorë, jipi fuqīnë të mundënjin tendacjonat; atirëve çë kanë metanī mbëkatashit, jipi ndihëme të mbahen e të mos bienë mz̃. Kultohu, o Zot, ka të sëmurmit, mos harro ata çë lëngonjin o tëhelqënjin e ata çë gjënden të shtrënguorë lipseshit. Mba mend të tribuluomit; jip gjithve, të parkalesinjë, drit,

[14] Àjos (greco ecclesiastico) = Sanctus.
[15] atirevet. Più in là, atireve. Il Santoria ama la *variatio*.
[16] gjënden] ghënden.

ndihëme je levrōmë. Mbal gjithvet prana të truonjë shpirtin tīmë të nëmurin, cilin u kërkonjë të e lẽ ndër shëjtet duorë tënde. Rritëm, o Zot, besën, ellpizen e karitatën, ashtu sa, tue të dashurë nani me të gjith zëmërën time, ardhëça [39] pëstajna të të dua e të t' trashigonjë[17] prë gjith jetën e jets ndë qiellit. Amin.

Ndë Konxakracjōn

O Zot çë me një fuqī e sandilguome ndërrōnë bukën mbë tëndin trīshëjt kurm e verën mbë tëndin trīshëjt gjak, ndërro edhe ashtu gjellën, zëmërën e shpirtin tīmë e bëj çë dafça vetëm tij, gjëllifsha e shërbefça prë tij ndë ktë mot e prana të trashigofça i agëzuom e i harēshëm ndë gjellën të stoneonëme.

U kamë bes dreq e pa ëhojo se ndë trīshëjtin Sakramend ësht Jesu Krishti, i vërtetëm Theos e i vërtetëm burr, cili u lē ka Maria Virgjërë e vëdiq i gozhdjasurë mbë kriqen ndë rahjin e Kalvarit, po të salvoj gjith shpirtërat e njerzëvet.

Kurë ngrëhet Mëridhja

O trishëjt e trīdashurë Sallvaturë e Jāt i pjono me namurë, u me faqe prë truolli të adhoronjë. Pafç lipisī ka u i mjeri çë jamë i pjot me mbëkat. [40]

Kurë ngrëhet Kállaçi

Salëvo, o Zot, shpirtin tīmë çë bjejte keq shtrëjt me tëndin gjak trīshëjt.

Pas ngrëjtures

O Zot, sa mẽ të shoh me siun të shpirtit e të besjes i ulurë e i përtrollurë ndë ktë mistikos, aq mẽ thellisht përtrollemi përpara tij, o Theos, e të adhoronjë.

Burrërī e trīshëjte të Jesu Krishtit, bjemja e së tënës shëndet, jatria e sëmundavet tona, tharosi i shpirtëravet tënë, u të adhoronjë mẽ thellisht se mundinjë e të ofërīnjë stoneonëmit Jāt prë shëndetën time e të dheut gjith.

Trīëmbël Jesu Krisht çë desh t' shprishënje gjith gjakun tënd i trīshëjt e të vëdisënje deshe i lakosurë, i shqerrurë e i copjasurë mbi një kriqe prë namurin tīmë, u të dua mīrë me të gjith zëmërën time e lutinjë mẽ shpejt se të vëdes e jo se të lẽ vetëm një kred të të dua me zëmërë mbë mallë.

[17] trashigonjë] trashinjonjë.

Te kulëtuomja e të vëdekurvet

Trīdashuri Jesu Krisht, të lusinjë, prë nderë të trīshëjtes gjellë[s'] sate e prë [41] vëdeqen keq të tharëtë çë dhurove, po të përhapçë tënden theosore lipisī shpirtëravet të përghatuorit. Kulëto, ëh, se ata duolltin ka kī dhē dëtirëm tëndes justixje, moj mba mend edhe se ata ndë nëmërë të atirevet çë zgjodhe janë. Kulëto se ata dhuronjin pse të duanë mīrë e ti edhe mīrë i do. Ndër tjerat, prana, të parkalesinjë të kēç lipisī prë timëtë prind, gjërī, miq, e arrmiq e çë më bëtin mire e mẽ me māllë të truonjë atë të tīmë – NN – *(si të duaç)*. Ndële atirëve gjith ato dëtīrë çë i mënonjin të hinjin ndë qiell e jip atirëve pamen tënde e ambënīnë të së tëndes rregjërī.

Parkales prë të mbëkatëruomit

Imi Theos, u njoh e skamallisinjë se jamë një i ngrakuorë me mbëkat e jetërë ellpize nëng më qëndrōnë prë shëndetën e times gjellë të stoneonëme ndomos ajō çë kamë mbë tënden trīmadhe lipisī. O Zoti Krisht' īmë, lefteror' īmë, mos bëj me mua judhçin fōrëmadh, moj më u bufto si jatë i pjono namurë e njomsī! Ndëlëmë, o Zot, sa mbëkat e të liga e shtrëmburī kamë bërë e ndëlejmi vetëm prë mirīnë tënde theosore [42] e prë nderë të Jesu Krishtit tët Bīrë, cili u sakrifikos prë mua e prë gjith dheun mbal këtij lartari.

Këtu thuhet Ini Jātë, *si tek fjeta 24*

Parkalese

Ellpizonjë, o imi Zot, ka mīria jote theosore gjith ato të dhëna shpirtulore e kurmërishte çë janë të mbjedhura ndë parkalesen njëmend e thënurë. U i pres, i ellpizonjë e i dua me bes bīrishte e pse ti prë vetëhënë, si jātë çë keq mire më do, më porsite të t' i lipënja tue lusurë ashtu e më takse se m' i jipënje.

Tek Qëngj i Theosit

Trīëmbëli Qëngj i Theosit, çë nxierë mbëkatët' e dheut, pafç meje lipisī.
I paftesëm Qëngj i Theosit, çë nxierë mbëkatët' ka dheu, pafç meje lipisī.
Trīdashuri Qëngj i Theosit, çë lanë mbëkatët' e dheut pafç meje lipisī.

Te Kungimi

U njoh, keq mirë, Zot' īmë, se nëng meritonjë të t' mbjedh ndë krahnoin tīmë. O Theos i trīmadh, imja pazëmërī, imja snjohurī e ligu zakōnë çë pata të mos [43] ruonja po si më ngitej hirën tënde e timet fëtesa pa nëmërë; gjith më qërtonjin e më thonë se u nëng meritonjë mẽ hirë e mbi gjith prana këtë aq të mīrë. Jetërë poka nëng më qëndrōnë ndomos të përtrollemi përpara thronit të

fōrëmadhies tënde të pa serpos e të skamallisinjë e të kallëzonjë se u jamë njerī keq i mbëkatëruorë, çë nëng meritonjë mosnjë hīrë, moj mbal gjith pëstaj atë hirë ashtu të trīmadhe çë ti jep te Kungimi. Mos vërë rē mbero, o Zot, ndër atë çë jām' u, po ruoj vetëm' atë çë jē ti. Theos namuri, Theos mīrie, Theos lipisie të palimtë, thuoj vetëmez një fjal e ajo sosën po të më shëjtëronjë shpirtin, t' e lanjë, t' e pastronjë, të e thjéllminjë ashtu sa të mund meritonjë tharoset e dhënavet tënde jose bëgatërīnë e hīrëvet çë ti jep te kī e mbë[18] të tjerat keq të mira sakramende.

Pas Kungimit

Çë mund bënj' u, o theosëmi Jesus, të miri prë tij mbë ndërruome të mīrëbëmes e pathënëme çë ti më lē me vetëhënë tënde mbë sakrifixin pa gjak të lartarit? Qofsh pather i bekuorë ka gjith [44] shënjëtit të qiellit, ka gjith njerzit të dheut, ndë motin çë u k' ana ime nëng lẽ kurraj të doksonjë lipisīnë tënde pa serpos e thomë ka herë e ka kred zëmërës e shpirtit tīmë bashk me profethin: "Beko, o shpirti jīmë, Zotin, cili ndëlenë fëtesat tënde e shërōnë tëndet shpirtulore sëmunda".

Ndë prasëmat parkalese

Lipisjari Theos, ëm, të lusinjë, çë të kī sakrifix të bënjë ndë shpirtin tīmë mburōme pema shëndetje e hīrëshi. Ndritë mendën time, fuqis timen duanī, dulīrëm zëmërën, pastrojëm shpirtin, lajëm ka gjith ato kafsha e kondëra çë mund shpëlqenjin përpara sivet tënde, ashtu sa çë sod e pārë u bëfça dreq prë dreq tënden theosore duanī.

E madhe Virgjërë, Jëm e Theosit, njota ni u rrī çerëprëtrollurë përpara këmbëvet tënde. U të mbërparinjë shpirtin tīmë si një lulez e veshkurez çë nëng pati prë një mot shum të gjat jo shī, jo voez. Ti nani ndihe ndë trīmadhet lipse çë kā. Lus ti prë mua tët Bīrë po të më jap ndëlemen e mbëkatëvet. Ti dërto ashtu zëmërën time, sa ajo, prë motin çë të [45] vinjë, aq e shërbeft e daftë mīrë me mallë e thellisht, sa prë motin çë shkoi rëndërisht e fëtesi. O e madhe Rregjëresh të qiellit e të dheut, trībëgate tharosésh të gjith hīrëvet të tīnë Zoti, pas Jesu Krishtit ti jē imja ellpize, imja shëndet, imja ndihore, imja harē, imi rrëfuxh, imja gjellë.

Kurë prifti jep bekuomen

Jip gjithvet, o Zot, bekuomen tënde ndrishe hīrëshi e mburuome, po si ajo qe me k' bekove apostolit e dhishipulit tënd, kurë u hipe ndë qiellit, e kjo çë më jep nani prifti qot parëpaguome të asaj çë ti takse të e japçë të zgjedhurvet tënd tek e prasëma dit të dheut.

[18] te / mbë. Variatio.

Tek i prasëmi Vangjel

I çërëprëtrollurë, o Zoti Theos, të lusinjë të më ndëlëç të vogëlën dhivocjōn me k' mbeta përpara tij ndë të madhin e shëndetëm sakrifix të ksaj Mesh. Ruoj me lipisī, o dejt mīrie, të murgun shpirt tīmë e leje të ketë pjes ndë hirën tënde këtu mbi dhē e të vinjë prana të trashigonjë pjes ka doksa jote e stoneonëme ndë qiellit. Amin. [46]

PARANDREQURË
prë Skamallīnë e prë Kungimin

Parkales e parë

Përgjunjurë përmisurisht[19] përpara këmbvet tënde, o Theos īmë i miri, tas çë njoha sa keq më vjënë e sa lig ësht të gjëndemi llarghu ka ti, njota se nani priremi prësëriu tij, Jātë i pjot me namurë, zëmërënjomë e i lipisjarë. U ftesa, o Zot, ëh, e keq fëtesa e nani kush mund rrëfienjë sa më tramaksën pamja e së timavet mbëkata? Moj ti mbero prë vetëhënë më thē se nëng do të vëdes pa spërënx i mbëkatëruomi, moj do se të njoh vetëhënë e tij, të metanoset, të lërënjë udhën e lig, të priret tek ti, e të gjëllinjë. Ruoj poka me sī të lipisjarë murgërīnë time, pse u prë vetëhënë nëng mundinjë gjẽ. Ndëjëm dorën tënde ndihore, nani çë njeh se u dua të priremi e të salvohemi tue kërkuorë të dal ka kī avs i mbëkatëvet, ku qeva i përmisurë. Ndritëm, o Zot, mendën, hapëm ndilëguomen e trūtë e bëj të njoh ëmërin e kuallitatën të gjith mbëkatëvet çë bëra. Dhez zëmërën time me një [47] namurë të shëjt, ashtu sa të i ketë mbë nodhje ndrishe sa janë. Ëm fuqī e duanī të mund i skamallisëça mīrë e të mbanjë pa ndërruome taksurën çë të bënjë të mos bie ndë fëtesat mẽ çë sod e pārë.

Këtu

penxōnë mīrë mīrë fëtesat çë kē bërë çë ka e prasëma skamallī, ndose ajo kā qënë e dreqte, ndomos zẽ çë ka të tjerat mẽ përpara. Pri s' pari skamallisën ndose bëre penitenxjen, ndose kē lënurë ndonjë mbëkat pa skamallisurë prë të keqë duanī, prë turp o prë ndonj' etërë tendacjōn o prë harruome; ndose nëng gjegje o nëng kē bërë porsimëtë e skamallerit. Kulëtōnë ndose mangove mbi komandimet e të nomit të tīnë Zoti o mbi preçetet të së shëjtes Qish me thëna e me trū. Kultōnë mos kē vixe asoj çë sjellën vëdeqen e të shpirtit e asoj fëtesa çë thërresën mënit përpara tīnë Zoti e mbëkatat gjith çë mund kefç bënurë me sī, me vesh, me gol, me hund e me duorë e ndose nëng bëre gjẽ çë të qe kumanduorë ka kush mundij; mbë mirin çë mund bënjë e nëng bëre; mbë ligun çë mund lënje e [48] nëng e ike; mbë dhivocjonat çë nëng thē, Meshat çë nëng gjegje, krëmëtet çë nëng ruojte, skandalin çë mund kefç dhënurë e të tjerat fëtesa ndrishe, po si i bëre, ku i bëre, përpara kuji i bëre, sa herë i kē bërë. Ka t' vëç mbë serpos ndë kultuomen e të mbëkatëvet atë fizikī e atë rē çë të vënje ndose kishënje prë ndë duorë nëgoxin mẽ të rënd e mẽ të madh të shpīs o të kurmit tënd e mẽ edhe. Prana thua

[19] përmisurisht] përmsurisht.

Bëme dhëmbimi

O Theos, u fëtesa e pata zëmërë! Çë keq më kishënje bënurë ti, çë ashtu lig u përgjegja mīries tënde pa serpos? O, qaj, zëmëra ime, qaj tëndet fëtesa, çahu prë dhëmbime, nodhjo mbëkatët' tënde, po si mund keshënje mbë nodhī s'hirën mm̃ të rënde je mm̃ të keqe çë të psonje mbi dheun. Taks të ndërroheç e të skamalliseç mm̃ njëhere e mm̃ nje se mundën e të prakārëç mbë shpirtin tënd gjakun trīshëjt të Jesu Krishtit prë names të sakramendit të Metanies, kuj ti nani qase po të mbjedhçë pemat. Qaj, zëmëra ime, pse me fëtesat çë bëre zbore parrajsin e ghadhnjeve pisën. Qaj, pse fëtese, [49] llastimise je shajte një Theos, cili ësht iti Jātë i but, i mallīsëm e i zëmërëmadh; cili jo vetëm se mosnjë keqe të bëri, moj ka vit, ka muoj, ka jav, ka dit, ka koh, ka herë e ka kred të mbjoi e të pështiellti gjith të mīrashit. Qaj, zëmëra ime, pse fëtese një Zot keq i mīrë, cili, me gjith se ti e fëtese, të zgjodhi prë bīrë i tridashurë e të bëri rredh të lumrīs stoneonëme të së tij. Fëtese një Theos ç' ësht krioseri i zëes tënde, një Theos çë të dha gjith atë çë kē ndë shpirtin e ndë kurmin. Qaj, zëmëra ime, pse fëtese Theosin, cili ësht kroi i mburuomë të gjith hīrëshit. Theosin fëtese, çë meritoi vetëm të ish i dashurë mbi gjith shërbiset çë na mallipsënjin prë dheun. Qaj zëmërë, se ti fëtese Theosin thomse dreq nd' atë herë, kurë ai të bënej mm̃ mīrë e mm̃ namurë të buftoj. Qaj, pse fëtese një Theos, cili prë mīrëtë çë deshi tij e prë shëndetën tënde u bm̃ njerī, si burr u lē, e ku? Ndë një grasht[20].

Prë tij qajti si corrobillith, qe i ngjeshurë e i pështiellurë me liverez, dhuroi tëtīm, gjëlliti i nëmurë e i vobkë, shërbeu si trim, dërsiti si burr ndë një puthigh e, mbë mot çë ish aq i mbëdhā fuqije e i vogël buftohej [50] prë duanīnë të vetëjuj, nëng qe i njohurë, more qe i përqeshurë e i shajturë. Qaj, zëmëra ime, pse fëtese një Theos, cili prë namurin çë suolli tij vate tue bënurë Dhaskalin, tue kallëzuorë urtëria qiellsore e tue porsiturë njerzit me shërbēme, me dhurime e me stjende ndrishe shortashi. Fëtese një Theos cili prë mallin tënd la gjith vetëhënë e tij si Theos e si burr mbë të shëjtin Kungimë!

Qaj, zëmëra ime, pse fëtese Theosin, cili dërsijti gjak te Kopshti prë tij, tue parkalesurë të Jatin po të ndëlej mbëkatat tënde. Fëtese një Theos, cili la të bën të e lidhjin, të e shtrëngojin me trëkuza, të e rrih'jin, të e përtrollëjin, të e xarrisjin, të e shpitjin, të e shajin, të e pushtijin, të e lakosjin po si deshëtin njerzit, prë cilëtë ai dhuroi e prë shëndetën e cilvet vëdisij.

Qaj, zëmëra ime, pse fëtese një Theos, cili prë namurin çë të deshi, përmëtoi t' ish i xheshurë e t' ish i lidhurë ndë një kullōn e t' ish atje i rrahurë me dēllë e me trëkuza aq sa mosnjerī qe ashtu i rrahurë tek ndonjë mot. Fëtese një Theos, cili tue qm̃në vërteta Vasilevsi të qiellit e të dheut, Zoti i ëngjëlvet e i njerzëvet, la [51] të bm̃në të e dhunojin si ji llavurë e si vasilevs i të gënjemes e të e përqeshurìes. Fëtese një Theos, cili prë pjes tënde qe i ngrakuorë me një kriqe trīrënde, çë ai me të gjith duanīnë e tij e qelli ngrah njera mbi rahjin e të Kallvarit, ku prana mbal asaj qe i gozhdjasurë ndë këmbtë e ndë duortë, me dhëmbime çë s' kā thëni, qe i ngrëiturë lart e lëngoi e tëhelqi trī hera prë tij.

[20] Altrove in quest'opera scrive *grazhd* [gcrasgdh], con il significato sempre di *stalla.*

Qaj, zëmëra ime, qaj, pse fëtese një Theos, cili prë nderë tënde qe i djegurë etit, lipi të pij e i qe i dhënurë thartirë, uthull e helmëthe. Qaj, pse fëtese një Theos, cili edhe mbal kriqen kultoi se ti qëndronje e varfërë e të la truojturë një jëmje keq e mirë e je lipisjare, po si ësht Maria. Qaj, pse fëtese një Theos, cili prë tij monu zëmërën desh t' mbanej të tërë e bën e i haptin krahnoin, i shquortin brinjëzit e zëmërën i lakosëtin e ahiena Krishti derdhi atena një lum uji e gjaku, çë vëleu të shuonej zjarrin e mbëkatvet tënde. Fëtese një Theos, cili tue lënguorë ndë kriqe parkalesi të Jatin po të ndëlej ata çë e kriqsojin e je vritjin, si vërteta i vrarë qe me një dejt straxjesh, e [52] vëdiq e qe i gropsurë prë nderë[21] tënde e ti nëng e njohe!

Qaj, zëmëra ime, pse mangove një Theosi, cili të tretën dit pas çë vëdiq u ngjāllë ka të vëdekurit, u hip ndë qiell, ulet tek e djathta e të Jatit, ku rrī e pret të jap njerzëvet parrajsin. Fëtese Jesu Krishtin çë qe ai çë të pruori shëndetën, qe ëmbllësia e zëa të gjelljes tënde. Fëtese një Theos, cili të dha hīrë pa nëmërë e jetërë nëng pritij o duoj ka ti ndomos të e keshënje dashurë me namurë. Ti nëng u përgjegje ndë prëtënduomen e tij, moj ai nëng u lodh e nëng të lëshoi e gjith ditën të mīrisën e të hirisën e me mallë të madh të lipën zëmërën e jo mẽ gjẽ.

Poka ai, tue bër' ashtu me tij, buftōnë valledreq se të do mīrë si vetëhënë e tij, jo për të, pse ai s' kā lipse njeriu, moj vet prë të mirën tënde e po se të bënjë tij kutjend, oreksëm e i harëmë ndë ktë gjellë e prana të t' lumsonjë prë pather tek jetëra. Popo, zëmëra ime, si pate shpirt të bënje aq keq? Çë të bëri Theosi? Ku të mangoi, ku të ngau, ku të cënoi, o të lakosi? Përgjegju. Pse je ftese? A, ti qetën e nguqurë e je turpëme, pse s' kē çë të thuaç! [53]

Metanosu allmonu ka ligtë çë kē bẽnë e vëhu çë nani të qāc ftesat çë bëre. Dhez të shuojturin namurë, zë[22] një gjellë të rē e mos duaj jetërë, mos dīshëro jetërë ndomos Theosin çë të kreosi. O, çë të e keshënja pather mīrë dashurë e mīrë shërbierë këtë Zot vërteta prë me u dashurë, pse deshi mua mẽ se vetëhënë e tij. Malli īmë, gjella ime, shëndeta ime, imja ellpize, u të dua mbal gjith të tjerat shërbise me të thellin e zëmërës. Kamë nodhje, mbal gjith të ligat çë mund gjënden, ligën e mbëkats time. Dua të skamallisemi me dhëmbime e metanī e s' dua të t' ftesinjë më kurraj, imi trīëmbël Lefterōrë.

LUSE

Trīshëjtes Trinitat

Trīdashëme Trinitat, Jātë, Birë e Shpirti Shëjt, Theos īmë, u të adhoronjë. Njota nani ndë këmbtë tënde një i vobek çë lusën të ambnīset me tij prë names të skamallies. Moj pse, Theos īmë, u pa ndihmen tënde s' mund bënjë gjẽ të mīri, more i gjas gurit çë rrikulliset ka mali prej hjimën, cili nëng qëndrōnë të [54] përmiset njera tek mẽ thelli i llaks, ndomos çonë ndonjë qëndruome. Andaj

[21] nderë] inderë.
[22] zë] ze.

të parkalesinjë me sa mẽ fuqī mundinjë, prë nderë të së madhes lipisī çë ti kē, se të më ndritçë trūtë po të kultonjë fëtesat gjith çë bëra. Bëj të njoh sa janë të sihjenëme e të shëmbtuome e të keqa mbëkatat, ashtu të mund i nodhjofça me të gjith zëmërën.

O imi zoti Krisht, u tij qasemi si ndë një krua lipisie, ku kamë ellpize të lahemi e të zbardhemi ka gjith kondrat e të shpirtit. O diell justixje, dritëso mua të ghuerçin; o jatrua theosorë, shëro mua të sëmurmin; namurë i pa serpos, dhez shpirtin tīmë me mallin tënd qiellsōrë ashtu sa të griset prë lot dhëmbimi e të jētë aq e mira kjo skamallī sa bëftë të ndërrofça gjēllë vërteta e mos t' u ndafsha mẽ kurraj ka ti, Theos īmë, ellpiza ime, namuri jīmë, ambnia ime.

O e dashura Jëma ime dhëmbsuome, përmëto të përzihen me tëndet lotët' [t]ime. Prë kulëtuomen të tëndevet dhëmbīme, o Marī, bëj të kemë ka īnë Zot një dhëmbime të thellë e të madhe prë fëtesat çë bëra e zëfsha një penitenxje po si perqet e mos e lëfça kurraj njera ndë vëdeqe e mbefça ashtu tue qajturë prë helëm [55] e prë mallë të timit Salvaturë, prë gjith motin çë të rrōnjë ndë ktë dhē.

PAS SKAMALLIES

Luse

Dashuri Jesus, qofçë pather i bekuorë, pse tue më ndëlierë mbëkatëtë më nxore ka pisa e më rrëndirëte rredhitatën e të parrajsit. U hiripsinjë tënden paserposëme mīrie, moj u, o Zot, jamë pather i ndrequrë po të të tradhizonjë e të t' sbesinjë prësëriu, mẽ zī se bëra ndë motin çë shkoi, e nëng mund kumbisemi ndë vetëhënë time keq e njōmë e keq e lekundishte, mos nëng më mbanë shtuora e nëng më ndihën hiri jīt. Mbamë, poka, o Zot, duort sipërë e mos le të jemë i mundurë e i përtrollurë ka tendacjonat. Dua të vëdes mẽ shpejt e jo të t' fëtesinjë mẽ. Njëmil vëdeqe dërrgōmë e mos më le të bie ndë mbëkatën mẽ të leze çë mund jetë.

U gjëndemi, o Theos īmë, anamesa ndë leke e ndë prikul e, mos më buftōnë Ti lipisī e nëng më ndẽnë dorën tënde të më marr, të më mbanjë e të më ngrënjë, u bie proposh e jamë i zbjerrurë [56] prë pather. Mirrëm, o Zot, mbajëm, dreqtōmë e qellëm ti aso udhashi çë më siellën mbjatu dreq ku ti gjënde, ndë paserposëmin mot.

Virgjërë trīshëjte, ndihëma e rrëfuxhi i të mbëkatëruomvet çë priren Theosit, u të parkalesinjë me mallë të thellë e me zëmërën të dhezurë po të më ndẽç dorën lipisjare edhe ti e të më mbāç besërisht e pa ndërruome ndë taksura çë bëra Zotit tīmë. Ëngjëll çë më ruonë, shëjtëra tīmë avuket, mbamni ndë prikul pa dëme, ruomni ndë tendacjona, ashtu sa me ruomen e me ndihëmen tëj u mundsha mallet gjith çë më zotëruonë njer' nani zëmërën e rrëvofsha një dit po të këndonjë bashk me ju laudhimet e doksat të atij Zoti çë më pati sod aq lipisī.

PARANDREQURA

prë Kungimin

Vërë rē, o Shpirt' īmë, e njih mīrë kush ësht ai çë fshehurë ndën speçiet sakramendishte vjenë sod mbë tij. Ësht Jesu Krishti prë vetëhënë, Theos e burr! Ai dreq çë rrī ulurë ndë të djathten të [57] stoneonëmit së Jātë! Ai ç' ësht i Zoti i qiellit e i dheut! Ai çë të kreosi e me gjakun e tij të bjejti mbëkatashit! Ai çë të mbānë e të dreqtōnë mbë gjellë! Ai çë kā të jētë judhkoi it ndë herën e të vëdeqes tënde! Kulëto mīrë, mas e penxo madhīnë, forëmirinë, fuqinë, urtërīnë e butisìen të këtij Zoti! Zgjo mbë tij skise të thelle rreverenxjesh, përzieji me një i doq e i dhezurë mallë drej këtij Theosi ashtu i madh, ashtu i mirë, ashtu i ghavnarë, ashtu mburōmë hīreshi e thuoj mbë vetëhënë tënde: "Ndose u të shihnja një rregj dheu, çë të vinej te shtëpia ime po të më bëgatij, të më nderoj me pasitē rregjërishte, me hīrë e me gjith të mirat dheore, si më mirrshin mua trūtë, tue penxuorë madhīnë e nderjes çë më bënej ai! Cila t' ish oreksa e harea ime tue masurë fōrëmbdhānë ellpize ç' u mund kumbisënja ndër pasitētë çë të mund më bënej ai. Njota, ni, shpirt' īmë, Rregjin të qiellit e të dheut çë vjenë mbë tij".

Besa t' e thōt keq mẽ mirë e këthjēllë[23] se s' mund të t' e thoshin skiset e kurmit. Andajna thuaj: "Të kamë bes, o imi Zot, të adhoronjë, të doksinji, të lusinjë. Më tramaksën [58] mbero besa ime pak e çelurë e zëmëra ime keq e ftohëte. U kam turp e nguqemi tuke u pārë pa mosnjë bëme çë meritōnë ti e pa mosnjë parandreqe o pastruome gjëndemi me k' të pres e të marr zotërien tënde. U jamë i nëmurë, jamë i pllot vobkësī, i pllot me mallixje e me ligërī e me mbëkata, pa mosnjë virtut, pa mosnjë urtërī. Jam' i çotiasurë, i ftohurë, i mundurë ka mallet e të dheut.

U meritonjë mẽ shpejt njëqind pisa e si mund pres e të dua po të vifçë ti, o sëmadhi Zot, ndë shtëpīnë time? Jo, zot, jo, zot? U nëng meritonjë aq mīrë, aq harē, pse nëng gjëndetë nj' etërë mẽ se u i mbëkatëruom mbi dhē. Ndose ëngjëlit nëng gjënden, po si të perqet, të pastruorë e të prëndrequrë përpara tij, o fōrëmadhi Theos, si mund prëtëndonjë u të hīç ndë shtëpīnë time, cila qe prë kaq mot e pasurë ka mbëkata e ka dhimoni?".

Penxo mīrë mīrë, shpirti jimë, prë cilën ligj Theosi mboshtet ka qielli njera mbë kurmin tënd i fshehurë ndën sqepin të buks e të vërës. Vasilevsit e dheut nëng marrën kurraj ndonjë të vaturë të gjate ndomos prë ligja rëndërishta ghadhnjemje të vetjuj. Moj ligja çë shpitën Theosin të [59] vinjë mbë vetëhënë tënde, mbë të birin tij, nëng ësht prë ndonjë ghadhnjeme të vetjuj, po prë ghadhnjemen tënde. Vjenë ai si jatrua i lipisjarë po të shëronjë lavomat e thella çë ti kē. Vjenë si jātë i pjot me namurë e butsī po të dreqtonjë zbjerrurat çë ti bëre. Vjenë si Zot keq i mīrë po të t' mbanjë shtuora me hirën e tij. Vjenë si një kamīnë karitatje po të ngrohinjë ftohsīnë tënde e të t' ndërronjë mbë vetëhënë e tij theosore, ashtu të mund thuoç ti po si thonej shën Pali: "Rrōnj' u, moj nëng jam' u çë rrōnjë, pse rrōnë mbë mua Krishti".

[23] këthjēllë] këdhjēllë.

Njotani, shpirt' īmë, po sa stīmë ka prë tij Theosi, sa ësht i madh namuri çë të siell. Cili ndër ëngjëlit mund dokset po si mundën ti? Cili ëngjell mund ketë një Theos prë të ngrënë si kē ti kurmin e Jesu Krishtit? Cila karitat ësht kjo, çë ai Theos, kuj lusnjin vetëm të e shohën ëngjëlit, ai Theos jipet tij kur' e do e sa herë ti e do? Çë e gjeturë namuri qe kjo? Kush mund e fjandaksij, kush mund e penxoj, kush mund e bëj, ndomos īnë Zot, ndomos Theosi krioserë! Thuoj nani ti, zëa ime! Nëng jē ti mẽ e ngurëte se një gurë, mẽ e ftohte se qatruli, [60] mẽ e paskise se një marmurë, mos nëng dheze me një mallë të zjarrisëm prej një dejt ashtu i gjerë e i thellë mīrìe?

Ndihëm edhe ti, theosori Shpirt, me rrighalet tënde qiellsore e pastro e prëndreq zëmërën time të bënë të jetë një shtëpī po si perqet këtij sëmadhi çë vjenë të më nderonjë. U të lipinjë një dhëmbime të madhe prë fëtesat çë bëra e një dishëruome të fuqisëme të mos i bënjë mẽ. Të lusinjë të më japçë të mbanjë vërtet me bes të gjallë e të thellë se ndë ktë Sakramend gjëndet e mënōnë Jesu Krishti. Të lusinjë të më japçë rreverenxjen çë ngitet fōrëmadhies të tij, umilltatën e zëmërës e një ellpize astundurishte prë shëndetën time stoneonëme, tue pasurë prë peng kurmin të Jesu Krishtit e një mallë të doq e të çelurë prë një Theos keq i mirë, cili aq mīrë më deshi e më do.

LUSE NJOHURIE

U poka, kriathirë ashtu e vogël je ulëte je përtrōllëme, kamë të marr mbë golën time e të vjonjë ndë timin stomahj e të mbllinjë ndë timen zëmërë [61] një Theos ashtu i madh po si jē ti çë nani vjenë tek u ndë ktë Sakramend?

Cilin sëmadh zot e bularë i trīlart pret nani, o zëmëra ime? O çë ghavnarë e i bukurith dhëndërr vjenë të t' lloronjë ananith, zëa ime, dhëndërr' i trīdashurë mbi gjith dhëndërrat prë me u dashurë. O Fjal e mishëruome çë, sa qeve thënurë, kreose qiellin e dhenë, si vjenë të kërruseç nani ndë të ngushtith e të thatë prëhërë të një kriathirje ka tëndet?

O Vasilevs i dokses, pse aq çerëprëtrolle çë do të[24] kumbisëçë thronin e madhëries tënde ndë proposhtin e times vobkëtī? O vërteta bëme mīrie të mos mund rrëfihet!

Një Theos prëmisën vetëhënë e tij po të ngrẽnjë e të prëlārtinjë një së tijin shërbtōrë! O të mund mirrnja rrisollucjōn një herë të të duonja mīrë, po si ti do mīrë mua, e të të rrëndirënja mallë prë mallë, karitat prë karitat, po si të perqej e të ngitej! Ti Rregj i rregjëravet e Zot i gjithies, kuj nëng lipset mosnjë shërbes, pse gjith i kreose ti e nani ule mbi krahtë e ëngjëlvet çë të shërbenjin; ti, Zot i fōrëmbëdhā, i pa ndilguome, i pa anxënëme, do t' vīsh ndë ktë vend ashtu i ulëtë e pa mosnjë [62] pastruome të kurmit e të zëes time? Thomse do t' mboshteç nj' etërë herë ka qielli mbi dhē? Do t' leheç nj' etërë herë ndë një grazhd mbi barin e thatë o mbi kashtën? Do t' jipeç nj' etërë herë mbë duorë të të mbëkatëruomvet? O Theos, o imi Zot, pse ti vjenë ndë ktë Sakramend të tagjisçë, të ngjallëç, të levroç e të siellëçë nj' etërë mil të mira kurmit e shpirtit tīmë?

---

[24] të] ti.

Si kamë të t' hiripsinjë u prë këto trīzgjedhura dhëna e mīrëbëme me k' më bëgatën. Si kamë të t' mbjedh mbë kurmin tīmë, të buftōnjë mbë pjes prëmadhen lipisī çë ti adhetën me mua? U i faqepërtrollurë përpara këmbëvet tënde të parkalesinjë të më qërōç, të më pastronjëçë me hīrën tënde, të mund gjëndemi ashtu i gaturë e i parandrequrë të t' mbjedh si të nget e të t' mbanjë po si të kā hjē. U njoh se jamë keq i kondrepsurë e, jo se i vrëjturë, jamë more i nxiturë e i zī mẽ se uri, prë këtë thërres i çerëprëtrollurë: "O Zot, u nëng meritonjë të hīç ti ndë shtëpinë time me të fōrëmadhen tënde lartërī. Domine, non sum dignus ut intres sub tectum meum". [63]

LUSE SH. MARIES

O e përdashura Jëm e Theosit e Virgjërë saftesëme Marī, çë prë tënden vetëmez thjellmī meritove të kishënje e të mbanje ndë prëhërin tënd të Birin të Theosit tas i burripsurë, edhe u sod kamë të e mbjedh mbrënda meje, moj po si janë ndrishe mallet e nëng gjiten fare! Ti njeh sa e cila ësht ndinjitata[25] ime, pse u kamë kondrepsurë njëmil herë me mbëkata shpirtin timë.

Nani skamallisinjë përpara tij të vobken qënurë time e prë këtë me gjith zëmërën, i çerëpërmisurë e i dhëmburë, priremi e vinjë të lusinjë tij çë jē rrëfuxhi i të mbëkatëruomvet. Ti qellë, të parkalesinjë, e mbërpārë t' it Biri virgjërīnë, shëjtërīnë, mallet, namurin e gjith atë parandrequrë me k' jeshënje je pastruorë, kurë e mbjodhe ndë prëhërin tënd pa mosnjë fëtes e kurë u kungove edhe ti prë pjes të gjith dheut. Se të mund e marr somenat me të gjegjurën mẽ të madhe umilltatje, kufdhenxje e namuri, tue pārë dorën e priftit çë vjënë të më kungonjë, fjandaksinjë të shoh mbë duorë tënde timin e tëndin [64] sakramendisurë Jesus e, ndose ti aq më përmëtonë, përdashure Jëmë, u mbanjë të e rriçivirinjë ka duort' tënde e kërkōnjë të e mbjedh me mẽ të thellen rreverenxje, me mẽ të dhezuren dhivocjōn e me mẽ të shumat pema çë mundinjë. Qoft' ashtu.

LUSE

Ëngjëllit strazetārë e të shëjteve avoket

Imi Ëngjëll strazetārë çë somenat gjënde përpara ndë këtë kungīmë ç' u nani vete të bënjë, edhe ti ndihëm e qëro e laj e këthjell gjuhën time, golën e zëmërën me një zjarr qiellisht, po si ai me k' ëngjëlli qëroi, lajti e këthjellti gjuhen të Isaies e të Jeremiut, ashtu të mund e marrsha me atë dulī e këthjellmī çë i ngitet këtij sëmadhi Zoti.

E ju, o shëjtëra çë më jini avoket, përzieni edhe ju lusat tëja bashk me timet, ashtu të mund dhezet mua ndë zëmërën besa, ellpiza e karitata, çë keq më lipsen[26] të mund rriçivirinjë Jesu Krishtin mīrë e dreq ndë kurmin tīmë. Amin. [65]

---

[25] ndinjitata] ndnjitata.

[26] Dal singolare (*dhezet*) al plurale (*lipsen*).

BËME DHIVOTE DISHËRIMI

O imi Theos, ea mbë shpirtin timë e shëjtëroje. Zotërou ti ka zëmëra ime e ndërrojme. Imi Theos, hīrë ndë kurmin tīmë, ruoje, shtrëngoje, mbaje e mos e lē të ndahet më ka namuri jit ndonjë herë.

Digj, o kamīnë karitatje, digj sa gjënë ligu e të ziu mbi mua e shkatërro e gris sa sheh se mund vëhet përpara hirën e namurit tënd.

O Mānë qiellishte, bëj çë u të njohça sa e ëmbël jē, të më nditen prana të tharëta, si mbë vërtet janë, gjith pëlqemet e të dheut.

Ea, Zot, i dashurë e keq prë me dashurë, ea e ëm gjith ato të mira çë takse atirëve çë të marrën me mallë!

O pëlqeme, o harē të zëmërës time, mos ngjat mẽ t' ardhuren tënde. Ea nje e mos mëno, pse zëmëra më digjet prë dhezurin mallë e shpirti më griset prë namurë. U e njoh se jetërë nëng jamë ndomos një vobkez kriathirë, moj ti jē keq i madh e keq i mīrë e nëng ndurpe të vīç ndë vobkëtīnë time.

Ea, trīdashuri Salvaturë, ea më [66] dulīrë[27], ea më këthjellë, ea më pastro, ea më shëro, ea më lumso.

PAS KUNGIMIT

mënōnë një ca mot tue penxuorë, prana thua këtë

LUSE

Ësht vërteta poka, o imi prëdashurë Theos, se nëng të qëndroi imja vobkëtī, imja ligërī, po të vinje tek u, e nani gjënde ndë zëmërën time! O Zot, sa jē prë me u dashurë, sa jē i mīrë, sa jē i dreqtë, sa jē duorëhaptë e zëmërëmadh po të japçë pa lodhurī! U të adhoronjë, o imi Jesu Krisht, u të dua mīrë, u të hiripsinjë. Të vẽ mbë duort shpirtin, mendën, trūtë, gjuhën, zëmërën e gjith vetëhënë time.

Gjith vetëhënë time, shpirt e kurm, e vẽ ndën zotërien të duanīs tënde? Ti mba me tënden shëjte hirë pather të gjalla këto tāksura çë nani u bënjë me duanī, prë sa mundinjë, astundurishte.

[27] dulīrë] dhunlīrë.

Imi dashurë Zoti Krisht, Birë i të prëdashures Ëms time Maries, i tagjisurë e i rriturë me t' sajin qumshtë virgjërisht, çë gjith gjellën tënde, kurë qeve burr, e grise [67] po të mirëbënje njerzëvet; përdashurë Jesus, u poka jamë e të mbanjë shtrënguorë mbë zëmërë? O, të qofsha truorë, mbaje Jesus ïmë, mbaje shtrënguorë, mos e lësho ndonjë mot, mos ec llarghu asaj, prë lipisï qëndro me të.

U t' e dhē gjith me duanï të mos të t' e lipinjë mẽ kurraj e, ndose u ndërrofça u, mos u metanos e mos u ndërro ti e mos e le të dal asaj filaqï namuri çë lumsōnë.

Marie, trïshëjte Jëm të Jesusit e Jëma ime, jam' edhe u it bïrë. Mos më lësho ndë kto krede ashtu të paçëmueme, parkales prë mua tët Bïrë po të më shumsonjë hirën e tij!

Harro, o Zot, harro, fëtesat time, pse u i nodhjonjë jo vetëm se janë të liga, moj pse shpëlqenjin tij! Ndëlejëm, o Zot, ndëlëmë[28] prë nderë të atij miri namurë çë më buftove e prë të madhin mallë çë ti gjëllïnë prë atë Jëm çë ti, tue tëhelqurë mbë kriqe, prë Jëm edhe m' e lē mua e si peng asaj e palimëte karitat me k' më deshe prë pather!

Ëm edhe me ndëlemen e mbëkatëvet qëndruomen ndë kto taksura çë bëra, ashtu sa mos u ndafça mẽ o u llarghofsha ka [68] ti e mundça prana, pa trëmbime dreq të t' zbierë, mundça të vinjë të t' trashigonjë atje lart ndë qiell, ku ti rrï e rregjërōn prë gjith stoneonën. Amin.

BËME HIRIPSJE

Çë bënë, zëa ime? E si penxōnë të përgjegjesh ndë mïrïnë ashtu të madhe çë të buftoi Theosi? O Jesus, imi trïëmbël Salvaturë! Ardhura jote mbë mua, tue më sjellurë me tij gjith të mirat, më shtrëngōnë keq të përgjegjemi tue të hiripsurë e tue të dashurë me një namurë çë mos të ketë mbi dhē gjasëme. Të hiripsinjë prë gjith paçenxjen e dhuruomen çë pate prej mua, tue mos ruojturë e mos masurë mbëshuomen e sbesëvet e të mbëkatëvet time.

Sa më bëre mbero e sa mot më dhurove, qe prë nderë të lavomavet tënde e prë nderë të gjakut çë shprishe prë mua, prë cilin aq herë më ngrëjte e më ndëleve. U të hiripsinjë prë madhen mïrie çë më pate, tue më bëgaturë me aq tënde dhëna, rrighale e mïrëbëme. Mbal gjith prana kamë të vẽ e të mbanjë trïlarëten çë m' e bëre tue më lënurë Kurmin e Theosïnë tënde mbë Sakramendin e lartarit. [69]

Të hiripsinjë prë aq namurë çë buftove e më deshe mbal aq të tjerë çë thomse mẽ se u mïrë të deshëtin e besërisht mẽ të shërbienë o keq mẽ pak se u të kanë fëtesurë.

U të hiripsinjë me mallin e me të falëmen mẽ thellishte të zëmërës time e, pse nëng dï e nëng mundinjë të të hiripsinjë po si më ngitej e të perqej prë një pasitē ashtu të madhe çë më bëre, cila qe

[28] Ndëlejëm / ndëlëmë. Variatio.

të vinje mbrënda meje, u përzienjë timet hirīsëme me ato çë bëre ti, o imi Jesus, tit Ati ji stoneonëm e me ato çë të bëri Jëma jote Maria.

Të hiripsëçin edhe prë pjes meje, të laudhofçin e të bekofçin gjith ëngjëlit, gjith shpirtërat të mirë çë qenë, janë e kanë të jenë mbi këtë dhē.

OFËRIME

O imi Theos, ti më dhē gjith vetëhënë tënde mbë Shpirt, Kurm e Theosi. Të jap u edhe gjith zëen time me sa fuqī ajo kā. Të jap kultuomen e të taksinjë të kultonemi pather ka ti. Të jap ndilëgimin e të besinjë të ngudhirinjë njinje njinje penxeret e ligj çë mund e zënë. Të jap dashurīnë e duanīnë me [70] astundurishte rrisollucjon të rrazbisinjë e të nxierë ka vetëhea e tire gjith mallet e dheut çë i mbërparen e të mos dētë e të mos shërbënjë ndomos tij vetëm, Zot i trīmadh e i trīmīrë.

Të jap kurmin timë me të gjith të tijat skise. S' dua të hapinjë mẽ o të adhetinjë sītë po të shoh qëna, bëna o kafsha prikulore çë të fëtesënjin o të dhjavasinjë livëre çë të shpëlqenjin o të vẽ rē ndë bëma të liga e skandalepsore çë më llarghonjin ka ti. Dua të mbëllinjë vesht të mos gjegjënjin mẽ kurraj rrëfieme dhērishte e të kundrelura thjellëmìes të shpirtit e të mirit çë kamë të dua tīmë vëllezërvet të krështē. Të jap golën e gjuhën time të shëjtëruorë me theosorin Kurm tënd e të taksinjë të mos thomë mẽ fjal të shtrëmbura, të rreme o gënjeshtra o prëqeshëme o mallkime o bea të rreme o murmurī o turprī o tjera shorta ndrishe.

Mbë serpos të taksinjë se, prë sa mundinjë me ndihëmen tënde, kamë të bënjë aq sa mos të t' fëtesinjë mẽ jo me skise, jo me kurm e jo me shpirt. [71]

LUSE NAMURI

I trīlaudhuar' imi Jesus, e mund buftonje ndrishe mīrëbëmen e namurīn tënde prë mua, tas çë më dhē gjith vetëhënë tënde ndë trīlartin sakramend të Evkaristies? E qëndronjë u i fëtohëtë edhe me zëmërë e nëng digjemi prë mallë e prë namurë? O theosëmi Jesu Krisht, bëj të dhezet një herë kjō zëmëra ime e të ndihet e të gjegjet e të tundet e të griset vetëm prë tij, ashtu sa mos të çonjë mbë tjera vende ambënī e të daft e të lusëtë e të shërtoft mẽ se kallamitha nëng do të dreqtohet prej pollit; mẽ se i verbëri nëng lutōnë dritën, mẽ se kacamitja nëng dishërōnë kroin kurë gjëndet e lakosurë.

Ëh, Zot, ti erdhe ndë kurmin timë të pushonje. U të dua me gjith zëmërën e shpirtin tīmë, të shtrëngonjë, të llōrinjë, të mbanjë names të zëes e jipemi gjith tij. E ti ëm, prë kurōrë të lipisiavet çë

më bëre njër' nani, ëm të gjëfça mẽ shpejt vëdeqen, ndose kamë të rronjë me fëtes. Bëj çë u nëng lëfsha mẽ ndomos të t' dua me mallë të thellë e të dheztë. [72]

LUSE TË PIEJTURI

Cilat mira nëng mund ellpizonjë u ka ti, o Theos ïmë i miri, tas çë gjith më dhē vetëhënë tënde? Të lusinjë poka e prësëriu të lipinjë, trīdashuri Salvaturë të shpirtit timë, të lipinjë një të gjere ndëleme të gjith timavet mbëkat, çë u nani, me sa kamë ndë zëe fuqī, ji nodhjonjë e i sihjeninjë, e, prë vllepen keq të madhe çë pr' atō meritova, kërkonjë të rriçivirinjë sa mẽ ndulxhenxje mund ghadhnjënjë e të parkalesinjë të më japçë të bën t' i ghadhnjenjë vetëm prë nderë të mīries tënde.

Të lusinjë prë të së tëndin paçëmuem Gjak, çë bashk me Kurmin, me Shpirtin e me Theosīnë tënde riçivirëta somenat, e të lipinjë me mallin çerëprëmisurë jo vetëm të më laç e të më thjellmōç e zbardhçë shpirtin ka gjith kondrat çë ai kā, moj edhe të më japçë fuqīnë e ëndën të mundinjë doqërisht njera ndë vëdeqe tindacjonat.

U të taksinjë e të jap bes, prë sa vëlënjë, të ikinjë kauzjonat çë më qellënjin ndë fëtesa. Moj ti njeh se u prë vetëhënë nëng mundinjë gjẽ, prë këtë lutinjë e truhemi ndihëmes të gjakut tënd e tëndes fuqī. [73]

Njotani se u të rrī përpara i vobkë e i xheshurë gjith virtutashit tue të lipurë hīrë e lipisī. Ti tagjis, ngjallë e ngos mua të dekururin. Dhez me zjarrin e tëndit namurë timen fëtohsī e me dritën e paraqënurës tënde ndrit timen errësīrë. Prirëm mbë thartīrë gjith pëlqemet e dheut, ëm të qellinjë me paçenxje rëndërītë e dhurimet çë më mbërparen tek gjella e bëj të harronjë gjith kreosëmet shërbise çë janë këtu posht e ngrëj shpirtin e zëmërën time po të kërkonjë tij e mos i le të venë këtu e këtje, tue u zbjerrurë te kjo jet. Tek ti vet bëj të gjënjë çë sod e pārë ëmblësīnë, pse ti vetëm jē të ngrënëtë e të pīrëtë timë. Ti jē malli e harea ime. Ti më oreksën, ti më ëmblësōnë e butën, ti më mīrëbënë.

Të lusinjë mbë serpos, nani, o Zoti Krisht, të më japçë shëndetën të shpirtit e të kurmit, të njoh mẽ mīrë madhīnë tënde, e gjith hirin të lipinjë, çë ti mẽ mīrë se u njeh se më lipset, po të doksonjë, me hjenë çë të perqet, zotërien tënde. E përpara të rrëzoheç po të vēç ka kurmi ïmë, truhemi të bekoç shpirtin e bëmat time. Aq lusinjë, aq dishëronjë, aq dua prë gjith [74] gjellën time njera herën e të vëdeqes, ndaj cilsë u qasemi ka dit, ka herë e ka njëmend me të madhe vrapëtie. Ruojëm ahiena ka gjith tendacjonat e ëm hirë e fuqī të i mundinjë e të i rrazbisinjë e përmëto të më shokinjë nd' at herë ashtu prikulore jotja e imja trishëjte Jëmë Maria.

Truhemi edhe lipisies tënde theosore të mos më lërë prë gjërtuome[29] të së timëvet mbëkata e prë pakën rreverenxje çë pata tue u qasurë trīshëjtes Evkaristie e të kungimëvet të liga çë bëra.

[29] gjërtuome] gjërrtuome.

Truhemi të mos më lẽrë[30] lipisia jote të nisemi ka kjo gjellë pa ndihëmen e të shëjtevet sakramende. E këtë hirë, ndose të duket mirë e dreqtë justixjes tënde, bëja edhe gjith njerzëvet prë cilëtë shprishe gjakun e grise gjellën tënde theosore e paçëmueme.

LUSE TË LUMES MARIE

Lipisjare Virgjërë Marie, Jëm' e Theosit, Rregjëresha e qiellit e të dheut, krua i mburōmë e të mīries, u të parkalesinjë çë, prë nderë të jëmëries tënde e të atij moti çë e solle ndë prëhërë të paftes [75] Zotin Krisht, të parkalesinjë të më ndihçë edhe ti me hirën tënde po të dërtohet zëmëra ime ashtu sa të mund e daft e të e shërbeft' me shpirtin e kurmin të këthjellëm e pa mosnjë vix o një mbëkat, allmonu asoj çë gramisënjin ndë deqen stoneonëme.

Bëj edhe të mund ghadhnjefça ato virtuta e urtëria çë ti njeh se më lipsen të mundinjë o të lẽ ato vixe çë më dëmsonjin shëndetën time shpirtulore e kurmërishte. Çel ndë zëmërën time një namurë të doq prë tij e prë tët Birë ashtu sa u mbë të rrofça, mbë të dësha e u salvofça.

Kulëtou, o Jëm lipisjare, se ti jē avokata ime pas tīt Biri, tët Dhëndërri e tët Ati e, mos ti fllet e lusën e parkalesën prë mua, kush më qëndrōnë? Gjërtuomet ahiena e vllepet të bienë mbë mua, si breshëri ndë monostrofat e dragonaret dimërore, e u keq i meritonjë, pse fëtesa, e ndihëma jote, fjala jote, lipisia jote ësht ajo çë mund më sallvonjë.

Trīëmble Jëm, thellis ndë zëmërën time namurin tënd e ëm një nishānë të mos mund e harronjë kurraj. Trīshëjti[31] [76] ëmër' it, o Marie, pather bumbllift ndë lavrat time e mos harrofça ndonjë herë të e thomë e të e thërres me rreverenxje e me mallë, bashk me atë të Zotit Krisht, ka dit, ka herë e ka njëmend e të kemë ashtu ellpize se, po si gjëllījta tue lusurë e tue thërriturë juve, kështu dekça ndër llōrë e mbë duorë tëja. Amin.

Ëngjëllit strazetārë e avoketëvet

Hjeshëm Pringjip i qiellsores gjerarhjī, çë prë një mīrie, cila s' kā thëni, të tīnë Zoti më qeve dhënë po të më ruoç; shëjtëra e shëjtresha të qiellit, cilëtë u zgjodha prë avoket e patit[32] lipisīnë të më gjegjëjit, parkalesëni edhe ju prë mua Theosin po të më jap hirën të mbahemi besullōrë ndë rrisollucjona çë mora e ndë taksura çë bëra somenat tue ngrënë Kurmin të theosëm së tij.

[30] l rë] lūrë.
[31] Trīshëjti] Trīshëtii.
[32] patit] paftit.

Prë shpirtërat' e përghatuorit

TRUOME

Pafçë lipisī, të parkalesinjë, o Zot, prë zëat çë janë e lëngonjin të llargha ka ti ndër lambsat zjarrishta të përghatuorit. Ato janë bila tënde e ti buftove se mīrë i do. Thërriti poka me hirën [77] tënde pa serpos po të vinjin të trashigonjin pamen e faqes tënde prë me u ruojturë e prë me u dashurë, lumsoji me buftuomen e fōrëmadhies tënde, o trīëmbli e trīfuqisëmi Theos, edhe, ndose të duket mīrë, bëji pjes ka ndulxhenxjet çë prë tënden lipisī kamë ghadhënjierë ndë Kungimin çë bëra somenat.

PARKALESE

Shpirt' i Jesu Krishtit, shëjtërōmë.
Kurm' i Zotit Krisht, salëvōmë.
Gjak i Jesu Krishtit, dējëm.
Ujtë e brinjëzëvet të Krishtit, lajëm.
Dhuromja e të Krishtit, ndihëm.
O i miri Jesus, gjegjëm.
Mbrënda ndër lavomat tënde fshehëm.
Mos më le të ndahemi ka ti.
Ka i ligu ruojëm.
Mbë herë të vëdeqes time thërritëm e kumando se të vīfsha tek ti po të t' doksinjë e laudhonjë me gjith ëngjëlit e shëjtit prë gjith jetën e stoneonëme. Amin. [78]

PARKALESE
prë ka një dit të gjith javs

Prë të Diallën

LUSE SË TRĪSHËJTES TRĪNITAT

O je shëjte Trīnitat,
shëjt Bir e Shpirt e Jat
mbë një Theos, tas trī vet,
ti ndë zëmërë mua vërtet
bes, ellpize e karitat
dhezëm, o shëjte Trīnitat.

U të latrīzonjë, të laudhonjë e të bekonjë, Jātë, Bīrë e Shpirt' i Shëjt, trī vet mbë një i vetëm Theos. U të adhoronjë, o Jātë gjith i fuqisëm çë më kreose. U të laudhonjë, Bīrë i theōsëm, imi Zoti Krisht çë më bjejte me gjakun tënd, cili s' kā përbleme. U të bekōnjë, Shëjti Shpirt çë më lajte e më pastrove ndë pagëzimin e më thërrite e më mbjodhe ndë shërbtrīnë tënde.

U përtërīnjë përpāra tij, o Shëjte Trīnitat, ndë prëhërin të kuj jamë, gjëllinjë e tundemi, ngjallinjë e përtërinjë taksurat e të lënat çë bëra kurë qeva i pagëzuorë, ahiena kurë prë tënden trīlarte lipisī, qeva i zgjedhurë [79] e i marrurë prë bīrë e prë rredh të parrajsit. Thomë këtu nani prësëriu e taksinjë me bē se çë sod e parë s' dua të kemë gjẽ bashk me Zatanin, me bëmat e tij o me mbëkatën. Dua të lẽ dheun me të gjith pombat e të taksurat të rreme e gënjesore çë më mbërparën.

S' dua të gjegjinjë mẽ kurmin e skiset, mishëtë e pëlqemet të dhunuome çë duk se ne buftonjin këta e të taksinjë e të jap bes, prë sa mundinjë anës tīme e me ndihmen e të hirit tënd, se kamë të t' dua me gjith vetëhënë time pa mosnjë ndërruome e kamë të gjegjinjë e të bënjë lijruomet e të së tëndit nom po të mund kemë, ashtu tue bërë, gjellën të stoneonëme.

U të hiripsinjë me zëmërë thellë të përtrollëme prë mirëbëmet pa ndimërīm çë pata ka dora jote lipisjare e mẽ se gjith të hiripsinjë prë trīmadhen të mīrë çë më bëre kurë më kreose, kurë më bjejte ka rrobija e të mbëkats prë names të Jesu Krishtit e kurë më leftërove ka prikulit, ku aq herë u gjënda, të mund zbīrësha prë gjith jetën e të jets. Ajlimono, sa më shpëlqënë se nëng t' u përgjegja po si më perqej! U nani metanosemi [80] me thellin e zëmërës time, pse të fëtesa, o imi trīmadhi mīrë. Mbë ktë kred u nodhjonjë sa të shtrëmbura kamë bërë e dhëmbemi[33] prë fëtesat e ksamurītë me k' të shpëlqeva e të lipinjë ndëles e lipisī. A, mos qoft kurraj vërteta çë u të fëtesça mẽ çë sod e pārë e kurraj mangofça të kemë bes e të gjegjinjë urdhëret çë ti më jep me lexhën tënde, o imi Vasilevs e fōrëmadhi Zot.

[33] dhëmbemi] dhëmbenmi.

U të ofërinjë jo vetëm, moj të jap gjith vetëhënë time, penxeret, fjalëtë e shërbiset çë mund kemë prë sod e prë gjith gjellën time. Ti prë lipisī ndihëm e bekōmë, salvōmë e shëjtërōmë me hirin tënd, tue më lefteruorë ka prikulit, ka fëtesat, ka tendacjonat e ka gjith të keqat shpirti e kurmi.

Rrit, o shëjte Trinitat, të truhemi, rrit ndë zëmërën time besën, ellpizën e karitatën e dhez mallin tīmë me namurin tënd po të dua mbal gjith kafshat tij, e afërin timë të e dua si vetëhënë time e dreq si ti, me golën e Jesu Krishtit, m' e kumandove. Ëm haristen, mbë serpos, të ecinjë dreq udhën e lexhs tënde, të bënjë sa më lipset ndë të qënurën time e të mos llarghonem ka të mirëtë njera ndë [81] vëdeqen e arrëfça, tue vaturë ashtu, të t' dua, të t' laudhonjë, të t' bekonjë ndë të lumen stoneon. Amin.

SH. MARIES

Luse prë ndëlemën e të mbëkatëvet

Njota ndë këmb tënde, o Jëm' e Theosit, një i rëndurë me mbëkat, cili mosnjë pasitē, një hirë o një mīrëbëme meritonë. U mbero kamë kufdhenxje e jellpizonjë ndë lipisīnë tënde e të truhemi me madhe bes e spërënx po si një jëmje mund truhet një bīrë, cili gjëndet ndë një lipse të madhe.

Ti nani, o Jëm, aq prë pjes të atij dhëmbimi çë pate e dhurove kurë qelle Zotin Krisht ndë Qish e mbë duorë e lē të pllakut Simeon, aq prë harënë e oreksëme çë pate e trashigove kurë i biri ji Theosit desh t' vinej ka qielli mbë dhē e të mishërohej ndë prëhërin tënd të pafëtes, ti parkales me mallë tët Birë e tët Ātë po të më kenë lipisī e të më ndëlenjin edhe prë nderë tënde mbëkatat e fëtesat gjith. Mos më le, o Jëm, të sellpizuorë, pa ndihëme e të shkret, moj dhezëm [82] namurin çë deshe Zotit Krisht, ndihëm e sallvōmë, se u edhe të jamë birë.

LUSE SH. JANJIT PAGZOSERIT

O bardhsī thjellmije, pasqīrë penitenxje, qetëmia je profetëvet, zanja e Fjals të tīnë Zoti, paravaturi i apostulvet, dritmadhi i dheut, trīdoksëmi shën Janjë, qoft' i bekuorë hiri i ëmërit tënd, qoft' i bekuorë hiri i prindëvet tënd. U hiripsinjë stoneonmin Theos çë bën e të parathirrtin profetërat ëngjëll çë qeve i zgjedhurë të venje përpara tue thirrturë të ardhurën e të Messīs; hiripsinjë të theosëmin Bīrë çë me golën e tij vate tue thënë se ndër të lerit gravet mosnjerī qe ashtu i madh po si ti; hiripsinjë[34] Shpirtin Shëjt, cili të mbjoi ashtu me dhëna qiellsore e me hīrë të gjerë çë ndë shkëfin e sat' ëmi, po të së mund anxëjin mbë tij e të përhapçin e të mburojin edhe mbë prindëtë tënd.

Ndër kaq hīrë çë ti pate, e u nani dica këtu kultova, prë lipisī, të parkalesinjë, bëjëm njëz edhe mua e qoft' ajo të pagzimit të penitenxjes. Ndritëm e bëj të njoh gjith timet mbëkata, tundëm e

[34] Hiripsinjë] Hripsinjë.

skotisëm zëmërën e bëj të i skamallisinjë e të i qanjë me dhëmbime të thelle, e [83] me një taksurë astundurishte të mos i bënjë mẽ kurraj e, tue bër' ashtu lexhën e atij çë ti thërrite me vërtet Qëngj i Theosit, cili u mishërua po të nxīrij fëtesat ka dheu, ardhëça mbë serpos të t' trashigonjë ndë parrajsin, ku bashk me të ti i doksurë mënōnë prë gjith jetën e jetsë. Amin.

ËNGJËLL STRAZETARIT

Ëngjëll çë më ruonë, mos më le të bie ndë mbëkat sod, moj bashk me shëjtet avoket mbāmë dorën sipërë, këshīllëm, ndritëm, levrojëm, fuqisëm, llarghōmë ka gjith të ligat, mallisëm prë të mirat e të dreqtat, shokërōmë ndë udhën e Theosit e qasëm ndë doksen e parrajsit. Amin.

PRË TË HËNËN

LUSE THEOSIT

I stoneonëmi Theos, u me zëmërën të çerëprëmisurë e të meruorë keq njoh se fëtesa tënden the[o]sore fōrëmadhī e mīrie. Andaj sod, ç' ësht e para dit e javs, u të lipinjë ndëles gjith timeshit mbëkata e parkalesinjë lipisīnë tënde aq e mbëdhā të më jap hirin të zẽ të [84] shërbenjë prë mẽ të mirën e shpirtit timë, prë shëndetën e cilit shërbeve edhe ti sa rrove ndë ktë dhē i mishëruorë. Të lusinjë poka, o imi Zot çë më sallvove, të më japçë hirën të dreqtōnjë gjith timet bëna prë mẽ të madhen nderë të dokses [s]ate e të ngjatinjë këtë bëme njera ndë timen vëdeqe.

Zot, u dua të bënjë tënden, jo timen duanī. Andaj të mbërparinjë, si timit krioserë çë jē, shpirtin, kurmin, gjellën e qënurën time me të gjith sa mund kemë prë dheun e prë qiellin. Të truonjë edhe shpirtërat çë gjënden ndë zjarrin e përghatuorit e me luse prana mẽ te dhezurë ata kuj mund i kemë dhënur' u kauzjonë të digjen' atje. Të truonjë ata çë më qenë prind, miq, gjërī o gjitonë o çë më bëtin mirë ndaj shpirtit e ndaj kurmit, po si më urdhërōnë jona shëjte Jëm Qisha; s' dua të harrōnjë armiqtë, o Zot, e gjith ata çë ti dī e do po të t' i truonjë. Të parkalesinjë mbë serpos me mallë të doq e të thellë po të më japçë hirin të bënjë përghatuorin tīmë te ki dhē, ashtu sa ndë timen vëdeqe, prë nderë vet të së tëndes dhëmbsuome gjellë e vëdeqe, u hifça ndë doksen e parrajsit [85] po të t' laudhonjë e të t' bekonjë prë gjith stoneonën. Amin.

SHËN MARIES

prë të t' jap virtutën' e të perseveranxjes

O Rregjëresh e qiellit, trīshëjtja Marī, u çë një mot qeva shërbtōr' i të dhimonit, nani dua të jemë shërbtōr' īt prë sa të gjëllinjë e pa të ndërronemi kurraj. Ti poka mbëjidhëm shërbtōrë, mbajëm e mos më rrazbis, si vërtet e meritonjë. O mëma ime lipisjare e theosore, u mbë tij vendsova gjith

tīmen ellpize. Bekonjë e hiripsinjë tīnë Zot, cili më dha të kemë tek ti aq ellpize e kufdhenxje. Ësht vërtet se prë mōn çë shkoi u murgërisht vajta rē ndë mbëkat, moj nani kamë bes se prë merituomet e Jesu Krishtit e prë lusat tënde kamë qënë i ndëlierë.

Nëng sosën mberō, Mëma ime. Një penxērë më helmōn e ësht se mund priremi të zbierë hirën theosore çë njerë nani më mbajti. Prikulit janë kado vend, armiqtë nëng fjënë e tendacjona të rea më rrëvonjin. A, ndihëm poka, zonja ime e fōrëmadhe, e lefteromë ka gjith kopanētë çë kërkonë të më jap pisa e mos përmëto [86] ç' u rafça prësëriu ndë mbëkata e të ftesinjë tëndin Birë, të the[o]sorin Jesu Krisht. Jo, mos qoft kurraj kjo herë ç' u pafça të zbierë prësëriu shpirtin, parrajsin e Theosin!

Këtë hirë të lipinjë, o Marie, këtë dua, këto bëj të kemë ka Theosi, po si māllmadhe lipisjare Jëm çë më jē. Ashtu ellpizonjë. Amin.

LUSE

SHËND LLIXHIT GHONXAGH

Ëngjëllōri trim, imi përdashurë ndihonjërë Sh. Llixh, po si avokatit tīmë mẽ të fuqisëm e përgjunjemi e të tëfalinjë. Thellisht përbingemi tij e të adhoronjë. Bekōnjë trīshëjten Trinitat çë të pastroj me aq pasitē shpirtin e ashtu thavmasisht t' e ngrakoi virtutashi ndrishe eroiha e të e bukuroi prana me penitenxjen ndë tënde[n] mẽ të njomthe ghanjunī. U hiripsinjë stoneonin Jātë, cili mbi tij u hareps po si mbi një bīrë keq i njohurë e i mīrë. Hirīpsinjë të Birin, çë mbë tij gjënë një pemë aq e pjekurë e këthjellme të gjakut së tij. Hiripsinjë Shëjtin Shpirt çë mbë zëmërën tënde të vogëlëz edhe çeli aq zjarr karitatje.

Prë atë penitenxje [87] prana ashtu thavmasore, pr' atë paftesī ashtu të larëte, pr' atë namurë ashtu të doq prej tīnë Zoti me k' kuazi u grise, të parkalesinjë të lipçë prë pjes meje Theosit të më bënjë hirë e të më jap një metanī të gjerë e të thelle gjith mbëkatashit, një thjellëmī trūshi e kurmi mẽ e llargha çë mund gjëndet ka fëtesat. Të truhemi edhe të më kēç e të më mbaç prë shërbtōrë e të më ruoç gjellën ka gjith penxeret, thënat e bënat çë mund shpëlqenjin duanīs të tīnë Zoti e të më shokëroç ndë vëdeqen. Të lipinjë me dishërīm të dhezurë shum të më japçë hirën e paçenxjes, të dhurimes e të butësies, virtutat theollojishte e kardinallishte, ashtu po të mund gjëllifça si krështerë i dreqt' e i mīrë e të arrëfça pëstaj të trashigonjë prej të asaj dokse çë të dha Theosi ndë parrajsin. Amin.

Mbllihet parkalesa e ksaj dit, po si gjith të tjerat çë vinjin pas, njera ndë të shtunën, me lusën e ëngjëllit strazetarë e të shëjtëvet avoket, po si ësht e shkruojturë tek fjeta 64, 76, e 83, e mbarohet tue thënurë një Ini Jatë, Agëzuosh *e* Kamë bes, *eç. Shih tek fjeta 24.* [88]

PRË TË MARRËN

LUSE THEOSIT

Imi Theos, u mbërparemi sod tij e, përgjunjurë prej tënden theosore madhërī, skamallisinjë faregjëin çë jamë, zbulōnjë fuqīnë çë nëng kamë e vobksien çë më shtrëngonë. Truhemi mbero tij, krua i mburōm' ëmbëlsije, e të parkalesinjë të më japçë ujtë e hirës' [s]ate, me cilin mund të lanjë timet kondrepsī, mund metanosemi fëtesashit, mund marr bē me rrisollucjōn të mos bie mẽ ndë mbëkata e mund salvohemi; mund shërtonjë gjith ditën harīstën tënde e të e parkalesinjë të më ndëlenjë gjith të shtrëmburat çë bëra, të më gatinjë e të më sheshinjë udhën e qiellit e të më hapinjë derën e të parrajsit. Amin.

Sh. Mikēllë, Sh. Rrafēllë, Sh. Ghabriēllë, qefallī të rregjërīs qiellsore, pafçi edhe ju valandie prë mua, tue llarghuorë ka u dhimonin e tendacjonat, me k' zakonisën të më luftonjë, tue më ruojturë ju shpirtin e kurmin ka sëmundat e prikulit gjith shortashi, tue më mbajturë pa [89] fëtesa, jo të rënda, jo të leza, e tue shokuorë pas vëdeqen shpirtin tīmë përpara tīnë Zoti. Amin.

LUSE SH. MARIES

prë vëdeqen ambnore e je shëjte

O Marie, trīshëjte Jëmë mīrërie e keq shum e lipisjare, u, tue penxuorë mbëkatat tīme e të rënda e pa nëmrīm, tue kultuorë kredin e të vëdeqes time, dridhemi, drohemi e çotjasemi. O Mëma ime ëmbëlore, mbë gjakun e Jesu Krishtit e mbë ellpizen çë mund kemë ndë ndihmen tënde kumbiset gjella ime.

O levromsore e të lënguomvet, mos më lësho ahiena, kurë të më lipset mẽ levrojma jote theosore. Ndose nani më shtërgōnë ashtu keq rrodhia e fëtesavet çë bëra ndë motin çë shkoi, trëmbima të mund bie prësëriu, ëhojou ndose qofça i ndëlierë, tramaksia e të prikulvet çë më rrethnjin, kanosia e justixjes keq e dreqte të Theosit, çë të jetë ahiena meje?

O, Zonjë, më parë se të rrëvonjë hera e vëdeqes time, lusëm ka īnë Zot e bëj të kemë një dhëmbime të madhe e të doqe mbëkatashit, [90] një rrisollucjon të mos të bie mẽ e të mbërparinjë e të ofërīnjë Theosit gjith gjellën çë më qëndrōnë me bes astundurishte të mos ndërronjë kurraj duanie. E prana, kurë të vinjë ndë herën e të vëdeqes time, o Marie, ellpiza ime, ahiena levrōmë, ndihëm, rri afërë meje, buftōmë faqen tënde, ëmblësōmë dhurimet, shkurtōmë të helqëmen, vogëlōmë trëmbimet, madhëm hirën, rritëm besën, çelëm ellpizen e, tue thërriturë e tue parë tij, bëj të lërenjë shpirtin ndë duorë tënde. Këtë hīrë ti ja bëre shum të tjerëve çë të qenë dhivote e u ni ellpizonjë e kamë bes se ti lipisjare do të m' e bëfçë edhe mua, po me gjith se nëng e meritonjë, moj kē t' m' e bëfçë prë tënden jëmsore lipisī. Qoft' ashtu.

Ëngjëll kustodhit, po si qe thënë.

LUSE
SHËND ANDONIT TË PADHUES

O Ndōnë, llumbardhez bukurushe pa mosnjë mallixje o ligërī, çë prë dulinë e të së tëndes gjellë e saftesëme e prë këthjellmien të së tëndes shpirtulore bardhī, prë të dhezërin tënd namurë e prë [91] të e pangarën tënde virgjërie, u gjave atij Qëngji pa mosnjë fëtes, cili u lē ka virgjëria, e prë s' andaj meritove t' ishënje i llōruerë e i harepsurë keq ëmbëlisht ka ai, me një të buftuome shum të madhe namuri, dua të thōmë ka Jesusi, cili si djalith i bukurë mẽ se bukuria erdh e t' u vū mbë llōrë e tue të harepsurë bën e harrove dheun e të qelli ndë një dejt i prëthēllë hareje çë së mund rrëfihet, pse të ngrëjti mbi gjith të qënuren e njërëzies e të ndërroi thartirën e ksaj gjellë mbë një parrajs i oreksëm e i hirëm, ashtu çë së mund jetë zbuluorë o i dhënurë ndomos ka Theosi çë mundën gjith. Vërteta thavmasī e trīlarëte! Mbajte si djal mbë duorë Jesu Krishtin. Qeve i mbajturë e i harepsurë mẽ se vllā ka Jesu Krishti!

Andāj prana zotërove fizīnë, lekūnde malet, qëndrove lumet, pikse dejtet, shprishe monostrofat, thjellmojte qiellin, dulīrëte sqotat, thërrite shiun, predhikove peshkëvet, munde shpirtërat e huaj e i ngudhirëte kurmshit të krështerëvet, shërove sëmurmit, dreqtove ghroçërat, ndrite të verbërit, bën e folëtin të vuvurit, bën e gjegjëtin të shurdhurit, ngjalle[35] [92] të vëdekurit!

Ailimono, avokat' īmë i miri, prë sa qeve pjono virtuta, qiellsoreç dhëna e me hīrë ti, aq jamë i lig, i vobek, i ftesurë e i s'hiripsurë u. Andaj pafçë lipisī meje e ndër të tjerat thavmasī çë bëre përziej edhe këtë jetërën, dua të thomë: me fuqinë tënde qiellsore ndërrōmë zëmërën e gjellën, me një të vet së tëndit hīrë dërtōmë shpirtin. Ai Corrobillith qiellsorë çë ti mbajte ndë duorë nëng të arrnjisōnë gjẽ ka sa mund i lipçë e një truome çë t' i bëfçë ti prë mua vëlënë e sosën të më bënjë pafëtes, të më hapinjë parrajsin e të më lumsonjë prë gjith motin pa mosnjë serpos.

PRË TË MËRKURËN

LUSE THEOSIT

Fōrëmadhi j'imi Zot, u dī e skamallisinjë përpara tij se ndë një dit si kjo e sodëme ti, tas i mishëruorë, qeve i tradhizuerë[36] e i shitërë mbë Jesusin, tët Bīrë, e bëre ashtu po të bjejnje shpirtin tīmë. Andaj nani u të lusinjë të më përzieç ndë trīmadhen të bjejme çë ti erëdhe të bënje me të shiturën e vetëjuj [93] e prë nderë të asaj ëm ndëlemen e mbëkatëvet e hirën të mundinjë mbaru tendacjonat e të mishit e skiset e kurmit çë luftonjin ligjën e shpirtit. Prë nderë të shëjtes burrërī tënde pafçë lipisī meje e mbëjidh e mba prë penitenxje e metanie të mbëkatëvet, çë kamë bërë, vllepet, shërbemet, punuomet e sëmundat e kurmit tīmë.

---

[35] ngjalle] ngjallëlle.
[36] Si noti il dittongo *-ue-*.

Mẽ tepërë pra të lusinjë të marrëç e të mbjedhç ato çë kamë të dhuronjë e të psonjë ndë ktë dit. Zoti Krisht' īmë, u të mbërparinjë kurmin tīmë. Ti g[j]ërtoje, rrihe e ndreqe si mẽ të duaç me zjarrin e dhurimevet. Jipi mbero fuqī të i pres me parandrequrë, të i marr me paçenxje, të i bënjë pa të përtohet o të lodhet e prana, prë nderë të trīshëjtit kurm tënd, lëmë të vinjë të këmë pjes ndë doksen çë ti takse atirëve çë zgjodhe prë rredhitatën tënde e çë dreqisht bëtin tënden duanī. Amin.

LUSE SHËN MARIES

prë të lefteruomen ka pisa

O Jëm e Theosit, trīshëjte Marie, sa herë u prë fëtesat time nëng kamë [94] merituorë pisën? U thomse çë ndë të parën time mbëkat kishnja qënë gramisurë, ndomos ti lipisjare nëng të kishnje qëndruorë dorën, me ligj e të nxirrepsurë, të sët Biri e mënuorë kopanenë e justixjes të së tij! E pra, tuke mundurë e njomisurë gurëtīnë time, më ngrëjte të keshnja kufdhenxje mẽ të gjere ndër tënden mīrie. Ajlimono, e kush e dī ndë sa të jetëra fëtesa e bëma të mbëkatëme mun të keshnja rīraturë anamesa aq kauzjona çë pata po të t' fëtesënja, ndomos nëng më kishënje mbajturë dorën ngrah ti!

Prëdashura Mëma ime, aq herë thomse më salvove po se gurëz mund jenë ndër zalet e dejtëvet e fjeta mund kenë lisëtë, tue lipurë prë mua hīrë ka īnë Zot? O Rregjëresha ime, çë më vëlenjin gjith këto të mira çë më bëre e hīrë çë më dhē e pasitē çë më ndëjte njera nani, ndose pëstajna vinjë të i zbierë gjith një herje e prë pather? U të desha, pas tīnë Zot, e të dua mbal gjith të tjerat kriathira e, ndose ndonjë herë të kamë manguorë, e kā qënë pa uhojo mẽ se një, ti më ndëleve. Ndok ni edhe të më ndëlēç prë lipisīn trīmadhe [95] çë kē e mos përmëto kurraj të të prīerë kraht ndonjë mot e të mos të dua tīj e Theosin, cili prë nderë tënde edhe aq lipisī më pati e aq herë më ndëleu.

Zonja ime e përdashura, mos le të jetë kurraj çë u ndonjë herë pafça të t' kemë mbë nodhje o të t' mallkonjë prë pather ndë pis. Jo, Mëma ime, jo. Si të t' e bënjë zëmëra të shohçë dëmtuorë ndë lëngime pa serpos një kriathīrë e ligjëme, cila një mot jo vetëm se të lusi, të thërriti e të deshi e shërbtreshe të qe, t' ësht Bil edhe e të lusën, të kërkōnë, të thërret e të do, sido të jetë? Çë më thua, o Marie? Zbiremi poka u? Jo më thot zëmëra, ellpiza e besa, pse zbiremi vet ndose të lẽ, ndose mẽ nëng të dua. Moj kush kā shpirt mẽ të t' lërenjë? Kush mund harronjë mīrien tënde, prana çë e njohu një herë?

Si mund harronj' u pasitetë çë më bëre, hirën çë më derdhe, namurin çë më solle, shëndetën çë më prore, ndëlemen çë më ndëjte? Jo, nëng mund zbiret kush truhet me bes e me mallë ka dita tij, o Marie. Mëma ime, ellpiza ime, gjella ime mos më le kurraj të jemë i zoti i vetëjuj, po zonjërōmë ti, mbamë ti, shtrëngōmë ti. [96]

Bëj çë ndër lipset time thërrefça pather tij ashtu sa me ëmërin tënd ndë zëmërë, ndë gol, ndë buz, ndë fjala e ndë penxere gjëllifça e vëdekça edhe ashtu, llarghu ka mbëkata e llarghu ka pisa.

PARKALESE

SHËND ZEPS

Trīdoksuri Patriark Sh. Zep, shok i fanëmīrë të Maries, shum dreqërisht i mbajturë prë jātë, si mbë vërteta qeve ndaj Lexhën, i Jesu Krishtit, Shelbuès i gjith dheut. Ti çë qeve mẽ i fanëmīri ndë gjith burrat, ti çë tue lloruorë Zotin Krisht trashigove ëmblisht parrajsin mẽ parë se moti, prë ato virtuta çë të ngrëjtin keq lartë e të qellëtin nd' at ghradh ashtu të nderëm' e të shkëlqemë po të jēç një ka mẽ të mbdhenjëtë qefalī të qiellsores gjerarhjī. Të parkalesinjë të më kēç k' ai Zot i sëmadh çë faregjẽ tij arrnjisōnë kurë e lusën, të më kēç hirën të ndëlemes të mbëkatëvet gjith çë bëra. Lejëm edhe të qasinjë virtutat tënde e bëj të t' gjas ndë gjellë të paftesëme çë ti shkove kurë qeve mbi dhē e ashtu vafça tuke u mbërparturë udhës të [97] parrajsit.

Ndihëma jote më dhëft' atë fuqī çë duhet po të mundinjë luftat e të armikut i pisëruomë, aq ndë motin çë rronjë ndë ktë jet po sa ndë vëdeqen, e mbal gjith truhemi tij të më shokroç nd' at vā keq i ngusht e i gjëmbisurë e nd' at herë ashtu prikulore e hirën çë të lipinjë ka t' m' e bëfçë prë nderë e prë doks të asaj vëdeqe ëmbëlore çë ti bëre ndër duorë të Zotit Krisht e ndër llōrë të Zonjësë Sh. Marie, ashtu sa, po si ti u nise ka kjo gjellë pa mosnjë dhëmbimë o trandaksī e hire tek jetëra e pjono hajdhī e oreks, u prë hirën tënde lërefça edhe shpirtin tīmë ndër duorë të Jesu Krishtit e ndë prëhërë të Maries, qiellsore Rregjëresh.

LUSE PRË DITËN E T'ËNJËTES

THEOSIT

Zot' īmë, Theos' īmë, ti ndë një dit si kjo e sodëme lajte këmbtë apostulvet me një karitat të dhezurë e me një umilltat mistikosëme e të thelle. Si sod edhe darkove me dhishipulit e na lē mbë trīshëjtin e shëndoshëm Sakramend Kurmin e Gjakun tënd, mbë speçjet të buks e të [98] verësë. Ndë ktë dit edhe u hipe ndë qiellin i doksuorë e i oreksëm po të rregjërōsh me Jatin tënd i stoneonëm ndë një rregjërī të pa serpos. Mbero, Zoti Theos īmë, u të parkalesinjë me mallë të dhezurë e të thellë të më dërtofçë, të më lāç e të m' pastrōç dijturen me lotët e vetëjuj e të më qërofçë zëen gjith malleshit të dheut, të më e qëroç mbëkatashit po të mund harë me rreverenxjen çë lipset bukën ëngjëllore. I ngosurë prana ashtu imi shpirt e i shëjtëruorë me kurmin tënd i trīshëjt, u hiptë bashk me ëngjëllit ndë qiellë të trashigonjë doksën, oreksëm e harënë të stoneonëmes tënde theosī e burrërī. Amin.

LUSE SH. MARIES

po të t' jap harënë e parrajsit

O Rregjëresha e të parrajsit, çë qeve je ngrëjturë pas tënë Zoti ndër gjith kriathirat të shëjtëruome, ka kjo llak murgërīsh të falinjë u i mierë e i zī e i mbëkatëruom e të parkalesinjë të prierçë prej meje ato sī tënde lipisjare. Ruoj, o Marie, ndër sa prikul u nani gjëndemi e thomse ndër shum të tjerë kamë të [99] përpiqemi prë sa të rronjë ndë ktë gjellë e thomse mund madhen aq të mund bënjin të zbierë shpirtin, parrajsin, doksën e stoneonëme, tij e Theosin.

Mbë tij, zonja ime, u kumbisa timen ellpīze. U të dua e shërtonjë kredin të vinjë të t' shoh e të t' laudhonjë bashk me shëjtit e ëngjëlit ndë parrajsin. O Marie, kurë të jetë kjo herë të shihemi i përgjunjurë ndë këmb tënde? Kurë të puthinjë atë dorë me cilën aq hariste më bëre? Vërtet ësht, Mëma ime, se u nëng u përgjegja ndë namurë me mallë të doq, po si më ngitej, e i gjava dejtrorit, cili i lefteruorë ka një monostrof e ka suvalat, puthën shurën e truollin, kurë të parën herë ka ujet të teramonisëta vẽ këmbën mbi dhē e taksën të mos priret mẽ mbi dejtin, e prana, shkuorë ca mot, priret mbi të.

Moj u qeva e jamë anamesa kauzjonavet e, si nëng u mbajta, trëmbemi edhe se monu mbahemi besullorë ndë taksura namuri çë të bëra prë motin çë të vinjë. Andaj të lusinjë me të gjith fuqīnë të zëes e të kurmit tīmë po të më kēç ka īnë Zot metanien e mbëkatëvet, të më thjellmoç me një hīrë qiellsore dijturen e prana, ndose të pëlqënë, të më thërreç ndër parrajsin ku [100] pa mosnjë ndërruome mund të njoh, të t' ruonjë, të t' dua, të t' bekonjë e laudhonjë prë pather e të paguonjë ashtu atë mot çë kamë mbeturë mbi dhē me zëmërën të zbjerrurë pas tjera malle, dishërime je namurë. Zonjë e fōrëmadhe, prë nderë të gjakut të i Jesu Krishtit, ngjallë e dhez ellpizen time, ëm shpirtin e t' urats, fuqisëm besën e karitatën e bëmë hirën çë të lipa, ndose nëng gjëndet ndrishe duanies të tīnë Zoti, cila qoft' e bẽrë pather mbi mua e mbi dheun gjith, pse, si do të jetë, pather ësht e mirë, e dreqt e je shëjte, si duania të një Theosi i trīlarëtë[37], i trīmadh e i trīfuqisëm kā të jetë.

LUSE

SH. VASILIT PESHPËK

Trīdoksëmi Sh. Vasil, peshpëk' i trīlart, drit e prëshkëlqeme e sëmadhe nderë të së shëjtes Qish, me fuqīnë e urtërinë çë tij shërbienë po të mundënje e të butësonje nxërrën e thartirën farmëkore të perendorit Vallend e të kallëzonje fuqien gjithmundore të tinë Zoti e të porsinje e të urtëronje të biltë e Qishsë të Kapadhoçes e të rronje një gjellë ashtu [101] të gjate[38] ndë names psimevet ndrishe të idhuna e të ngurëta çë dhurove; me atë fuqī, të parkalesinjë, e me atë urtërī mirr të dreqtōç e të pastrōç mua të meruomin, çë pa fuqī e urtërī vete i zmarmarturë këtej e atena pas valandītë e

[37] trīlarëtë] trīharëtë.

[38] In realtà San Basilio (330-379) morì a meno di 50 anni.

dheut e skiset e kurmit, cilëtë gjith ditën më llarghonjin ka lexha e tīnë Zoti e më xarrisënjin ndë mbëkata pa ndimërīm.

Ti, o sëmadhi Sh. Vasil, ti urtërōmë trūtë, ndritëm mendëm, dërtōmë zëmërën, pastrōmë shpirtin e, ndose prë fëtesat time të rënda meritonjë të jemë i dërguorë ndë pisën, mbërparu ti Theosit kurë çë rrī të thetë dëmtuomen time e, si me një thavmasī të madhe nëng bën e arvoi të shkruonej Vallendi dëmtuomen tënde po të jeshënje i ostraçizmurë, ashtu edhe ahiena me një të truome të doqe e të dhezurë qëndro dorën e tinë Zoti kurë daftë po të shkruonjë dëmtuomen time. Ngitëm prë kaq ti zëen e lem të njoh fëtesat çë bëra, lakosëm zëmërën me dhëmbime trīdoqe e bëj të i qanjë me lot të tharëta e me të thelle metanī, lëmë të bënjë rrisollucjon të mos bie mẽ e të mënonjë ndë ktë qënure prë sa të rronjë e të gjëllinjë [102] e të mund vëdekça edhe tue u metanosurë mbëkatashit. Amin.

PRË TË PRËMËTEN

LUSE THEOSIT

Imi triëmbëli shelbués Jesus, njota se u i meruorë pjono fëtes buftohemi përpara tij ndë ktë dit, tek cila ti zgjodhe të vëdisënje po të rrënonje mbëkatën time e të më trajtonje pllasin e doksjes qiellsore. U somenat të parkalesinjë me mallë të dhezurë e të doq po të më bëfçë pjes të dhëmbimëvet çë ti dhurove ndë kurmin e ndë shpirtin, kurë qeve i lakosurë, gozhdjasurë, e vëdiqe ndë kriqe e të më japçë fuqī po të qellinjë me oreks kriqen e të penitenxjes, të mos kēmë mallë me mosnjë pëlqeme dheu o skise kurmi.

Bëjëm hirën, Zoti īmë, të ndienjë e të qellinjë ndë zëmërë psomet e dhurimet të vëdeqes tënde si ji qelli shëjtja Mathalënë, cila gjëndej mbë këmb të së tëndes kriqe. Bëj të njoh e të ndilgonjë sa vëleu jotja vëdeqe, po si e njohu e ndilgoi vjedhtari i mīrë, çë vëdiq bashk me tij e, po si atij të mbëkatëruomi çë të parkalesij i ndëleve [103] fëtesat, i takse e i dhē parrajsin, ashtu prë nderën e asaj vëdeqe ndële fëtesat time. Lakosëm zëmërën me dhëmbime të thelle, bëj të metanosemi e të i qanjë e pra, i lajturë lotëshit e i pastruorë si tij të perqet, bëj të vinjë të oreksemi e të harepsemi ndë doksën e parrajsit e ndë tënden lumsore pame. Amin.

LUSE SH. MARIES

po të jap hirën të duomi mirë

JESU KRISHTIN

O Marie, ti jē kriathira mẽ e larëte, mẽ e forëmadhe, mẽ e ghavnare, mẽ e thjellmja[39], e mẽ dulira, bukura e je shëjtja pas tīnë Zoti. O, ndose gjith të njihjin, Zonja ime, të t' duojin po si ti meritōnë! Moj u levrohemi se aq shpirtëra të lumsurë ndë qiell e aq të tjerë çë janë të dreqtë mbi dhē gjëllinjin

[39] Variatio. Dall'indeterminato al determinato.

të mallisurë prë bukurīnë keq e mīrë çë ti kē. Mbal gjithsej prana harepsemi se īnë Zot prë vetëhēnë do mẽ mīrë tij se ëngjëlit gjith e njerëzit e të dheut. Rregjëresh keq prë me u dashurë, u i murg e i mbëkatëruomë të dua mirë edhe, moj keq pak. Doja andaj të keshënja një [104] namurë mẽ të njomith e mẽ të thellë prej tij. Bëm ti, Zonja ime, hirën të e kemë, pse ata të fanëmirë çë janë të dashurë e duanë mīrë tij kanë një peng të mbëdhā predhestinacjon'je, pse īnë Zot këtë namurë ja jep vetëm atireve çë salvohen.

Zonja ime lipisjare, u shihemi keq i mbajturë ka të mirat e të dheut e këta më shuonjin dashurīnë çë kesh t' keshnja prej tët Biri, cili gjith ditën me duorë të hapta të mira më derdhën e ligj më mbërparën të e dua mīrë shum shum. U s' dī të përgjegjemi ndë ktë mbituome dashurije me k' më thërret ai, ndomos me fëtohsī e brimte çë tramaksën. Ngrohëme ti, Mëma ime, zëmërën, ngrohëme ti me zjarrin e të dashuries tënde qiellsore, shkule këtena aposhtaz e prire alartaz. Lidhe e shtrëngoje me zinxira çë së mun të çahen, po të detë vetëm Zotin Krisht e jo mẽ gjẽ.

Krua i mburuomë namurije, u nëng të lipinjë bëgatërī, nëng të pienjë ndera, doksa, dhëna, rrighale, pasītē o të mira dhērishte, moj të pienjë atë çë mẽ dishërōnë edhe zëmëra jote, dua të thomë namurin vetëm të Theosit. S' e kamë bes, Jëma ime, se ti nëng më ndihën po të mun shohça [105] të ngosurë këtë dishërim çë kamë ndë zëe, e cila u e dī se keq të pëllqēnë. Jo, ti jē Jëm, e jëma, sido të jetë, merr vesh lusat e të së bilvet e i jep atë çë dishëronjin të dreqti e të miri. Parkales poka, o Marie, parkales tët Bīrë të më jap hirën të e dua mẽ se vetëhēnë time e, tue dashurë atë bashk me tij e tij bashk me ktë, arrëfça mbë serpos të ju dua pa mos mẽ ndërruome ndë parrajsin. Amin.

LUSE

SHËN THANASIT

Illë ji trīshkëlqemë të shëjtes Qish, pasqirë paçenxje, mal virtutje, krua urtërije, martiriu i besjes, shtëpia e të dhurimëvet, shën Thanas keq i mīrë, nani çë ti mbë qiellë trashigōnë atë ambënī çë të qe e luftuorë ka vidhja e ka zilia mbi dhē, kultou meje çë lëngonjë ndë ktë gjellë ndrishe luftashi. E mẽ tepërë truhemi ndihëmes tënde u çë thomse mbi të tjerëtë pothimisinjë[40] hirën e ambënies të shpirtit e të kurmit e, mos mund e kemë prë vllep të së timëvet mbëkat, bëj të më jap fuqīnë allmonu Theosi të i dhuronjë e [106] të i qellinjë me paçenxje, po si ti dhurove e me paçenxje qelle gjith ato të liga çë të thanë e të bëtin gjith armiqtë tënd e të së shëjtes bes.

E po si ti shkove anamesa atirëve pa të kondrepsëçe me nxërr, me nodhje o me llastimī, moj si ari e rëgjëndi mbë zjarr o hekuri ndë grihen mẽ u limothe, u këthjellte, u bukurove, ashtu, tuke shkuorë u prë names zjarrin e të vllepevet të këtij dheu, pafça të vinjë mbë serpos të trashigonjë bashk me tij pamen lumsore të tīnë Zoti prë gjith jetën e jets. Amin.

[40] Dal greco *epithymeō*.

PRË TË SHTUNËN

LUSE THEOSIT

Theos īmë, u njoh e skamallisinjë se jām' ai çë të fëtesa keq rëndërisht e pa njohunie. Mbero, pa të zbierë o të mbitinjë ellpizen, u të lutinjë ndë ktë dit, ndë cilën ti desh t' mënonje ndën varrin me kurmin, e me shpirtin harepse e lumsove levruomeshi çë s' kānë thëni shpirtërat e asīsh shëjte jatëraç çë dergjëshin ndë limbin, u të parkalesinjë nani çë, prë nderë të asaj bëmje, pafçë lipisīnë të më japçë pushimin e [107] dijtures, levruomen të shpirtit e të kurmit, prë sa ti njeh se mund më lipset e mund më vëlënjë prë shëndetën të stoneonëme.

Zot' īmë, u të mbërparinjë gjith punet e shërbemet çë sod kamë të bënjë e parkalesinjë mīrien e fōrmadhien tënde të i kēsh e të i marrçë po si të bëra prë nderë të namurit tënd e prë mẽ të mirën e shpirtit tīmë. Ëm të mos lẽ kurraj besën e Qishs tënde kathóllike e të bënjë gjith atë çë ajo më thot, mund më thetë e mund më urdhëronjë, pa shtrënguome e pa shpëlqeme të duanies time.

Ëm hirën e parkalesjes, ëm hirën e lotëvet po të mund lusinjë me të parën mīrien tënde pa të lodhemi ndonjë herë e me të ditën të lanjë e të pastrōnjë shpirtin tīmë të kondrepsurë fëtesashit e, tue gjëlliturë ashtu ndër lot e ndë metanie, pafça mbë serpos harënë aq të luturë, të priturë e të dishëruome të mund shoh faqen tënde trīdoksore mbë qiell, cila me harē çë nani s' mund ndilgonen lumsōnë gjithien e kriathiravet çë mund kenë pulqemen të e shohën e të e trashigonjin. Amin. [108]

LUSE SH. MARIES

po të t' jap ndihëmen e saj

O trīshëjte Mëma ime, u shoh nëmërin pa ndimërīm të hirëvet çë ti më pate ka īnë Zot e njoh edhe ksamurin me k' tij u përgjēgja. Kush nëng kā zëmërë e nëng njeh mīrëbëmat çë pati, ai nëng meritōnë të i ketë mẽ. Kjo ësht një e rënde vërtet, moj u jo prë këtë lẽ të ellpizonjë mbë lipisīnë tënde, o jëmë zëmërënjomthe.

Ti jē ajo çë mbānë, përhapën e jep hīrëtë gjith të tīnë Zoti ndër nē të mbëkatëruomit. Andajna ai të bëri ashtu fōrëmadhe, ashtu të fuqisëme, ashtu të bëgate, ashtu të mīrë, ashtu të butez, po të na ndihëçë pa të lodhēç kurraj. U dua të salvohemi. Prë këtë ndë duorë tënde vẽ shpirtin, zëmërën, kurmin e shëndētën time. U dishëronjë të jemë i shkruojturë ndë shërbëtōrit tënd mẽ të tēpërë. Ti mos më rrazbis. Ti vete tue kërkuorë të meruomit e të vobkit po të i levrōç e të i bëgatçë. Mos lëre mua të meruomin të pjono fëtes, çë shërtonjë me mallë të thellë po të qasemi tij. Fllit ti prë mua tët Biri, [109] tas çë njeh se ai tij nëng të arrnjisōnë gjẽ.

Ndose ti më mbjedh ndën qurdhien tënde e më pushtrōnë me sqepin tënd të lipisjārë e të gjerë e të thavmasōrë, kush kā zëmërë ahiena të më ngas o të më ruonjë mẽ? Mbëkata? E ti e shprishën. Djalli? E ti e trëmbën. Pisa? E ti e mbllīnë. Errësira? E ti e ndretën. Armiqtë? E ti ji mikën. Vëdeqja? E ti e butën. Tas poka çë këta s' mund më ngasën, kush më nget o më kanosën mẽ? Iti Birë? O, ki mundën, e mundën me ligj, të bënjë atë çë do! Moj ai ndë një parkalese të tëndevet butësonet edhe e më ndëlënë.

Parkalese poka, o Jëma ime, parkalese prë nderë t' atij namuri çë ai pati tij e çë ti i solle atij. Luse ti prë pjes meje e lipi të më ndëlënjë mbëkatat, të më dërtonjë zëmërën, të më pastrōnjë shpirtin me hirën e tij gjithmundore e të më jap të bënjë një vëdeqe të mīre, jo se pse u e meritonjë, moj pse keq meritōn vëdeqja çë bëri ai mbi kriqen prë fëtesat tona e shum meritove ti tue dhuruorë prë nē ndën kriqen ku virej e vëdisij ai. O Marie, Rregjëresha ime, u mbë tij kumbisinjë ellpizen time mẽ të madhe e me këtë [110] ellpize dua të gjëllinjë, me këtë ellpize dua të pushonjë e me këtë edhe dua të vëdes. Ndihëm ti, këshillëm ti, levrojëm ti, o Marie. Amin.

LUSE

SH. JANJË KRISOSTOMIT O GOLARËTIT

Ajlimono, errësīra e të truvet më zgjeret e më trandaksën, trëmbima e t' armiqvet më shtrëmbōnë, vëdeqja dirore më kanosën e gjella ime e mundurë thartirashit ruonë perëndimën si ditën çë straposet ndë vend i llargh! O shën Janjë, ti me atë urtërī çë të dha īnë Zot po të ndilgonje, të përhapnje e të porsinje vërtetat e tija, të mbjedhëra e të mbëllira nd' ato mistikosëme shkruome, me atë urtërī spav rētë çë më sqepënjin e ndritëm trūtë e prëlambsëm shpirtin po të njoh virtutat theosore me duanī të dreqte të i lloronjë, të i bënjë e të sallvohet.

Si munde prana armiqtë tënd e bën e u qetin, ëm ashtu fuqī të mund[i]një edhe u të dashurat e shpirtit, cili do t'[41] ecinjë pas këshillet e të dheut; të mundinjë edhe u tendacjonat çë më luftonjin gjith ditën tue mos më lënurë një kred [111] ambnī o pushīmë.

Sh. Janj' īmë, tij të qe vënurë ëmëri Golarëtë, thomse prë bëgatërīnë e ëmblësinë çë kishnje mbë të folëtë. Ti nani, prë lipisī, me ato fjal ashtu të fuqisëme e t' ëmbla fllit kauzën time parë[42] tīnë Zoti e, kurë prana kamë të vëdes, bëj të e xẽ mẽ parë se hera, po si e xure ti prë names të Sh. Vasiliskut[43], e lemë të pastrohemi, si ti u pastrove me Skamallīnë e me Kungimin, e të lëshonet shpirt' īmë ndë duorë tënde e të vinjë, i shokuorë ka ti, të trashigonjë faqen e atij Theosi aq i mīrë çë, vetëm tue u buftuorë, lumsōnë mbjatu gjith ata çë e shohën me lumsie të stoneonëme. Amin.

---

[41] do t'] djot.
[42] parë] pas.
[43] La predizione è narrata da Palladio, *Dialogo sulla vita di Giovanni Crisostomo*, XI.

NËNDORE

prë krëmtet e Sh. Maries

NËNDORE E I

MBË NDERË TË KONXHICJONS TË SAJ

Gjegjëm, Theos, e prë lipisī më ndih,
ngreu e lipsen time ruoj e shih.
Dokse paft' i Jati edhe i Biri,
dokse e nderë edhe Shpirti fanmiri.
Si qe, ndë stoneone ësht ai Zot,
Theos çë s' pat priazme[44] e s' kā ndonjë mot. [112]

LUSE

Virgjërë e trīdoksme, na harepsemi me tij pse ndë tënde[n] saftesëme Konxhicjonë munde gjalëprin të lig e mbëkatën edhe. Qoft' i bekuorë trīlarëti Theos çë të zgjodhi mbë gjith të bilat e Adhamit të vetëmez e të fanëmīre e të la të jeshnje pa mbëkatën e të zëmes të gjells njērishte. O, tas çë qeve aq e thjellëmez, e zgjedhurë, je bukurë e pafëtes, pafçë lipisī prë nē të kondrepsurë, të lig, e të mbëkatëruomë e, po si tij Theosi të ndëjti dorën e nëng bën e rē ndër avsin të fëtesjes e të zëmes, ashtu ti ndëj neve dorën e mbajna të mos biemi ndër mbëkata ndrishe.

Mos le, o Marie, të na mundinjë e të na zotëronjë ndonjë gjalëpërë pisulōrë, cilit ti [i] shkele e i shtipe kreun të pjono fōrë çë të parëzën herë kurë u buftove ndë të qënurën. Ti e vure, të mundurë e të përmisurë, ndën këmbtë e, si e vure, mbaje e mos e lësho kurraj ndonjë thërrimes, po të mos vinjë të luftonjë prësëriu na të murgjit. Kjo ësht haristja çë të pienjëmi na, të përgjunjurë e të përtrollurë përpara tij, ndë ktë nëndōre çë zëmi të bënjëmi prë [113] doksen të nderës' [s]ate. Ruojna ti alartaz me lipisī, mbëjidh, si do të jenë, doksat e laudhimet çë të dërgonjëmi e përzieji me ato çë të bënjin ëngjëlit po të jenë ashtu të madhe e të mira si i[45] perqen fōrëmadhies e paftesjes tënde. Amin.

Kënëkëz

Virgjërë e larëte, o Marie,
çë ndë gjellë sa u buftove,
ti me gjalpërin lufëtove
e m' i shkele ligën krie,
ti harepsu, o Marie. *Agëzuosh.*

[44] priazme] piazme.
[45] si i] e të.

Dritëm e bukurë mẽ se dielli,
gjithnjerī sa të prosteksi,
prë harē trīmadhe reksi:
po si burri, dheu e qielli
të laudhoi, e hëna e dielli. *Agëzuosh.*

Pati mallë, pati harē
kush të bëri, e Jati e Biri.
U gëzua Shpirti fanmiri,
tuke ruojturë hjenë çë kē.
O Marie, sa e bukurë jē! *Agëzuosh.*

Të harepsi, të gëzoi
me trīlarëte thavmasī
Jati e Biri, o Marī.
Shëjti Shpirt edhe të mbjoi
pasitēsh e të gëzoi. *Agëzuosh.* [114]

Kurë dhimoni ngrëjti sītë
e shkëlqeme ashtu të pā,
u tërbua e vate rā
thellë te pisa, ku hjidhītë
janë të rënda e bjeghërītë. *Agëzuosh.*

Mbjatu pisa u thturbëlua,
u përlip, u hundakos;
dreq mbi të mbëkata u stros,
dhjasi[46] shum e s' u qëndrua,
vrau e thelle u mboshtua. *Agëzuosh.*

Pisa u mbllī, parrajsi u hap:
mbjodhi tij të e doksore:
T' u purpoq Theosi e "Nxore
 - tha - mbëkatën? U të jap
shum fuqī t' e vrāsh mẽ vrap". *Agëzuosh.*

Ashtu taksi i Jati e doli
pas i Biri e jëmë të fali;
jëm[47] të thirri, si bënë djali;
tij, si nuses dhëndërri, foli
Shpirti Shëjt e parë të doli. *Agëzuosh.*

---

[46] dhjasi. Il verbo si incontra nel *Miloscino,* v. 686, con il significato di *abbassare, calare* (il fendente). *Adhjàsinj* vale *ordinare, rassettare*. Qui l'accezione precisa non è chiara.
[47] jëm] jum.

Ashtu tij të parën herë
kurë mbë gjellë të suoll Theosi,
çerëprëmisurë bën' e strosi
të të falij dheu i gjerë,
qielli e ëngjëlli e djalli i mjerë. *Agëzuosh.* [115] 55

Prana këndohet kjo anthifon

[**Tota pulchra**]

Gjith e bukurë jē, o Marie,
e mbëkatën e zëmjes s' kē.
Ti jē doksa e Jërësalimit,
ti harea e të Zdrailit ,
ndera ti e katundit tënë. 5
Të fëtesmëvet ndihore,
o Marī Virgjërë noerore,
Jëm lipsjare, parkales
Krishtin të na jap ndëles.

Vjershëthi

Te jotja Konxhicjon, Virgjërë Marī,
ti pafëtes qëndrove e pa të zī.
Nani Theosin parkales prë nē,
kuj ti e Bil e Jëm e Nuse jē.

PARKALESËMI

O Theos çë prë Konxhicjonën e paftesëme të Virgjëres Marie shpīnë parandreqe tët Biri dreq po si atij i ngitej, truhem[i] çë, si ti, prë vëdeqen parëpame të tit Biri lefterove Marien gjith fëtesashit, ashtu prë nderë të asaj jipëna po të mund vinjëmi ku ti jē. Prë vet Krishtin Zotin tënë. Amin. [116]

NËNDȮRE E II

mbë nderë të së lemes të Shën Maries

Shum e doksëme Virgjërë Marie, Jëm' e trīlipisjare të Theosit, ruoj na të përgjunjërë përpara këmbëvet tënde, shërbëtōrë e dhivote, çë të lusëmi me mẽ të thellën pjes të zëmërës e me mẽ të gjallin mallë të shpirtit, të lusëmi po të mbjedhçë, sido të jenë, këto laudhime çë zëmi mbë nderë të

së lemes tënde të fanëmire. Na ndilëgonjëmi të mbashkëmi laudhimet tona me ato mẽ të vapta, mẽ të lārta e mẽ të dreqta e urtërore çë të bënjin e të dërgonjin mbë qiellë shënjëtit çë gjënden atje e ndë ktë gjellë edhe.

Ti u leve jo vet po të ishënje e Jëma e tīnë Zoti, moj të burrëries edhe. Andaj, si prë Bīrë pate Jesu Krishtin, prë bil pate edhe na të meruomit. Na mbero qemë të rrethulluom ka mbëkata, nëng u mbajtim ndë gjellën e[48] të saftesëme çë na dha Theosi e ramë ndë të liga e ni, të gramisurë e të vëdekurë hirit, nëng meritonjëmi të t' thërresëmi me ëmërin keq t' ëmbël jëmje. Moj ti çë, pas tīnë Zoti, ndër gjith kriathirat jē aq e [117] mira sa nj' etërë nëng gjëndet mẽ, ti prë lipisī jëmrishte me hirën tënde të pa serpos qërojna zëmërat, pastrojëna shpirtërat e thirrëna prana mbë qiell të të bekonjëmi prë gjith stoneonën. Amin.

Kënëkëz

Ish e mbllīrë me hekurore
dera e vendit, ku harea
qiellsore rrij, e hjea
të mbëkatjes na pushtroj.

Tuke ardhurë ti, doksore
Virgjërë e bukurë, te kjo gjellë,
dera u hap e hjea u qellë
teku djalli, çë ng' e doj.

Ti na erëdhe, po si vjenë
shiu i dashurë dheut i thātë.
Ti e potise e tas të gjātë
një zinxīrë solle me Tij,

çë na lidhën e na rrëmbënë
ka kī dhē pjono hjidhī
e na siell mbë rregjërī,
ku përpara s' mund të hij

ndonjerī të Adhamit birë.
Moj Theosi, kurë ti leve
e prë Jëm të vuri neve,
një fuqī madhe të dha

të na bënje të fanmīrë [118]
me një hariste keq të gjere.
Bëj, o Jëm, poka njëhere
ku jē ti të vinjëmi na.

[48] e] o.

7. Vjershëthi

Lemja jote, o Prindëresh Marī,
na suoll mbi dhē të madhe një hajdhī.

Parkalésimi

Shërbëtorëve tënd, truhemi, o Theos, jipi qiellsorën hirë, e atirëve, kuj i Biri i të së lumes Virgjërë Marie suolli shëndetën, krëmtja e së lemes të saj bëj të i rritinjë ambënien të shpirtit e të kurmit. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

NËNDỌRE E III

mbë nderë të së vatures të Shën Maries ndë Qish të parën herë

Të falinjë, o Marie, me një reverenxje të thelle e me zëmërën të dhezurë malli. Doja të kishënja prej tij një namurë të doq, si ai çë pate ti prej tënë Zoti, pse, sa monu trī vjeçi jeshënje, e qellurë ka jot ëm ndë Qishën e të Jērsallimit, ndonse aq e vogël, u dhē shpirt, mend, trū e kurm ndë duorë të tinë Zoti [119] e ç' ahiena bënat, thënat, penxeret nëng panë, nëng deshtin e nëng patin jetërë mīrë ndomos Theosin e harīnë qiellsore.

Vashëz e fanëmīrë, edhe na muortim rrisollucjōn të shërbenjëmi e të duomi Theosin vetëm' e tij, pa kërkuorë mẽ gjẽ. Moj neve mbero çë qemë rrobij të mbëkats na lipset një hirë keq e madh të mund ngrëhemi avsit ku vamë të bijim e një fuqī keq e doqe na duhet po të ndërronjëmi gjellë e të qëndronjëmi o të mbërparemi tek gjella çë zumë të rē.

Na poka lipëmi Theosit ndëles e parkalesëmi tij edhe po të e lusëçë prë pjes tënë po të na ketë lipisī e të na mbjedh e të na mbanjë ndën fuqīnë e tij, ndomos jo si mbjodhi tij tek Qisha e Jērsallimit, me pasitē e me hīrë e hajdhī të trīmbëdhalle, pse me tij qe nevoj të bënej ashtu, tas çë ju i qase pa mosnjë fëtes, more jē pjono me hirë; moj allmonu të na mbjedh e të mbanjë na si të mbëkatëruorë çë jemi, prë lipisī, prë karitat e prë nderë të lusavet tënde.

O Marie, Zonja e Rregjëresha jonë keq prë me u dashurë, ti bëre atë çë s' ditim të bëjim na. Nani andaj tij të qëndrōnë mbëshuomja të [120] bẽç me nē sa bëri īnë Zot me tij, mbë pjes allmonu, ndose s' mun të jetë prë gjithsej, dua të thomë të shpejtofçë përtōmen tënë. E, ndose njer' nani qemë të vaphëtë o të ftohtë ndë shërbemen e tīnë Zoti, çë sod e pārë ti ndërrojna zëmërat, dhezi ndër tijin e ndë tëndin namurë ashtu çë mos dafçin, mos lusëshin e mos kërkofçin jetërë ndomos të laudhonjin e të bekonjin juve e të vinjëmi prana të ju trashigonjëmi prë pather tek gjella e paserposëme. Amin.

KËNËKËZ

O dulira e fanëmira
ndë gjith gratë çë pati dheu.
Pjot me bes, e paftes,
iti mallë qiellin rrëmbeu.

E rē lule, dheut u sule,
u prëlarte e vajte dreq
ku të pritij e thërritij
me një mallë të dhezurë keq

iti Dhëndërr, jo si nj' ëndërr,
moj si bëme e si vërtet.
Dashurisht, ëmbëlisht
te parrajsi bën' e u gjet,

ka mbi rē prire ndë nē
një të ruojme lipisjare. [121]
Ruoj ku jemi, shih ku vemi
ndë ktë dhē të ghonovare.

Me mbëkat, si drunjë të that,
rrimi prej zjarrit i zī.
Ti na rrëmbe, mos na le
se të bënemi si hī.

Vobka e zeza, jo të leza,
vemi na si guri ndënë,
ndo na lẽ e na përzẽ
dora jote, e së na ngrẽnë

se të vinjëmi po të hinjëmi
te parrajsi me harē.
Ti na thirr, ti na mirr
me një tënde pasitē.

Nëng na jep mẽ kī djep
truolli se shërtima e lot,
ku t' façonjëmi, kudo ruonjëmi,
por me dëme ësht i pjot.

Kequllore, zezullore
ësht e thelle filaqia,
ku, ndo mjera na zẽ hera,
ikën gazi e vjenë hjidhia.

Vjershëthi

Lem të t' laudhonjë, fōrëmadhe Shën Marī,
e kundër' armiqvet tënde ëm fuqī. [122]

PARKALESËMI

O Theos çë të lumen e pather Virgjërë Marī, shtëpia e të Shpirtit Shëjt, deshe ndë ktë dit çë të venej ndë Qish, truhemi mīries tënde çë, prë nderë[49] të asaj, të na lëfçë të vinjëmi ndër Qishën e të dokses tënde. Prë Krishtin Zotin[50] tënë. Amin.

NËNDORE E IV

MBË NDERË TË MARIES VIRGJËRË JE AGËZUORË KA ËNGJËLLI GHABRIELLË

Me këto nënd Agëzuosh o ti Marī *çë të thomi ka dita ndë ktë nëndore i dërgonjëmi edhe nj' etërë aq bekuome shën Maries e vemi tue penxuerë të madhin mīrë çë na bëri pse, tue thënurë ajo se ish shërbtresha e Theosit, kurë ëngjëlli e tëfali pjono me hīrë qiellsore, e i tha të bënej duania e tīnë Zoti mbë të, çë n' ahiena zū shëndeta jōnë me të Fjalën stoneonëme të Theosit e njerëzia erdh t' ish e lefteruorë ka rrobija e djallit. Andajna me oreks e me dhivocjōn i thomi*

1. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo [123] tëfalëme qiellsore me k' të gëzoi ëngjëlli ji Theosit.

Ka një viersh ksoj thuhet një Agëzuosh *eç. me një* Dokse paft' i Jati *eç.*

2. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo hariste qiellsore me k' ëngjëlli i Theosit të tëfali e pjot.

3. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo habërë e fanëmīrë çë të suolli ëngjëlli ka qielli.

4. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo fjal e urëte me k' ti u kallëzove shërbtresha e Theosit.

5. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo herë e fanëmīrë çë këshillëte të bënje prë dreq duanīnë e tīnë Zoti.

6. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo thjellëmie qiellsore me k' mbjodhe ndë prëhërin tënd Fjalën e tīnë Zoti Theosit.

7. Qoft' i bekuorë, o Marie, ai kred keq i fanëmīrë kurë veshe me tënin mish të Birin e Theosit.

8. Qoft' i bekuorë, o Marie, Shpirti Shëjt çë të mbjoi me hīrë e me pasitē qiellsore pa mosnjë ndimërīmë.

9. Bekonjëmi e doksonjëmi, o Marie, bashk me tij të shëjten Trīnitat, cila me pathënëme lipisī të ngrëjti e të lartoi ndër gjith kriathirat e prë Jëm, prë Bil [124] e prë Nuse të deshi po të bënej ashtu

[49] nderë] inderë.
[50] Zotin] Zoti.

tij nderën mẽ të madhe e burrëries shëndetën mẽ të mirë tue mundurë mbëkatën, tue përmisurë djallin, tue mbllíturë pisën. *Agëz.*

Kënëkëz
[**Ave, maris stella**]

Agëzuosh, o dejtit illë,
Jëm trīmadhe e Theosīs;
Virgjëra ti e virgjërīs,
derë je qiellit fanëmīrë.

Ëmrin ti t' Evës ndërrove,
kurë Ghabriellit tas ka gola
more Fjalën. Ti ka shola
tas na solle ndë pushīm.

Ti trëkuzat ligvet zgjidh,
ti të verbërit ji ndrit,
ti me mīrë na mbjo, e shpit
gjith të keqat shum tutje.

Via, bufto se jëm na jē
e prë tij të marr ai
lusat tona, çë nani
si Bir' it tëfalëmi na.

Virgjërë vetëm e lartullore
kuj së mun të gjas njerī
prë hariste e prë butsī,
bëj ti na të but edhe.

Ëmna thjellmëze një gjellë, [125]
nj' udh të dreqte na zbuloj,
Zotin Krisht pra na buftoj
të na jap me hīrë oreks.

Doks' e madhe paft' i Jati,
nder' e dokse paft' i Biri,
e me ta Shpirti fanmīri.
Qoft Trīvet një nderë vet.

Vjershëthi

Ti parkales prë nē, shëjtja Prindëresh,
po luset tona Krishti të marr vesh.

PARKALESËMI

Hirën tënde, truhemi, o Zot, derdhe ndër zëat tona ashtu sa na, çë njohtim se ëngjëlli na kallëzoi mishëruomen e tët Biri Jesu Krishtit, prë nderë të psuomvet e të kriqes të atij ardhëçim mbë doksen e të së ngjallurit. Vet prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

NËNDORE E V

MBË NDERË TË SË BESUOMES TË VIRGJËRES MARIE NUSE TË SHËND ZEPS

1. Virgjërë e trīshëjte, prë të virgjërën [126] nusëruome çë bëre me të virgjërin e shëjt dhëndërr Zepën, bëj çë shpirti imë u besoft me tëndin Bīrë, Zotin timë Jesusin.

Agëzuosh - Doks, eç.

2. Virgjërë e trīthjellmez, prë atë e mosngare virgjërī çë ti mbajte tuke mbeturë bashk me tët shoq Zepën, i virgjërë e i trīthjellmith edhe, le zëen time po të mun të t' shërbenjë me zëmërën të lajturë e të thjellmorez edhe e, si Tij, shërbeft Birin tënd Jesu Krishtin.

3. Virgjërë e trīdashure, prë nderë të atij të njomëthi mallë me k' deshe tëndin Zep, keq prë me u dashurë shoq, prīrë shpirtin tīmë e bëj çë daft mīrë pa mosnjë ndërruome tëndin Birë e timin Zot Jesu Krishtin.

4. Virgjërë trīdoksore, prë namurin e t' asaj të dreqte gjegjurī me k' bëre sa të kumandoi e të tha me norejme urtërī shoqi jit Zepa, le shpirtin tīmë të gjegjinjë mbjatu dreq Birin tënd e Zotin tīmë Jesu Krishtin.

5. Virgjërë e pjono umilltat, prë kultuomen të asaj të shpejte shërbëtrī me k' shërbeve dhëndërrin tënd, të përdashurin Zep, dërto shpirtin tīmë të dētë [127] besërisht e të shërbeft Birin tënd Jesu Krishtin, Zotin tīmë.

6. Virgjërë pa mosnjë fëtes, prë ato trīmadhe dhurime çë ti shkove bashk me tëndin trīdashurë Zep, këshilloj shpirtin tīmë të përulet e të zigonet prë gjithsej ndën duanīnë e tët Biri, Zotit tīmë Jesu Krishtit.

7. Virgjërë e trīlipsjare, prë nderën e asaj prëngushte vobkëtī çë dhurove bashk me tëndin dhëndërr Zepën, bëj çë shpirti īmi u xheshtit ka gjith petëkat e kafshat të këtij dheu, prë mallë vetëm të dētë mīrë timin Zot e tët Bīrë Jesu Krishtin.

8. Virgjërë e bukurushez, prë namurin të së madhes umilltat çë ti pratikove me tëndin prënoremë dhëndërr, le shpirtin tīmë të ndënvëhet gjithve po vetëm të pëllqenjë tët Biri Jesu Krishtit, Zotit tīmë.

9. Virgjërë trīshëjte, pr' atë mburuome pasitësh çë ghadhënjeve tue mbeturë bashk me Zepën, dhëndërrin tënd, njerī keq prë me u laudhuorë, le shpirtin tīmë të mallipset shëjtavet virtuta po të mund pëlqënjë Birit tënd e Zotit tīmë Jesu Krishtit. [128]

Vjershëthi

Si sod me Zepën u nusurua Maria,
e mbjuome qe prë të harësh gjithia.

PARKALESËMI

Shërbtōrvet tënd, truhemi, o Theos, jipi qiellsorin hirë, ashtu çë atirëve, kuj zdorgjura e së lumes Virgjërë Marie suolli zëmen të shëndetjes, krëmtja e të sajes nusëruome i rriftit pushuomen e ambënīnë. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

NËNDORE[51] E VI

MBË NDERË TË SH. MARIES VIRGJËRË ÇË VATE TË GJËJ LIZABETËN TË SAJE GJËRĪ

O trīshëjte Marie, Qish e gjalle të Theosit, ti çë ka një mot i stoneonë qeve e fanesurë po të ishënje rrëfuxhi, ndihëma e levrojma të gjith atirëvet ndë njerëzit çë kanë lipse aq shpirti po sa kurmi, të parkalesëmi na ndë këtë nëndore po të jēç rrëfuxhi, ndihëma e levrojma të lipsevet tona shpirti e kurmi. Bëje, o trīmadhe Jëm lipisie, bëje prë nderën të sëmadhit mīrë çë të deshi trīshëjtja Trīnitat[52]. Amin. [129]

1. Qoft' i bekuorë, o Marie, ai dhivot penxerë çë pate të veje të gjënje tënden gjërī shëjte Lizabetën. *Agëzuosh.*

2. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo shërbeme çë bëre tuke vaturë maleshit e prë nd' udha të gramisura e prikulore po të gjënje tënden shëjte kunate Lizabetën.

3. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo e hiturë e fanëmīrë çë ti bëre ndë shtëpīnë të së tëndes kunat Lizabets.

4. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo tëfalurë e māllëmadhe me k' tëfale tënden kunate[53], sa prë të parëzën e pē.

5. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo lloruome pjot me hare, me k' ti llorove shën Lizabetën, tënde shëjte kunat.

---

[51] Nëndore] Nënore.
[52] Trīnitat] Tīnitat.
[53] kunate] kunete.

6. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo e puthurë e dreqte e pjot me mallë të qiellsorë me k' ti puthe faqen të Lizabets, tënde kunat.

7. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo hariste e mburuome[54] me k' ti prëmbjove shpirtin e së tëndes kunat Lizabets.

8. Qoft' e bekuorë, o Marie, ajo shërbeme pjono hjē çë ti bëre Lizabets, ndë gjith motin çë mënove te shtëpia e saj.

9. Qofçin të bekuorë, o Marie, ato trī [130] muoj me k' ti lumsove shtëpinë e Shëjtes Lizabet e me tëndin Bīrë edhe ndë shkëf shëjtërove tëndin nip Janjin e harepse pllakun Xakarī.

Vjershëthi

Ti vet bekuome qeve ndër gjith grā
e karpoi it çë gjith bekuomet kā.

PARKALESËMI

Jip neve, të parkalesëmi, o Zoti Theos, shëndetën të shpirtit e të kurmit e prë nderën të Sh. Maries Virgjërë të mund jemi leftëruora këtu ka helëmet e tek gjella stoneonëme të mund pushonjëmi anamesa hareve. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

NËNDORE E VII

MBË NDERË TË THJELLMONIES TË SË LUMES VIRGJËRË MARIE

Virgjëre Marie, çë qeve ndë gjith motin të së qënures tënde pa mosnjë fëtes, ti, e bardh mẽ se bora e malit e lili i llaks, mẽ e shkëlqemez se rrëmbi i diellit e se drita e të dits, mẽ e ëmbël se mjaltë, mẽ mirudhire se trondofilja [131] e paraverës, mẽ e bukurë se bukuria, mẽ e pastruome se pastruomja prë vetëhënë, ndōnse ashtu qeve, desh t' venje edhe ti, si të tjerat grā, bila mbëkatruome të Adhamit, po të jeshënje e bekuorë e të lahshënje ndë Qish përpara të Trīmadhit Prift.

Ti s' kishënje kondëra të lanje, s' kishënje dëtira të paguonje, s' kishënje dëme të qanje, jo fëtesa të qëronje, moj, pse ti qeve Jëma e të Theosit, shërbeve e bëre, si shërbeu e bëri it Birë po të sallvoj njeriun e, po si ai vate të pagëzohej ndë lumin Jordānë, jo se pse i nevohej atij pagëzimi, moj po të

[54] e mburuome] emburuomo.

ngjaroj e të këthjellij ujet të turbëluome e të kondrepsura, tuke i ngarë me misht[55] e tija trīshëjte, ashtu ti çë ishënje Qisha e gjallë, cila mbaj ndë gjī Theosin, vajte ndë qish po të bënje sa urdhëroj e porsij lexha e të Mojsesit e të madhshënje, ashtu tue bërë, mbal gjith të tjerat kriathira me urtërī e me virtuta.

E kurë pllaku Simeon të përhapi e parë se moti të kallëzoi psuomet e tët Biri, ti dhurove me mallë e ndënvure duanīnë tënde asaj të qiellit. Jëma jonë, ndose prë tij qe e vate ashtu, prë nē mbero ësht e vete ndrishe. Na kemi zëen të [132] kondrepsurë rëndashi fëtesa, shpirtin e kemi të mundurë mālleshit dheu e ndër gjith të qënurën tënë pak o faregjẽ gjëndet të mīrë, të dreqtë o të dulīrë, moj sa kemi ndë shpirtin e ndë kurmin gjith kā nevoj të jetë dërtuorë, të lajturë e të pastruorë.

E vetëm' ellpiza na gjëllīnë se ti, Jëmë, tue parë vobkëtīnë tënë, me hīrën e me virtutat çë pate të shumta, ti, na dërtonë, na lānë e na pastrōnë sa të mund vinjëmi mbë serpos të trashigonjëmi ndë qiellë tënden bukurī, pastroníen, dulīnë e hajdhītë çë ti kē e ato hira[56] edhe me k' gjith ditën të nderonjin e të bëgatënjin iti Jātë i stoneonë, iti Bīrë Jesu Krishti e Shpirti i Shëjt. Amin.

Këndimez

Me atë madhe trīshëjte duanī
me k' Theosin thërrite mbi dhē,
o trīlarte bekuome Marī,
ruoj mbë nē. *Agëzuosh.*

Tas u nxitim, u turpëtim e rāmë
keq proposh, ka lārti ku qēmë;
me virtuta e hariste ng' u mbāmë
po si u lemë. *Agëzuosh.* [133]

Moj të raturë, fëtesurë, gramisurë,
ka parrajsi keq llarghu të vaturë
e te pisa pri s' afëri përmisurë,
kuazi paturë, *Agëzuosh.*

tij thërresëmi, se drita ti jē
e ajo vetëm ka presëmi shëndet.
Ndëje, o Jëm, ti dorën ndë nē
e, sa na nget, *Agëzuosh.*

na shërōnë, na lānë, na pastrōnë,
prë parrajsin të mira na bënë,
duanīnë na ndritën e dërtōnë
çëdo gjënë *Agëzuosh.*

[55] misht] mishte.
[56] hira] gjira.

shtrëmburisht te zëmëra se kemi
e na mbjōnë me malle qiellsore,
na harepsën e lārt bën' e vemi,
të dhoksore. *Agëzuosh.*

Vjershëthi

I taksi Simeonit shëjti Shpirt
të s' disij, ndomos shihij Zotin Krisht.

PARKALESËMI

Theos i stoneonë, çë mundën gjithsej, na, tuke u truojturë, parkalesëmi fōrëmadhīnë tënde çë, si it Bīrë, i veshurë me tënin mish, tij u mbërparë tek Qisha, bëj ti edhe me nē çë, të lajturë e të pastruorë [134] me shpirt, ardhëçim përpara tij ndë parrajs. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

NËNDORE E VIII

MBË NDERË E TË ZDORGJURES TË SË LUMES VIRGJËRË MARIE

Me rreverenxje të thellë e me mallë të madh, të përgjunjurë përpara tij, o Marie, truhemi e të parkalesëmi të kēç lipisī prë nē të vobkë e të mbëkatëruomë, jo pse na e meritonjëmi, moj prë nderën të Jesu Krishtit çë ti solle nënd muoj ndë prëhërin e prana, e zdorgjurë, e pē corrobilith mbë duorë tënde e u harepse tue diturë se ai bënej shëndetën e të dheut. Prë nderën e të atij malli të thellë e të doq me k’ ti e ruojte, e llorove, e puthe, e ngjeshe, e xheshe, e veshe, e pastrove, e qumshte e je rrite, prë nderën e të atij namuri harro të ligat çë bëtim, lajna me hirën tënde kondrat çë kemi, dreqtojna shpirtin, pastrojna kurmin të mund shohëmi, pas vëdeqes, faqen e Jesu Krishtit tët Biri, cili, të na lefteronej ka pisa, desh t’ lehej ka ti ndë dhē. [135]

Kënëkëz
[O gloriosa virginum]

O virgjërë ndë gjith virgjërat dhoksore,
trīlart', īllë i shkëlqēmë ndë tjerat il,
kush të kriosi, ani si një fëmil
ti qumshtōnë.

Sa neve nxuori Eva ligullore
ti na rrëndonë nani me tëndin Bīrë,
ti qiellin hapën atij të fanëmīrë
çë të kërkōnë.

Ti dera e rregjëries të lartit Rregj
e të shkëlqemes dritë qeve ti shpia.
Gjellën çë pāmë ka Virgjëra Maria
tëfalëmi gjith.

Dōksen çë të bënjëmi, o Jesu, gjegj,
çë tas prë nē ka Virgjëra burr u leve,
e, si me Jānë, me Shpirtin doksurë qeve
ka gjindja gjith.

Ka një strof të ksaj kënëkëz kanë të thuhen dhjet Agëzuosh *eç. e mbë serpos të dhjetmes një* Dokse *eç.*

NËNDORE E IX

MBË NDERË TË SË LUMES VIRGJËRË MARIE ÇË BIE NDË MEST GUSHTIT

Pandehj, o zëa ime, sikurë të u keshënje gjeturë përpara tek vendi i fanëmīrë [136] e tek ajo e lume herë, kurë Maria, e mundurë vetëm ka një gjumith i ëmbël, u qëllua mẽ shpejt se vëdiq, e shpirti i saj, i kurorëm ka dimbëdhjet ille, i veshurë me dritën e diellit, i ulurë mbi qerren e hënëzës, i stolisurë me të dhënat e të së Shëjtit Shpirt, i pastruorë me mburuomen hirë të Jesu Krishtit, Bīrë i saj, i pjono doks, oreks, mallë të madh e harē, Maria[57] u mbërparë të stoneonit Jātë mbë qiell, e shokurë gjith anëvet ka ëngjëlit.

Pandehj edhe ti, zëa ime, atë pëlqeme e atë harē çë s' kā thëni e truhu asaj Rregjëresh e parkalese me zëmërën të māllëme po të ruonjë ka larti i të sajes madhërī vogëlīnë tënde e të derdhinjë mbi tij, parkalese, vetëm një aso hareshi çë ajo ndë parrajsit ësht e trashigonë e ajo e vetëmez harē, kije bes, mun të t' lumsonjë. E ni ti, të mund e kēç sa mẽ njëhere e do, me bes e me ellpize tëfale e luse ndë këtë nëndore.

Kënëkëz

Kush ësht kjo zonjë
çë e bukurë vjenë?
Mẽ shum se hënëza,
si drit shkëlqēnë! [137]

Duket e zgjedhurë
mbi ilt' e qiellit;
popo, vrënë faqen
prë mbjatu diellit.

[57] Il soggetto è prima *shpirti i saj*, poi *Maria*.

Me mallë e ruonjin
sa janë mbi dhē
kriathira[58], e falënjin
prë kafçë e rē.

Mali kundrela
vënurë te drita,
me borë pushtjellurë
kurë dihet dita,

mali e tëfalën,
e dejti e kroi,
birraka e lumëthi,
llaka e përroi,

dita shkëlqemez
e haraksia:
mbi të harepset
mbaru gjithia.

Moj ju të xëni
doni, o kopile[59],
kush ësht kjo lule
mbi trondofile;

kush ësht kī madhith
i rī shërbes,
çë dheun thavmasurë
lẽ ndë gjith pjes?

Kjo Zonjë hajdhjarez
ësht ajo grua
ç' u zdorgj Theosit,
me k'u lartua;

ësht ajo Vashëz
ç' Evën ndërroi:
ajo na therëti,
kjo na shëroi;

ajo Parrajsin
neve mbulliti;
kjo t' e hapënej

[58] kriathira] kriathria.
[59] kopile] kapile.

mẽ mirë e diti.

Eva mbi njërëzit
mbjodhi mallkuome;
Maria trīmirashi
na mbjoi bekuome.

Ka gola e ulëkut
me t' sān karpo
na lefteroi,
na nxuorë kjo.

Maria të mirat
çë pati dheu
ka saji prëhërë
na parasteu.

Na dha një anizez
te dejti i keq;
te grami udhën
buftoi të dreq; [138]

ndë vapa hjezën,
dritën te nata,
ku na kanosij
zeze mbëkata.

Dorën na ndëjti
te dushku i thellë,
pjono të ligashi,
të kësaj gjellë.

Ndo i toket shihëni
kësaj namurë:
neve ajo deshi
s' dimi çë kurë.

Sa mīrë na bëri
pather na bënë,
ndo tonat zëmëra
t' e duonë së lënë.

Via, gjith i japëmi
zëmërat e tona,
Jëm e thërresëmi
të jetë jona;

mos e harronjëmi
një dit, një herë,
prë mallë t' e duomi
gjat e të gjerë;

me nē natën
mbeftit kjo,
ditën si shokez
na paft' ajo;

na dhëftit nd' ëndërra
nina të mira,
ndë gjellë penxjeret
na mbāt dulira;

na vjōt pushimen
Maria ndë deqe,
pra na letrofët
ka pisa e keqe.

Vjershëthi

Qe ngrërë ndë qiell Maria. Ëngjëlit gëzōnjin,
harepsen e me mallë Zotin bekonjin.

PARKALESËMI

Të shërbëtorvet tënd, truhemi, o Zot, [139] ndëleji fëtesat e, pse tij me bëmat tona s' mun të pëlqenjëmi, allmonu me ndihëmen e[60] Prindëreshsë të sët Biri, cili ësht Zoti īnë, lena të mund sallvohemi. Prë atë çë me tij gjëllīnë e rregjëronë ndë stoneonën. Amin.

NËNDORE E X

MBË NDERË TË SË LUMES VIRGJËRË MARIE TË MĪRKËSHILLIT

1. O Virgjërë trīshëjte, Jëm' e Këshillit të mīrë, çë u nise ka Albëria, pas çë ajo rā mbë duorë të qenit turk, e zgjodhe të mënonje ndë fanëmirin katund të Gjenecanit, na me çerë prë trolli të lusëmi po të na keç ka Theosi hirën të mund ikëmi pather ka mbëkatat të rënda e të mund bënjëmi zëat tona Qisha të pastruome po të mund mbanjin Shpirtin të Shëjt.

Një Agëzuosh *e një* Dokse *eç*.

2. Virgjërë trīshëjte, Jëma e Mīrëkëshillit, çë kallëzove të nisurën e nīnës' [s]ate ka Skutari Gjergjëravet e Skllavisëravet e i zgjodhe prë shok të fanëmīrë tek ajo vaturë thavmasore, na të

[60] e] a.

truhemi me gjith mallin e dhezurë të zëavet tona, po [140] të na shokroç me ndihëmen tënde tek e vatura e ksaj gjellë, ashtu sa me porsimen tënde mund arvofshim të të trashigonjëmi ndë doksen e të qiellit.

3. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e Mīrëkëshillit, ti çë bën e paranjohu Petruça vendin ku donje të pushoj nina jote e ajo të e dërtoi, bëj të prënjoh edhe zëmëra jōn sa ësht i ëmbël malli i tët Biri Jesu Krishtit po të bënjëmi dreqërisht duanien e tij e të mos lëmi sa na perqet të qënures tënë.

4. Virgjërë trīshëjte, Jëm e të Mīrëkëshīllit, ti çë me thavmasī të madhe shkule ka muri ninën tënde, e rrethullove me prëshkëlqeme drit, e ngrëjte lārt e ftove pak njerz po të i vejin pas, ti edhe shkul e ndaj zëmërat tona malleshit dheu, ashtu sa me bardhie koshenxje mund shërbefçim Theosin e tij.

5. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e Vulies të mīrë, ti çë ngurëte ujet e dejtit e bën e shkuonë mbi ta, pa lagurë këmbt, ghonovarit çë erdhëtin me tij, dreqto, të parkalesëmi, e qëndro astundurishte zëmërat tona ndë taksurat të mira çë bëtin, ashtu sa, tuke shkuorë ka kī dejt i monostrofurë, të leftëruorë ka gjith [141] prīkulit, arvofçim mbë serpos tek lemënja e të shëndēts e të stoneones.

6. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e të Mīrëvulies, ti çë, tue fshehurë kuatërin tënd Rrom atirëve çë të vijin pas, mbë serpos bën e e gjetin të vënurë ndë adhoracjōn të gjithvet Gjenecānë, ti fshehna ligërien e dhimonit, lusëna ka Zoti Theos hirën të vjōnjëmi e të mbanjëmi besën, të na hapet mz̃ e mz̃ drita e hirës tënde e të mos na llarghohen kurraj ka siu lexha e Theosit e iti këshīllë, ashtu po sa, të ndihurë ka këto di fuqia, pafçim mbë serpos faqen tënde tek parrajsi.

7. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e të Mīrëkëshillit, ti çë, rrëvuome Gjenecānë, ndër bumbllimen thavmasore të këmboravet ftove gjith katundet po të vijin të harepsëçin përpara nines tënde keq e bukurë, ti bëj të kemi ka īnë Zot fuqī ndë shpirtin tënë po të mund përgjegjemi ndë mallīsëta ftuome të haristes e të mund arrënjëmi ashtu të t' shohëmi e të trashigonjëmi pamen' e Theosit e tënden qiellsore bukurī ndë katundin e të parrajsit, cili nëng vjetërohet kurraj.

8. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e Mirëkëshillit, ti çë me buftuomen vetëm të kuatërit, [142] ku ësht nina jote keq e bukurë, zëmëron njerzit e i ftōnë të ellpizonjin mbë tij, të t' lusënjin e të t' lipënjin gjith atë çë duanë të kenë të dreqt'e të mīrë, ti bëj çë besa jonë e kumbisurë mbë tij vaft tuke u rriturë dit prë dit e na paft ka īnë Zot haristet gjith çë mund na lipsen.

9. Virgjërë trīshëjte, Jëm' e Vulis të mīrë, ti çë njohe se qisha jote Skutarë kish të bīnej ndë duorë të turqëvet çë kesh t' e turprojin e andaj nëng deshe të lënje atje mendirën tënde se të mos ish e dhunuorë aso njerzish të pabes, çë thomse të përziejin ndë adhoracjona me Maomethin[61], ti, o Zonjë, mos përmëto kurraj çë të qëndronjëmi të lëshuora haristes tënde na, moj me pasitënë tënde shokrojna e ndihëna njera mbë herën e prasëme të vëdeqes tënë. Amin.

[61] Maomethin] Mahomethin. L'*h* del Santori in questo caso non viene pronunciata.

Anthīfon

Dokse Jatit, kuj jē[62] Bil;
dokse të Birit, kuj jē Jëmë;
dokse Shpirtit, kuj jē Nuse.

Agëzuosh, o Qish e së trīshëjtes Trinitat. Agëzuosh, o Marie, Rregjëresh e të [143] Mīrëvulīs. Ti parkales prë nē nani e ndë herë të vëdeqes tënë. Amin.

PARKALESËMI

Kultou, o lipisjare Virgjërë Marīe, pse[63] nëng u kā gjegjurë kurraj ndë ktë jēt se ndonjerī çë kërkoi, lusi o lipi ndihëmen tënde kā qëndruorë i shkreturë. U, ka kjo ellpize e kufdhenxje i tundurë, vinjë të mbërparemi tij tue qajturë e tue valtuorë, po si ji mbëkatëruorë çë jamë. O Jëm' e Fjals të vërtetëme, mos rrazbis fjalën time çë të lusën, moj mirre vesh e gjegjëm. Vet prë Krishtin, Birin tënd. Amin.

Delëmereza[64]
çë siellë një kurorë luleshi
Virgjëres Marie

Jetërë s' kamë, fōrëmadhe Zonjë,
të të siellë se këtë gjī;
zëen atena e fjuturonjë,
tij t' e jap, o Shën Marī.
Ti me tij prë pather mbaje,
me namurë lakose e çaje,
ndonjë mot ti mos e le.

Lulesh vetëm një kurorë [144]
prë nishānë malli të siellë,
e t' e vẽ me timen dōrë
nd' atë krie çë si një diellë
ndë menat pa rē shkëlqēnë,
o te mjezëdita vjēnë
të shkëlqēnjë mẽ shum atje.

[62] jē] jek (jec).
[63] Qui e poi talora anche in seguito con il valore di *che*.
[64] Delëmereza] Delëmebeza.

Monasaqesh tufa e liu,
trondofile e lule bardha,
çë ng' i zū, se voeza, shiu,
si i ka pjeshku, molla e dardha:
gjith sa munda u t' i mbjodha,
buzkuqe e lile zgjodha,
e t' e ndreqa si ësht ani.

Monosaqen, të më mbāsh
pather virgjër e kopile,
solla tij, trīshëjte Vash,
edhe kuqen trondofile
të më mbjoç me pasitē
shpirti e kurmi, e me harē
të m' thërresh ku, Zonjë, rrī ti.

Atë [ç’] s' munda, Zonj', u tij
po të bënja, bëj ti mua,
çë jē dējti ka pāt vij
neve varthat miri krua,
ujt' e kuji na shërōnë,
e me dhënë qiellin ndërrōnë,
nëng na lẽ të varfër' ashtu.

Ti m' rrazbis ligun[65] penxërë, [145]
çë ndë keq më gropësoi,
e të buten paravërë
tas m' e vodhi e m' e perndoi;
ti porsīmë të zbjerrën udh,
ti pushtrōmë te kī dëludh,
mos më le ndë lip këtu.

Gjith mallet dheu m' i nxīrë,
vet namurë qielli dërgōmë,
bëj të rrī pather dulirë
u me shpirt e të t' thomë:
"Rregjëresh, o, ndë m' thërret
teku[66] jē, zëen m' e nget
e së do mẽ ndë këtë

të mënonjë lipsuome llak
çë, ndë gjellën rēz e kamë,

[65] ligun] ligum.
[66] teku] toku.

nje më bẽn fëtësve pjak,
e ndër dëme bën' e jamë.
Dua të vinjë tek ësht ambënia,
tek ësht gazi e ku hjidhia
nëng tramaksën shpirtrat mẽ.

Ndë kto dushqe, ndë kto pila,
teku ruonjë u mjera dele,
ndo, me nd' dorë një[67] tuf me lila,
të këndonjë ndonjë kangjele,
tek parrajsi, ku jē, thirre,
prë të mīrë, o Virgjërë, mirre,
te kī truoll mos e lësho;

e me të edhe shpirtin tīmë [146]
thirr ndaj thronit keq i lārt,
ku shkëlqënë si shkeptīmë
madhe e gjate, e ku e thārt
nëng më nditet [mua][68] mẽ gjella,
se m' e shkonjë ndër llaka thella.
Zonjë, sa lipinjë mua dërgo!".

SHTATORE

Shën Maries të dhëmbësuome

Gjegjëm o zot, e prë lipisī më ndih etç. Dokse paft'i Jati edhe i Biri etç.

Shëjte Jëm e lipulluome,
bëj të gjegjinjë edhe u
tëndet dhëmbura, këtu
ndë ktë zëmërë pak e zgjuome.

I. Të lipsinjë, o shëjte Jëm' e dhëmbësuome, prë atë shpat e ngurëte e je thārte çë të shpoi zëmërën kurë gjegje ka gola e të pllakut Simeōn se iti Bīrë i trīdashurë, mallë i vetëm të zëes [s]ate, kesh t' ish i gozhdjasurë ndë një kriqe e të bënej prë zëmërën tënde pa mosnjë fëtes një thik farmëkore dhëmbimi. U të parkalesinjë çë, prë nderën e atij helëmi çë të shokëroi prë aq vjet, të më kēç ka īnë Zot haristen të mund penxonjë çë sod e parë nat e dit dhëmbimet tënde, [147] psuomet e vëdeqen të Jesu Krishtit e të mund bëfça një shëjte vëdeqe.

[67] me nd' dorë një] me dorë udë. Emendo un testo incomprensibile.
[68] L'aggiunta è resa necessaria dalla metrica.

Thuhet Agëzuosh *e një* Dokse *e prana kënkëza ç' ësht e shkruojturë ndë të parën par[k]ale[se][69], e kështu prë gjith të tjerat.*

II. Lipisjarinjë, o shëjte Jëm' e dhëmbësuome, dhëmbimen të thelle çë ti gjegje prë vëdeqen të corrobilvet saftesëm çë qenë të vrarë ka Erodhi e prë të ikurën çë ti pāt bënje njera tek Exhiti, ku anamesa të gjindjes të huoj pate të dhuronje trëmbime, vobkëtī e të tjera nevoj ndrishe shortashi. U të parkalesinjë pr' atë paçenxje të madhe çë pate të më kēç haristen ka īnë Zot po të dhuronjë si bëre ti me paçenxje të ligat e të tharëtat të ksaj gjellë keq e mjerë e të më jap dritën të mund njoh errësīrën të këtij dheu e të mund bënjë një ambënore e shëjte vëdeqe.

III. Lipisjarinjë, o shëjte Jëm' e dhëmbësuome, atë dhëmbime keq të madhe çë të shkoi zëmërën kurë zbore tëndin bukurushith e trīdashurë Birë Jesu Krishtin Jerësallim e, tue derdhurë lume lotshi, qajte e je kërkove. Të parkalesinjë çë prë nderë të aso lotëve çë derdhe e shërtime çë shture të lipçë prë pjes meje [148] Theosit hirën të më ndritinjë sītë e të zëes të mos mund e zbierë mẽ ndonjëherë prë pather e mẽ se mbë të tjera ndë herën çë kām të des.

IV. Të lipisjarinjë, shëjte Jëm' e dhëmbësuome, prë atë të madhe vllep çë ti dhurove kurë prostekse tëndin Bīrë të bekuorë, cili me mbëshoren kriqe ndë krah vej udhs të Kalvarit po të vëdis atje, i lodhurë e i grisurë ka dhurimet e ka lakosat. U përpoqtin ahiena, o ime je dhëmbësuome Rregjëresh, sītë me sītë e zëmëra me zëmërën, u njohtin, u gjegjëtin, u dhëmbëtin, u lipisjarëtin! U të parkalesinjë, o Marie, prë pjes të asaj shpëlqeme të madhe çë ti ndjejte ahiena të lusëç ti prë mua tët Bīrë po të më bënjë haristën të qellinjë me paçenxje kriqet e ksaj gjellë e të bënjë të mīrë e shëjte vëdeqen.

V. Më shpëlqēnë, e shëjte Jëm' e lipulluome, prë atë dhëmbime keq të madhe çë ti dhurove tue parë tëndin trīdashurë Bīrë të vëdisij ndë një kriqe anamesa njëqind vllepe, lakosa, thartira, dhëmbime e sëndera e dhunuome, i pa mosnjë levrōmë, ndihëme o rrefrixhërë çë zakonen të jipen nd' ato krede edhe mẽ të ligëvet. [149] U të parkalesinjë prë nderë të asaj mixore dhëmbime çë të shpoi ahiena zëmërën të më kēç ka iti ji ngriqurë Bīrë haristen të bën të pather ruonjë kriqen e vëdeqen e tij e mbi kriqe të zënë e mbë kriqe të serposen mallet e zëmërës time.

VI. Më shpëllqēnë, o shëjte Jëm' e dhëmbësuome, prë atë dhëmbime keq të thelle, të ngurëte e të mixore çë ti dhurove kurë ligullori verbërë i shqori brinjëzit e i lakosi zëmërën me lënxën tët Biri tas i vëdekurë. Ëh, se ajo lakos, Jëma ime, qe gjith jotja. E prana kurë e pē të vëdekurë e gjith të shqerrurë tët Bīrë ndë prëhërin tënd, o, mixore kopanē! Jëma ime, u të parkalesinjë çë prë nderën të aso dhëmbimeve e dhuruome, cilëtë s' mund jenë ndonjë modhi të rrëfjejtura, çë ti mbjodhe ndë zëmërën tënde e qete, të parkalesinjë: lip ti prë mua tit Biri Zotit Krisht po të më lakosinjë zëmërën ashtu thellë me një dhëmbime qiellsore sa mos gjegjëtit mẽ dhëmbime malleshi dheu e bëfça u ashtu një ambënore e shëjtez vëdeqe.

[69] parkalese] parale.

VII. Të lipisjarinjë, o shëjte Jëm' e dhëmbësuome, prë atë thartīrë e helëm pa mosnjë [150] levruome çë ti ndjejte tue varrisurë tëndin Bīrë Jesu Krishtin, tas i vëdekurë. Ti deshe të e lajnje, të e pastronje me duorë tënde e, kurë varri qe i mbëlliturë, zëmëra jote qëndroi e varrisurë atje ku pushoj i gropsurë kurmi i tët Biri. Të parkalesinjë prë gjith ato straxje e martire e lëngime çë ti pate ndë zëmërën e ndë shpirtin, të më lusëç ka īnë Zot ndëlemen e mbëkatëvet, ndihëmen tënde mbë gjellë e mbë vëdeqe e, pas vëdeqes, të më jap doksen e parrajsit. Amin.

Kënëkëz

Ndënë një dhafnëze hjesore,
prej një lipëmi qeperis,
Shën Maria vate u kumbis,
po me zëmurë të helmōre.
Tue shtūnë shërtim ka gjiri,
vllepet qaj çë pati i Biri.

Rrij kundrela gjerit dētë
çë suvalat shtrushëllōme
çaj mbi gurë e trëmbësome
gjindën bëj çë rrij mbi jetë.
Sa mẽ dejti llastimisej,
zëmëra mjerës bën' e i grisej.

Atje pranë mburoi një krua, [151]
ku pra lotët' e saj arrūnë
e me ujet bashk u vunë
aq sa bëtin një përrua,
çë fëtoj gjithien të qaj
prë lipsī me tijin vaj.

Moj ka truolli ndonjë menat
s' qe e luturë natjes voeza,
si ato lot çë sītë e zeza
shtūnë të Virgjëres ndë gjat
mot çë qajti, po s[i] i priti
dheu me mallë e i dëthiti.

Shpirtogjēllë, fiteps e gurë
mbajin hapta veshëtë e sītë.
Tuke gjegjurë valëtītë,
çë me zëmërën të sëmurë
e me faqen verdhulluome
bëj e zez e je helmuome

Shën Maria, qajin edhe:

"Ti, fōrëmadh ka larti qiellë[70]
trīshkëlqemë[71] e i bukurë diellë,
ndë ktë piejturë u përgje!
Si ng' u erre, kurë vëdiq
kush të bër' i murg ndë kriq?

O! Ti u erre, u mīrë e pē,
e gjithia tas u tramaks,
pisa e qielli u trandaks,
hëna u sheh mbrënda ndë rē.
Qajti mali, qajti kroi, [152]
vet mua zëmëra nëng gjëmoi?

Jo, se murga m' u skotis
e m' e zū tas merëngia!
Aq e marr qe ka lipsia
sa t' vëdisij rrij e s' dis;
moj ndë gjellë qëndroi të mẽ
vllep dhuronjë e jo mẽ gjẽ.

Zëmëra ime, e bẽrë si brima
prë një lip i gjat e i thellë,
ka menata ndë ktë gjellë
dritën pā se ka perëndima
vate e mẽ mjeres ng' i vjenë,
ng' e prëlambsën o shkëlqënë.

Më mbëshōnë poka se rronjë
po të qanjë Birin çë zbora?
se më loset po si bora
ndë gjī zëmëra, sa e kultonjë?
Tas e zbora e mẽ s' e kamë,
sa prë helëmin s' dī ku jamë.

Popo, Birë! Si të e harronjë
këthough penxērë çë vë m' përpara
porsa lig dhurove e t' shara
ka Judhīt'? U së mund rronjë,
moj, ndo rronjë, kamë pather qanjë,
njerë çë sītë prë lot i thanjë.

Ato faqez bukurëza

[70] qiellë] hiellë
[71] trīshkëlqemë] trīshkëlemë.

s' mund të spaven mua ka siu,
ku m' e mbuoll Theosi e biu [153]
një harē theosore. Rrëza,
popo, qe njinje e prerë
ndë mẽ buten paraverë!".

Jona Jëm, një lot prë nē
shtīrë asosh çë mundënjin aq.
Me mbëkata jemi kaq
të pështjēllta sa, ndo rē
së na merr ti lipisjare,
qiellin nëng e shohëmi fare.

Me një lot një parkales
ti mbërpārë Birit çë qanë,
e ajo lot nd' ellpiz na mbanë
se nd' parrajsin kemi pjēs.
Truona, o Jëm, kultojna e mba
se edhe bil të jemi na.

Vjershëthi

Parkales prë nē, o Virgjërë e dhëmbësuome,
po të mund kemi pjes ndë taksura të Krishtit.

PARKALESËMI

O Theos, ndër kuj psuome, si tha profexia e të Simeonit, trīëmbëlin shpirt të së lumes Virgjërë e Jëmë Marie shkoi thika e dhëmbimit, ëmna prë lipësī të na, çë tue kultuorë adhoronjëmi të sajat dhëmbime, [154] psuomes tënde trashigofshim pemën fanëmire. Cili gjëllīnë e rregjërōnë prë gjith jetën e jets. Amin.

KURORËZA

e të pes lakosavet

TË JESU KRISHTIT

I. Me rreverenxjen mẽ të thelle e me mallin mẽ të ngrohtë u të puthinjë, o lakos keq e bukurë të këmbs' e mënçërë të timit trīëmbël Jesu Krisht. Të adhoronjë, të tëfalinjë, të bekonjë e të parkalesinjë çë prë nderë tënde e të gjakut çë derdhe pafça hirën të i lipinjë me gjith zëmërën ndëlesën e të fëtesavet.

Thuhet Ini Jāt'. Agëzuosh. Dokse *eç.*

Jesu Krisht, u adhoronjë
të fanmira ato lakos
me k' më hape ti, o Theos,
dreq parrajsin çë kërkonjë.

Ka një lus këndohet kjo strof.

II. Zot' īmë, trīëmbëli Jesu Krisht, u me rreverenxje të madhe e të thelle adhoronjë e puthinjë atë lakos çë ti dhurove prë mua te këmba e djathte e të parkalesinjë me mallë të dhezurë çë prë nderë të asaj lakos e të gjakut çë derdhe k' ajo më pafçë [155] lipisī e më bëfçë hirën po të ndilëgonjë sa të fëtesa, po të metanosemi e të bënjë penitenxje e të mos bie më ndë mbëkata prë gjith gjellën time.

III. Imi Zot, trīëmbëli Jesu Krisht, u me rreverenxje të madhe e të thelle adhoronjë e puthinjë shëjten lakos çë ti qelle prë mua te dora e manxhinëte e të parkalesinjë me zëmërën ndë gol çë, prë nderën të asaj lakos e prë gjakun e të shëjt çë derdhe k' ajo, po të më japçë ndëlesën të mbëkatëvet e doksën e stoneonëme të parrajsit çë aq herë e kamë zbjerr tue dashurë kriathirat e të dheut.

IV. Imi Zot, trīëmbël Jesu Krisht, u me çerën të përtrollurë thellisht adhoronjë, bekonjë e puthinjë shëjten lakos çë ti prë namurin tīmë pat dhuronje tek e djāthta dōrë e të haristisinjë, Zoti jīmë, me zëmërë të mallisurë prë namurin çë më zbulove e të parkalesinjë edhe çë prë nderë të asaj shëjte lavomë, prë gjakun çë derdhe e prë namurin çë më solle po të bëfçë të u gjëllifça pa fëtes mbi dhē e të dāfça vetëm tij çë qeve shëndeta e dheut.

V. Imi Zot, trīëmbëli Jesu Krisht, u me rreverenxje të madhe e të thelle adhoronjë, puthinjë e bekonjë lakosën çë prë nderë [156] meje të shqori brinjëzit e të dëpërtoi zëmërën e gjak bën e derdhi e uj. U me zëe të mallipsurë , Zot' īmë, të haristisinjë e të parkalesinjë çë prë nderë të asaj lakos e të gjakut çë derdhe e të namurit çë më solle po të më kēç lipisī edhe e të më japçë dhëmbimen e metanien të mbëkatëvet, të më lefteroç ka pisa çë meritova me to e të më japçë parrājsin çë zbora tuke dashurë kafshat e kriathirat e të dheut.

Kënëkëz
[**Vexilla Regis prodeunt**]

Të Rregjit hapet fjamuri,
shkëlqënë fëshehta kriqe.
Vëdeqe, ti, e lakosurë
ka gjella, tas vëdiqe.

Një lënx i hapu brinjëzit
Rregjit e gjerë shtëlloi
me gjak e uj mburuomja
xhukie çë na sallvoi.

Ashtu vërtetëm u dukëtin
vjershet çë Davëdhi tha,
kurë Zotin para njerzëvet
mbi drū buftuorë e la.

Shkëlqēm, ghavnarith arvurë
me purpurë i pastruorë,
mbi gjith ti qeve i zgjedhurë [157]
ka Krishti e i nderuorë.

O lumi ti çë mbajte
mbë llōrë kë bjejti dhenë!
Pisën, me duorë të mbrazëta,
lëreu ndë madhe penë.

Kriqe, gëzuosh, e vetëme
ellpiz ndë mote lipi.
Hirën ti madh të butvet,
ndëles të ligëvet jipi.

Tij, Trīnitat, shëndetje
krua, të laudhofçin shpirtërat
gjith e kuj dhē vitorjen
të kriqes jip parrajin.

LUSE

Psuomes të Jesu Krishtit

Zoti Theos çë po të bjejnje dheun, të shiturë me tijat fëtesa dhimonit, deshe të lehshënje si burr, deshe të ishënje i pagëzuorë, i rriprovarturë ka Judhītë, i tradhizuorë ka Judha me një të puthurë; deshe të ishënje i lidhurë e, si qëngj i pafëtes i xarrisurë ndë kasap, tërpruomisht i qellurë përpara Anësë, Kajfasit, Pillathit e përpara Erodhit; deshe t' ishënje i paditurë ka martirī të rrëmë, i rrahurë,

i shajturë, i qellurë dhunë, i pushtiturë, [158] kurōrëm gjëmbashi, i sqepurë ndë faqe, i përqeshurë, i dëmtuorë, i shpiturë të binje; deshe të ishënje i përmisurë, i xheshurë, i shtruorë e i gozhdhjasurë ndë kriqe; deshe të ishënje i ngrëjturë lart, vënurë anamesa vjedhtarëvet, potisurë me uthull e thartīrë, i shkuorë me një lënx e desh t' derdhënje një lum gjaku; ti, Zot' īmë Jesu Krisht, prë nderë të kso vllepve, çë u nani kultova, të kriqes tënde e të së tëndes psuome, lefterōjëm ka pisa, ndëlejëm fëtesat e thërritëm ndë parrajsin si thërrite vjedhtarin të mīrë çë vëdiq i ngriqurë bashk me tij çë gjëllīnë e rregjërōnë prë gjith jetën e jets. Amin.

Vjershëthi

Zot' īmë Jesu Krisht, fëshehëm ndë lakos
çë të m' leftrojnje pate ti, o Theos.

PARKALESËMI

Zoti Jesu Krisht, Theosi i zëmërës time, prë ato pes lakosa çë Tij ndë kriqe ini namurë të bëri, gjegj shërbëtorit tënd, cilëtë ti bjejte me një gjak keq i paçëmuem. Ti çë gjëllīnë e rregjërōnë prë gjith motin. Amin. [159]

TËFALËME PRËSHËJTIT SAKRAMEND

Vënurë Sakramendi mbi lartarin, si ësht zakōnë, tue livanisurë këndohet kjo

Kënëkëze
[**Pange, lingua**]

Këndo, gjuh, të doksuorit
kurm të Krishtit mistikōnë
e të gjakut çë na bjejti
ka fëtesa e na sallvōnë
me një pemë çë ndëjti[72] njerzëvet
Rregji i madh i rregjëravet.

Neve i dhënurë, neve i lerë
ka këthjellma Virgjëre,
dheun e bëri të lefterë
me urtërīnë të shprishure.

[72] ndëjti] ndëjte.

Gjellën e tij të shëjt e shkoi,
thavmasīshi gj[i]th e mbjoi.

Kurë ai darkoi të prasëmen
herë me të vëllezërit,
bëri Lexhën e bëri dasëmen
si Mojsesi, e atirëvet
Kurmin tij i dha prë ngrënë,
me k' shënden' e gjithvet bënë.

Fjala mish e buk vërtetëme
mishtë u bẽ te Fjala;
verën tas të mīrë të dreqte [160]
gjak e bënë; e ligjja
nëng sheh e nëng ndilëgōnë
sa një zëmërë e besëme arvōnë.

Arvuorë këtu, këndoseri lẽ e prifti dhjavasën këtë luse, ndose bënet ndë qish tëfalëmja prë gjith; ndomos e thua si mẽ të pëlqënë.

LUSE

Njota, Zëa ime, se gjënde përpara Zotit tënd, cili u burrësua prë të madhin mīrë çë deshi tij. Ni ti adhoroje e penxo se një Theos keq i madh gjëndet mbë trīshëjtin Sakramend. Përdashuri Jesus īmë, u kamë bes se ti gjënde mbë Shpirt, Kurm e Theosī mbë këtë trīshëjt Sakramend namuri. Ti jē Theosi i gjith ellpizavet e ka taksurat çë ti më bëre u pres të kemë gjith të mirat. U dī se gjaku īt më ndëlënë mbaru fëtesat e më hapën udhën e të parrajsit.

Andajna lusinjë me mallë të dhezurë e të thellë ndihëmen e shëndoshëme të atij Gjaku. Sakramendisuri amuri jīmë, ti çë shprishën atidreqa lambsa karitatje e malli qiellisht çel e dhez këtë ftohëten time zëmërë e bëj të detë pather tij e prë sa tij të nget e asaj lipset. O Theosi [161] īmë, u doja çë të dheu gjith t' ish i dhezurë ka iti shëjt namurë e çë të gjith të duojin tij çë jē i trīmiri, i trīmadhi të gjithvet. Ajlimono, Zoti īmë, u, mbre se të të donja e të bëja sa ti meritonje, u të fëtesa e të mangova aq sa të mund kemë zbjerr parrajsin e merituorë pisën.

Zoti īmë keq i mīrë, njota, nani u metanosemi, të lipinjë ndëles me të gjith zëmërën e ti bëj me haristen tënde të mos bie mẽ ndë fëtesa.

Stoneonëmi Theos, u të hiripsinjë pse më dhē tëndin Bīrë Jesu Krishtin mbë Sakramend, hiripsinjë edhe tëndin Bīrë pse pati lipisīnë të qëndroj ashtu mbi dheun bashk me nē të varfërit. Të hiripsëçin prë mua ëngjëlit, shëjtërat e shpirtërat të mīrë.

Jesus īmë, ti dhē gjith vetëhënë tënde prë mua. U të mbërparinjë edhe mbë sakrifix gjith ditën kurmin, skiset e zëmërën e shpirtin. Sa kamë, sa mundinjë e sa jamë qoft tëndëtë e jo timëtë mẽ.

Zoti Krisht' īmë çë jē e rrī mbë Sakramend si burr e si Theos me një fuqī e fōrëmadhī çë s' kā thëni e me një ulëtī ashtu e thelle sa së mund rrëvohet; sakramendisuri Zot' īmë, mirr vesh lusat time, [162] pse u të parkalesinjë prë pjes të gjith dheut: prë vetëhënë time, prë prindëtë, prë gjërīt, prë gjitōntë, prë miqëtë, prë të njohurit, prë ata çë më mīrëbëtin, prë armiqtë, prë ata çë më dëmëtin, prë të besëmit, prë ata çë nëng të njohën e së të kanë bes. Jip gjithvet dritën çë i lipset të të njohën, të të skamallisënjin, të metanosen mbëkatashit, të të duanë, të t' shërbenjin me mallë e dreqtī po të mund sallvohen.

Mos harro, o Zot, të sëmurmit, ata çë lëngonjin o tëhelqënjin. Dërgoji sa i duhet të mund gjëllinjin tue njohurë e tue shërbierë tij. Kulëto, o Zot, e derdh me duorë të hapta ujet hirisëme e mburuome të së tëndes qiellsore lipisī mbi shpirtërat e përghatuorit, ndëleji vllepet zjarrullore e tilëqi të trashigonjin prë pather ndë parrajsin harenë e të faqes tënde.

Serposurë lusja, tue livanisurë këndohet qëndruomja e të

KËNËKËZES
[**Tantum ergo**]

Ni trīmadhin Sakramend
të përgjunjërë falëmi
e të moçëmin dokumend [163]
me të rīnë bekonjëmi,
se pse besa arrẽnë mbë vend
ku me skis ngë hinjëmi.

Gjith e të Jatit e të Birit
doksa qoft' e hàjdhi,
doks e nderë të fanëmirit
Shpirt, çë ngrohu e lajti
dhenë mbëkatashit. Harē
pafçin Trī mbë një vetëhē.

Vjershëthi

I dhē të hain, Zot, bukën qiellsore,
e shëjte, gjith pëlqeme, e ëmbëlore.

PARKALESËMI

Theos çë neve mbë thavmasuorin Sakramend kultuomen na lē të së tëndes psuome, ëmna, të truhemi, të duomi e të nderonjëmi ashtu mistikosëtë të Kurmit e të Gjakut tënd sa të mund kemi pjes ndë pemat e të bjejtures çë ti na bëre, çë gjëllīnë e rregjërōnë prë gjith stoneonën. Amin.

Bekuorë ç' ësht me Sakramendin gjindja, mbllihet funxjona tue thënurë

Laudhuorë, bekuorë, doksuorë prë pather qot
Trīshëjti Sakramend ndë gjatin mot [164]
të stoneons e Virgjëra Marī
qoft e bekuorë ka dita me hajdhī.
Jesus, Maria, Josef, ti na beko;
ndë gjuh, ndë shpirt, ndë fjal me nē mëno.

NËNDORE E XI

SHËN MARIES TË TRONDOFILERIT

1. O Marie, lile saftesëme dulie, prë nderë të asaj hajdhī çë pate kurë ëngjëlli të fali e të tha se kishënje konxhipisurë e mbanje ndë shkëfin[73] të virgjërisht të Birin e Theosit, lejëm të njoh mīrëbëmen të madhe çë më ngau tue pasurë prë vëllā Jesu Krishtin e tij, o fōrëmadhe Zonjë, prë Jëm.

Thuhet ka një luse një Agëzuosh *e* Dokse *eç.*

2. O Marie, pasqīrë e prëshkëllqeme umilltatje, prë atë hajdhī çë pate kurë xure se jot kunate Lizabeta ish me barr e vajte nje të e gjënje, le zëmërën time po të gjënjë hirën e të Theosit e çë mos u llarghoft ndonjëherë ka shërbemja e tij.

3. O Marie, Jëm' e mburuome karitatje, prë atë hajdhī çë pate ahiena kurë te grazhda e Betëlemit u zdorgje[74] e leu [165] tas ka ti shelbuési ji dheut, bëj çë gjella ime qoft pather e mburuome bëmashi të shëjte po të meritonjë ashtu shëndetën të stoneonëme.

4. O Marie, dhaskaleshe thavmasore gjegjurie, prë nderë të asaj hajdhī çë pate kurë, po si urdhësonej nomi dhënurë ka Theosi Mojsesit, ti qelle ndë Qish prë të parëzën herë tëndin theosëm Bīrë, ëm çë u bëfça duanisht urdhërat e nomit të Theosit po të meritonjë pas vëdeqes të jem' i mbërparturë tek Qisha e të dokses[75] stoneonëme të së tij.

[73] shkëfin] skëfin.
[74] zdorgje]zdorrgje.
[75] dokses] doksej.

5. O Marie, metërë e rīshkëlqeme paçenxje, prë atë hajdhī çë pate ahiena kurë kishënje zbjerrurë tëndin përdashurë Birë e pra e gjëjte pas trī dit anamesa t' urtëvet, çë i përhapij e porsij vërtetën e të Nomit, bëj ti çë m' u prjerrtë mua hiri i tīnë Zoti e mos qofça i mundurë kurraj ka armiqtë.

6. Virgjërë e dhëmbësuome, prë nderë të asaj të dhezure luse çë bëri Jesusi ndë kopshtin e Gjetësémanit e prë namurin e atij gjaku çë ai dërsiti, tue bunarturë gjith vetëjuin njera çë rrëvoi të potisij kuazi truollin, u të parkalesinjë e të truhemi të dhezçë lusat time me [166] tëndin zjarr të shëjt e të më japçë një metanī të vërtetëme të së timavet fëtesa e fuqinë të mos bie mẽ kurraj.

7. Virgjërë e dhëmbësuome, prë nderë të së rrahuravet e të dhëmbimit keq të madh çë dhuroi Jesu Krishti prë pjesën time tek pretori i Pillathit, të lusinjë të më japçë shpirtin të metanies e një vërtetëme duanī, po të pagūonjë dreqërisht justīxjen e Theosit.

8. O Virgjërë e dhëmbësuome, prë ato të liga shtërguome çë dhuroi Jesu Krishti kur' i vunë kurorën gjëmbashi e prë ato dhënime e të shajtura çë dhuroi prë timet mbëkata, ti thjellmoj timet penxjere, dulirëm trūtë e dreqëto gjith bëmat time prej nomin të Theosit.

9. O Virgjërë e dhëmbësuome, prë atë trīrënde mbëshuome të kriqes me k' shtërguonë krahëtë e Jesu Krishtit tue vaturë ndë Kalvarin e prë gjith ato herë çë, shpiturë, vate rā asaj udh, ëm edhe mua të mund qellinjë me paçenxje kriqen e këtij dheu e tue rrënuorë prë gjith motin bëmat mishërishte të duanies time çë më luftōn.

10. O Virgjërë e dhëmbësuome, prë nderë të asaj dhëmbime keq të madhe çë [167] dhuroi Jesu Krishti kurë qe i gozhdjasurë mbë kriqen, prë të shajturat çë pati e prë të helqurat çë shokëruonë vëdeqen e së tij, të truhemi të japçë edhe mua fuqīnë të mund bëfça si bëri ai e të kemë ashtu ndë herën e të vëdeqes time pemat e gjakut të atij.

11. O Rregjëresh, Jëm e Theosit, prë atë harē çë trashigove kurë pē të ngjallurë e të pjono dokse tët Birë[76] ndë Pashqit, truhemi po të lëfçë zëen time të mund ngjallet ndë hirin e Theosit e të mund dal e doksëme ka duort' e t' armiqëvet të saj.

12. O lartullore Regjëresh të qiellëvet, prë nderë të asaj harē keq të madhe çë ti trashigove tue parë tët Birë çë doksuorë vate u hip ndë parrajsin tue lënurë dhënë, bëj ti çë zëmëra ime u ndaft ka gjith mallet e të dheut e shërtoft prë pather doksen e trashiguomet të stoneonëme.

13. O Rregjëresh, Zonja e gjithies, prë atë harē ëmbëlore e të madhe çë pate kurë u gjënde përpara ndë t' ardhuren doksore të Shpirtit i Shëjt, të truhemi të e lusëç prë nderë meje po të vinjë edhe ndë shpirtin tīmë e të e mbjonjë me tijat dhëna. [168]

14. O Rregjëresh, Zonja e t' ëngjëlvet, prë atë harē çë trashigove ahiena kurë u pē e qellurë doksorishte mbë qiellë, anamesa llojevet ëngjëllore, lej ti shpirtin tīmë të të shokonjë allmonu [me]

[76] Birë] Biri.

dishëruomen, njera çë të rrëvonjë ajo fanëmire herë çë të përzihet me tij prë pather ndë të lumen trashiguome të Theosit, çë bënë parrajsin.

15. O Rregjëresha e gjith shëjtevet, prë atë harē çë trashigove kurë u pē kuroruome nderje e doksje e je njohurë e je tëfalurë ka qielli, ka dheu e ka pisa, bëj ti çë u të njohça e pafsha prë Jëm, prë ndihore e prë zonjë ndë gjith lipset time e prë kaq të dafça, të ruofsha e të kërkofça me gjith mallin e të zëmërjes time. Amin.

Kënëkëz

Ju njerz, çë harruora
pushoni te dheu,
kuj zëmërat lënguora
tas jeta rrëmbeu,

ndo duoni hajdhī,
ndo lutëni harē,
trīlarten Marī
thërritëni mbi dhē. [169]

Ndë lipe, levrōm,
ndë liga, dhurīm,
Ndë malle jep levrōm,
jep gaze mbë shërtīm.

Ndo lutëni, ndo doni
te gjella lipisī,
hariste ndo kërkoni,
thërritni: "O Marī!".

Maria me pëlqeme
na mbjonë e namurë,
Maria pa të rreme
na mbanë e pa kurë.

Ellpizën Maria
na[77] ngjallën e lartonë,
me bes ndë hajdhia
krështea na bukurōnë.

Marien na doksomi
me zëmëra mbë malle.
Thërresëmi, via, thomi
ndë lodra, ndë valle:

[77] na] ne.

"Marī, jona Mëm,
Marī, jona harē,
Marien gjith prë Jëm
do t' kemi mbi dhē!".

Me atë na te gjella
ndo rronjëmi një dit,
ndër llaka të thella
prë mot e prë vit, [170]

na duket e ëmbël
si pikza e mjalit
te labrëth' i vogël
buftonet të djalit.

Ndo fjëmi, ndo rrimi,
shërbenjëmi o pushonjëmi,
ndo hami, ndo pimi,
ndo qanjëmi o shërtonjëmi

tue thirrurë Marīnë,
na duket mīrë e dreq,
na madhën hajdhīnë,
na nxier ndë të keq.

Të birin e jëma
me mẽ namurī
së lusën ndë mbrëma
t' e shoh prë ndë shpī,

si lutën kjo Zonjë
me të po të ketë
dhivot[’t] çë t' e laudhonjin
shërbenjin te kjo jetë.

Te gjella na shokōnë,
mbëkatëvet thërret,
të mira na dërgōnë,
te deqja na pret.

Djallin e përmisën
te pisa të rrjerë,
lipsjare na hirisën
ka mot e ka herë. [171]

Andajna, ndo malli
të qīellit na shtrëngōnë,
me keqa ndo djalli
kanosën e na shtrëmbōnë,

trīlarten Marī
thërresëmi pjota bes,
e ajo me hirī
na mbjonë e me ndëles.

Vjershëthi

Trīmadhja Prindëresh e Theosit, parkales prë nē
po të mund kemi pjes ndë taksurat të Krishtit.

PARKALESËMI

Theos, të kuj i vetëmi Bīrë prë gjellën, vëdeqen e të ngjallturen së tij neve të shëndets të stoneonëme na bjejti paguomet, ëmëna, truhemi, çë prë këta mistikose të trīshëjtit Trondofilērë të së lumes Virgjërë Marie, çë adhoronjëmi, e të bënjëmi po sa na porsinjin e të mund kemi po sa na taksënjin. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin. [172]

MISTIKOSËTË
E TË TRONDOFILERIT

MISTIKOS HAJDHIE

I. Tek i pari mistikos hajdhie, tue thënë një *Ini Jātë* e dhjet *Agëzuosh o Ti Marī,* vemi tue penxuorë po si Virgjëra shëjte qe je tëfalurë ka ëngjëlli Ghabriellë, cili i tha se kesh t' mbarrej me hariste qiellsore e kesh t' zdirgjej tue dhënurë dheut tënin Zot Jesu Krishtin.

I. Ini Jat, çë ndë qiell rrī,
ëmërin tënd bekonjëmi na,
ç' ësht i pjot me shëjtërī;
rregjia jote ārt' nd' ata
çë duanīnë tas bënjin tënde
si mbi dhē ndë qiell, ku gjënde.

Ti ka dita bukën neve
çë na lipset, Zot, dërgo;
se dëtirëtë na ndëleve,
si na tjervet, ti bufto;
Mos na[78] le ndë tendacjona;
keqashit ti lefterona. Amin.

II. Agëzuosh o ti, Marī,
çë me hīrë e pjono jē;
ini Zot me tij rrī,
se mbi grātë i pate hjē;
ti e bekuorë, e bekuorë qot [173]
karpoi it, Krishti īnë Zot.

O Theosit shëjte Jëm,
prë ne gjith pjono fëtes,
pjot me lip e lot e nẽm,
Birin tënd ti parkales,
si ndë vëdeqen tënë, nani,
po të vinjëmi, o Zonjë, ati.

Thuhet dhjet herë e, kurë mbarohen, thuhet Dokse, eç. *e prana këndohen këto*

Kënëkëza

Marī, Jëm e madh hirie,
lum mburom' i lipisīe,

[78] na] ne.

ti na mirr ndë deqe tona
e ng' armiku lefterona.

Dokse tij prë pather qot,
çë ka Virgjëra leve, o Zot,
e me tij Jāti doksuorë
qoft' e Shëjti Shpirt bekuorë.

U tij, o S[hën] Mërī,
këtë laudhim dërgōnjë;
ti prite mbë hajdhī
e t' mira mua dërgo.

U jetërë nëng shërtonjë
ndomos po të ndëles
të shpirti bẽn të çonjë
te Zoti ka ti pres.

II. Tek i diti mistikos hajdhie, tue [174] thënë një *Ini Jāt'* e dhjet *Agëzuosh o Ti Marī*, vemi tue penxuorë porsa e lumja Virgjërë Marie, sa xuri ka gola ëngjëllit se je saja kunat Shën Lizabeta ish me barr, u nis njinje e vate të e gjënej tek shtëpia e saj e mënoi atje trī muoj bashk me të.

Ini Jātë, Agëzuosh *e* Dokse, *si u tha*.

III. Tek i treti mistikos hajdhie mënonjëmi tue kultuorë posi, ardhurë moti të zdirgjej e lumja Virgjërë Marie, u zdorgj te Hora e Betlemit ndë herën e të mjeznats e, vënurë Jesu Krishtin ndë një haore katrëmbçi tek grazhda ku gjëndej, gëzohej e merëngonej.

IV. Tek i katërti mistikos hajdhie mënonjëmi tue kultuorë posi e lumja Virgjërë Marie tet dit pas ç' u kish lerë Jesu Krishti e qelli mbë Qish po të bënej si lexha e Mojsesit urdhëroj e je vū ndër llōrë të pllakut Simeonë.

V. Tek i pesëmi mistikos hajdhie mënonjëmi tue penxuorë posi Maria Virgjërë zbori të Birin e më e kërkoi prë trī dit e tek e treta mbë serpos e gjeti ndë Qish anamesa daskallve, cilëvet' i kallëzoj e përhapij Lexhën, po me gjith se ghanjun ish dimbëdhjet vjeçi. [175]

MISTIKOSËTË DHËMBIMI

I. Tek i pari mistikos dhëmbimi, tue thënë një *Ini Jātë* e dhjet *Agëzuosh o Ti Marī,* mënonjëmi tue kultuorë posi Jesu Krishti, kurë parkalesi prë nē te kopshti i Gjetësémanit, dërsijti gjak.

II. Tek i diti mistikos dhëmbimi mënonjëmi tue penxūorë posi Jesu Krishti ka prëkeqi Pillath qe i lënurë ndë duorë të Judhivet po të ish i rrahurë e i qenë dhëna gjashtmil gjashtqind gjashtdhjet e gjasht kopanē.

III. Tek i treti mistikos dhëmbimi mënonjëmi tue kulëtuorë posi lipisjari Jesu Krisht qe i kurōrturë me gjëmba të shposore e të tharëta.

IV. Tek i katërti mistikos dhëmbimi vemi tue penxuorë posi Zot' īnë Jesu Krishti qe dëmtuorë të vëdisij e Judhītë, se të i jipëjin mẽ të madhe turp e dhëmbime, e shtrënguonë të qellij ngrah drurin e të mbëshūomes kriqe.

V. Tek i pesëmi mistikos dhëmbimi mënonjëmi tue kulëtuorë posi Zoti īnë Jesu Krishti, arvuorë tek mali ji Kalvarit, qe i xheshurë e i gozhdjasurë mbë [176] kriqe me të ngurëta gozhda, përpara të Jëms e trīdhëmbsuome.

MISTIKOSËTË DOKSJE

I. Tek i pari mistikos doksje, tue thënë një *Ini Jāti* e dhjet *Agëzuosh o Ti Marie,* mënonjëmi tue kulëtuorë posi Zoti īnë Jesu Krishti të tretën dit pas asaj, tek cila vëdīq, u ngjallë, u ngre vetëm ka varri trīnderëm e i doksëm po të mos vëdisij mẽ kurraj.

II. Tek i diti mistikos doksje mënonjëmi tue kulëtuorë posi Zoti īnë Jesu Krishti, pra çë duolli i thavmasuorë ka varri, u hip me të madhe krëmte ndë parrajsin, tas çë kish mbeturë katërëdhjet dit bashk me të Jëmën e me apostojit.

III. Tek i treti mistikos doksie mënonjëmi tue penxuorë posi īnë Zot Jesu Krishti, ulurë tek e djathta e të së Jatit, dërgoi Shpirtin të Shëjt ndë shtëpīnë ku rrijin të mbëledhurë apostolit bashk me Sh. Marien.

IV. Tek i katërti mistikos doksje vemi tue kulëtuorë posi fōrëmadhja Virgjërë Maria, dimbëdhjet vjet pra çë Jesu Krishti mundi e vrau vëdeqen, shkoi ka kjo [177] tek jetëra gjellë, e qellurë ka ëngjëlit shpirt e kurm ndë parrajsin.

V. Tek i pesëmi e prasëmi mistikos doksje mënonjëmi tue penxuorë posi Maria Virgjërë ka i Biri Jesu Krishti qe kurōrme Rregjëresh e të gjithies e doksen edhe kulëtonjëmi të gjith shëjtevet.

Këndimeza

Ti gëzou, o Rregjëresh,
çë jē Jëma e lipisies,
ëmbëlsia e gjelluries.
Rregjëresh, ti u gëzo.

Na, me llōrë alartaz vëna
e me faqet ka ti prjerra,
thirrëmi: "Ndih, via, na të zbjerra,
ka dëludhi na leftëro!".

Bila t' Evës sfanisore,
ndë ktë zallë të llargh dërguora,
merëngōre, të luftuora
līgëvet rënda, mos na le.

Ndë ktë llak pjono hjidhī,
pjot me lip, thella dëmbime,
lusëmi murga me shërtime
ndo ç' e pafçim një harē.

O ndihore madhe jona,
prīrë mbë nē shkëlqemet sī
pjota gaz, harē, lipsī[79]; [178]
mos lëshojna mjere ashtu.

E karpoin tënd fōrëmadh
nevet varfërë, via, buftoje,
Zotin Krisht; prana lëshoje[80]
gjalëmërin çë na mbanë këtu.

O ndër Virgjëra ti fānmira,
ti fōrëmadhe, ti ghavnare,
ti mẽ e bukurë e lipsjare,
vet ka qielli e dashurë ti,

trondofile kuqullore,
o Marie madhe e trīlart,
mos dhuro të na të thart
rrīm' ndë dhē e thirrën' ati. Amin.

LITONIA E TË LUMES MARIE VIRGJËRË

Kyrie, eleison, Christe, eleison, Kyrie, eleison eç.

Jātë i Qiellit Theos - Bīrë, leftërorë i dheut, Theos - Shpirti Shëjt edhe Theos - *Pafçë nevet*[81] *lipisī.*

[79] lipsī] lipisī.
[80] lëshoje] lëshose.
[81] Nevet. Variatio, invece del solito neve.

Shëjte Trīnitat mbë një Theos - *Lipisī ti paç prë nē.*
Shëjtja Marī
Shëjtja Jëm' e Theosit
Shëjtja Virgjërë e virgjëravet - *Parkales prë nē.* [179]
Jëma e Jesu Krishtit - *Parkales prë nē.*
Jëma e theosorit hirë
Jëm' e thjellëmore
Jëm' e trīnderëme
Jëm' e pangarë - *Prë nē ti parkales.*
Jëm' e safëtesëme - *Parkales prë nē.*
Jëmë prë me u dashurë
Jëmë thavmasore
Jëm' e Krioserit - *Prë nē ti parkales.*
Jëm' e Shelbuésit
Virgjërë prënoreme
Virgjërë je doksuome
Virgjërë e predhkarishte
Virgjërë fuqisore
Virgjërë lipisjare
Virgjërë besullore
Pasqira e justixjes
Throni i urtëries
Pjazëma e harësë
Nekue shpirtullore
Nekue prënderore
Nekue prëdhivocjon'je
Mistikosëme trondofile
Fōrëmadhja turr e Davdhit
Turr je avorishëte
Shtëpia e ārësuome
Arrka e të besjes
Dera e qiellit - *Parkales prë nē.* [180]
Illi ji menatjes - *Parkales prë nē.*
Shëndeta e sëmurmëvet
Rrëfuxh i të fëtesmëvet
Levrom' i të lakosmëvet.
Ndihëma e të krështerëvet
Rregjëresha e ëngjëlvet
Rregjëresha e patriarkvet
Rregjëresha e profetvet

Rregjëresh' e apostulvet
Rregjëresha e martërvet
Rregjëresha e skamallerëvet
Rregjëresha e virgjëravet
Rregjëresha e gjith shëjtevet
Rregjëresha e shëjtit Trondofilerë - *Parkales prë nē*.
Qëngj i Theosit, çë dheut mbëkānë ndëlënë,
ndëles prë nē bufto.
Qëngj i Theosit, çë dheut mbëkatën nxierë,
ka qielli, o Zot, na gjegj.
Qëngj i Theosit, çë dheut mbëkatat lanë,
lipisī nevet bufto.

Vjershëthi

Parkales prë nē Shëjtja Marī, Jëm' e trīshëjtit Trondofilērë,
po të mund meritonjëmi pjes ndë të taksurat e Krishtit. [181]

Parkalesëmi

Jip neve, të parkalesëmi, o Theos, shëndetën të shpirtit e të kurmit e, prë nderë të të lumes Virgjërë Marie, Jëm të i të[82] shëjtit Trondofilerë, të mund jemi këtu të lefteruom ka helëmet e tek gjella e stoneonëme të pushonjëmi anamesa harevet. Prë Krishtin Zotin tënë. Amin.

Kënëkëz
S[hën] Maries të sëmurmëvet

Kamë ndë zëe një māll' i thellë,
Jëma ime qiellësōrë;
doj t' e nxirënja, e mosnjë dorë
çova tas të m' e shëroj.

Hiri mbrënda parën herë
pjes ka veshëtë e pjes ka sītë;
gjakun mundi, eshtrat, dellītë,
mbjatu arvoi ku desh t' arvoj.

Gjeti zëmërën[83] e m' e lidhi,
çoi oreksën e m' e vodhi,
muori ligjën e m' e zdrodhi,
sa këshilli m' u çotjas.

[82] Si noti la sequenza di articoli prepositivi.
[83] zëmërën] zëmërëa.

Ç' aso herje u te jeta
nëng e pata një pushīmë;
jamë te zjarri, jamë ndë brīmë, [182]
u vetëhënë nëng dī kuj gjas.

Tej, këtej si fjamurë vete,
nëng pushonjë te ndonjë shërbes;
vete e vīnjë e pra çë pres,
çë të dua, u s' e ndilëgonjë.

Nëng e njoh ndo i llavurë jamë,
ndo mbë gjellë e mistkosime
më t' xarriset jeta ime,
ndo tek ajri fjuturonjë.

Shtrushi i lumëvet më tramaksën,
gjakun piksën shkepëtima,
më trandaksën bumbullima,
thīrma e dejtit më shtrëmbōn.

Natën e ditën kam nodhìe,
prodh ngë gjënjë te ndonjë vend,
jam' i nëmurë, jamë skutjend,
gjindja gjith më trëmbësōn.

Shtridha bare e m' i dëthita
po se t' ishin mua jatrī;
ku, se mbjatu mẽ hjidhī
bën' e shtura e keq mẽ jam.

Prita motin, ellpizōrë,
të m' shëroj e moti arvoi;
moj, si erëdhi, spavu e shkoi,
e shëndēn si e kishënja e kam.

Njoj, nani dhezurë të solla
trī qërī me zëe mbë mallë.
Gjegjëm, o Jëmë, e një sinjallë [183]
se më ndiejte m' e bufto.

U t' e thomë si dallanisha
çë mbi dejtin fjuturōnë.
Kurë e lodhurez kërkōnë
mẽ fuqī e s' kā ajo

e një fuqī po ligullore
posht e tilqën, mjerë!, mbi detë,
bie e zeza, e ruonë ndë jētë
se nëng ësht ndihëm prë të.

Nd' atë lipse keq e madhe
vetëm' e lënë, pendat skotisën
pak mbi uj; mbiturë, spovisën.
Shoket venë çë qenë me të.

Dallanisha si nd' at mot
mund lutoj ndihëm njeriu.
Ashtu mua ndë zëmërë biu
një këshīllë: dua të t' e thom

lipsen time e kam' ellpize
se ti, Jëmë, çë zëen më sheh,
ruon sëmundën e m' e njeh,
e m' dërgōnë prasëmen shërōm.

Ndo m' e luta këtë herë,
Mëma ime, kush e thot?
Aq e kamë zëen të pjot
me dishërīme sa ng' e thash

ndonjë herë o mund e thomë:
mẽ se i urëti do ndonat,
mẽ se ujtë dheu i that, [184]
se stolī lutën një vash.

Po si gruaja ç' ësht me barr
dishërōnë një djal i mīrë,
lutinj' u këtˈ ëmbëlë hīrë
e ka ti lipsjare e pres.

Sa më zgjidhën këtë nënje,
sa m' shërōnë këtë lavōmë,
trashigonjë ndë gjellë pushōmë,
mbë duorë tënde mund vëdes.

Këndimez

Alighorī të shpirtit i fëtesmurë
mbë një delez, cila, e zbjerr, priret prë
vetëhënë tek i zoti

Mblidhe, Zot, se nani vjenë
ajo delez çë t' u zbuorë.
Ruoje mīrë, të qofça truorë,
nd' ësht ajo, çë jotja qe.

Shih ndo faqja i shkëlqenë
me të moçëmen ambënī;
njihe mīrë ndë bāllt' e sī
nd' ësht, si ish një herë, edhe.

Rā mbë dīrë të lartit qiellë,
mẽ nëng ësht si qe ahiera.
Pjot me liga, tas e miera [185]
njohu ani të larten bes.

Merëngore ballin siellë,
por me thelle një lavōmë;
moj thërret, dhëmburë: "Shërōmë
gjith të bërat time ftes!".

Qe xarrisurë, moj rrëmbeje
prë lipsī ka thelli grēmë,
përse ani lipën ndëlēmë[84]
pjot me lip e lot ajo.

Via, ndëleje, o Zot, ndëleje,
harro gjith bënat e keqe.
Laje ti, pastroje, ndreqe,
me[85] të tjerat e nëmëro!

[84] ndëlēmë] nthëlēmë.
[85] me] më.

URTËRIA
E TË KRËSHTERËVET

Pjejtura. Çë kā të bënjë një i krështērë po të mund sallvohet?

Përgjegjura. Kā të ketë bes e kā të bënjë sa thot e i porsinë lexha e tīnë Zoti e rīnjohurë e je përhapurë ka Jesu Krishti.

Pj. Mbë çë ësht e mbjedhurë mẽ tepërë besa e Jesu Krishtit?

Më. Ndër di mistikos çë janë të mbllira mbë nishanin e të shëjtes kriqe, dua të thomë se īnë Zot ësht një Theos mbë [186] trī vet, Jātë, Bīrë e Shpirt' i Shëjt, e se i Biri u mishërua e vëdiq të na sallvoj.

Pj. Çë vjenë me thẽnë se īnë Zot ësht një Theos mbë trī vet?

Më. Vjenë me thẽnë se īnë Zot kā një të vetëme theosī, një esenxje e një naturë të theosore, mbë trī vet mbero, kuj ja thonë Jātë, Birë e Shpirt i Shëjt.

Pj. Çë vjenë me thẽnë të mishëruomit e të vëdekurit të së tënit Shelbués?

Më. Vjenë me thẽnë se i Biri i tīnë Zoti, dua të thomë i diti vet të së shëjtes Trīnitat, u bẽ burr e vëdiq mbal një kriqe për të na sallvoj.

Pj. Poka nishani i të kriqes buftōnë të krështeun?

Më. Ëh, zot.

Pj. Dī ti si bënet nishani i të kriqes?

Më. Ëh, zot.

Pj. Bëje poka.

Më. Vẽ dorën e djathte ndë ballin e thomë *Nd' ëmërim e të Jatit*, e përbinginjë[86] ndën krahnuanë e thomë *Të së Birit*, e shkonjë ndë mushkun e të mënçërë e thomë *Të Shpirtit*, e qellinjë ndë mushkun e djatht' e thomë *Shëjt*. Mbashkinjë duort e mbllinjë kriqen tue thënurë *Amin*. [187]

Pj. Fjalëtë poka të nishanit të së Kriqes janë?

Më. Këto: Nd' ëmërin të së Jatit, të së Birit e të Shpirtit Shëjt. Amin.

Pj. Pse thē *Nd' ëmërin* e jo *Nd' ëmërat*, tas çë dī se janë trī vet?

Më. Pse janë trī vet, ëh, moj bënjin një Theos e je para fjal njëínë buftōnë të të Theosit e të jetërat Trinitatën e vetëvet.

---

[86] përbinginjë] përbimginjë.

Pj. Një vetëm poka është īnë Zot Theosi?

Më. Ëh, zot.

Pj. E vetëtë theosore sa janë?

Më. Janë trī: i Jati, i Biri e Shpirti i Shëjt.

Pj. I Jati është Theos?

Më. Ëh, zot:

Pj. I Biri është Theos?

Më. Ëh, zot.

Pj. Shpirti Shëjt është Theos?

Më. Ëh, zot.

Pj. Janë poka trī Theosëra?

Më. Jo, zot. Janë trī vet theosore, moj një prana është ini Zot.

Pj. E pse janë trī mbë një i vetëm Theos?

Më. Pse të trī kanë një qënurë, një naturë, një fuqī, një mīrie të përzierë e pa të mund jetë e ndajturë. [188]

Pj. Pse janë trī Vet?

Më. Pse i Jati s' kā zëme e nëng del ka ndonj' etërë vet, i Biri del ka i Jati çë e gjenerosën ndë stoneonë e Shpirti Shëjt del ka njeri e ka jetëri, dua të thomë ka i Jati e ka i Biri.

Pj. Cili ka këta trī vet theosorë u mishërua?

Më. I Biri, ç' është i diti vet.

Pj. Si u bẽ burr?

Më. Tue marrurë mish o, mẽ mīrë të thomë, një kurm e një shpirt ndë prëhërin të pafëtes të Sh. Maries Virgjërë prë bëme e prë virtut të Shpirtit Shëjt.

Pj. Pse i Biri i Theosit u burrësua?

Më. Po të sallvonej shpirtërat e gjith burravet të dheut.

Pj. Si ja thonë të Birit të tīnë Zoti i burrësuorë?

Më. Ja thonë Jesu Krisht, cili është Zoti e Shelbuési īnë, vërtetëm Theos e vërtetëm njerī.

Pj. Çë bëri Jesu Krishti të sallvoj zëet e njerzëvet?

Më. Rroi e dhuroi e me të tijat psime e dhurime na bëri e na la sakramendet. Tue dhuruorë, vëdiq i gozhdjasurë ndë kriqen e pagūojti prë nē justixjen e të [189] Jatit e dhuroi prë tonat mbëkata e na hapi e na zgjeroi udhën e të parrajsit me sakramendet.

Pj. Sa janë sakramendet?

Më. Janë shtat: **1.** Pagëzimi. **2.** Krizëma. **3.** Metania. **4.** Evkaristia. **5.** Valëtë Shëjt. **6.** Urdhëri o Priftëria. **7.** Kushqia.

Pj. Çë na vëlenjin këta sakramende?

Më. Na shërbenjin të ghadhënjenjëmi, të rritëmi e të zgjeronjëmi hirën e tënë Zoti.

Pj. Ç' ësht hiri o haristja e tīnë Zoti?

Më. Ësht ajo çë lanë fëtesat tona e ka bil të mbëkats e rrobī të djallit na bënë bil të Theosit e rredhëra të parrajsit.

Pj. Ç' ësht Pagëzimi[87]?

Më. Ësht sakramendi çë bënë burrin birë të tīnë Zoti e rredh të parrajsit, pse na nxierë mbëkatën e të zëmes, dua të thomë mbëkatën ç' erdhi njerzëvet ka Adhami, po si edhe gjith të tjerat çë mund kemi bẽrë mẽ parë të pagëzohemi e na mbjonë shpirtin me dhëna e rrighale qiellsore e me hirë.

Pj. Ç' ësht Krizëma?

Më. Ësht një Sakramend çë fuqisën njeriun po të mos ketë trëmbime, të skamallisinjë besën të Jesu Krishtit e bën e [190] jemi jushtërōrë të Shelbuésit tënë.

Pj. Ç' ësht Evkaristia?

Më. Ësht Kurmi e Gjaku i Jesu Krishtit, me cilin tagjiset karitata, cila ësht gjella e[88] të shpirtit. Andaj jipet ndën speçjet të buks e të verësë, moj vërteta ajo nëng ësht buk vetëm, pse ndë konxakracjōn ndë Kurmin e ndë Gjakun të Jesu Krishtit ndërrohet.

Pj. Ç' ësht Skamallia o Metania?

Më. Ësht sakramendi i të Skamallies. Kī Sakramend na ndëlenë fëtesat çë bëtim pas Pagëzimit e na prīerë ndë mikërien e tīnë Zoti, të kuj prë mbëkatat jeshim të bërë armiq.

Pj. Ç' ësht Valëtë Shëjt?

---

[87] Pagëzimi] Ragëzimi.
[88] e] o.

Më. Ësht sakramendi çë qërōnë qëndruomet e të fëtesavet, jep oreks e fuqī shpirtit po të luftonjë e të mundinjë tendacjonat e të dhimonit ndë herën e të vëdeqes e me shëndetën e të shpirtit sīellë edhe shëndetën e të kurmit.

Pj. Ç' ësht Urdhëri o Priftërīa?

Më. Ësht ai Sakramend çë na jep ministret e të Qishës e të lartarit, cilëtë japën neve e marrën prë vetëhënë të tjerëtë sakramende me virtutën e me hirën e tīnë Zoti. [191]

Pj. Ç' ësht Kushqia?

Më. Ësht ai Sakramend çë shokërōnë e mbashkën burrin e gruanë me hirën e Theosit, i jep fuqī të gjëllinjin me ambënī, të bënjin e të rritënjin bīlëtë me shëjten trëmbime të tīnë Zoti e bën e kanë oreks te kjo e tek jetëra gjellë.

Pj. Kush ka bes ndë kto sakramënde e i bënë edhe sallvohet o jo?

Më. Ëh, zot, se sallvohet.

Pj. E nëng i lipset fare mẽ gjẽ?

Më. I lipset besa e gjith bëmavet çë bëri e na kallëzoi Theosi o bëri e na porsiti Jesu Krishti.

Pj. E kush na i thot këto vërteta?

Më. Simbolli i Apostulvet.

Pj. Dī ti Simbollin?

Më. Ëh, zot.

Pj. Thuoje.

Më. Njota. **1.** Kamë bes mbë tënë Zot Theosin, Jātë i trīfuqisëm çë kriosi qiellin e dheun. **2.** E mbë Jesu Krishtin, Bīrë së tij, i vet Zot īnë, **3.** Cili qe konxhipisurë prë bëme e virtut e të Shpirtit Shëjt e u lē ka Maria pather Virgjërë. **4.** Psoi e dhuroi ndën Ponx Pillathin, qe i ngriqurë, vëdiq e qe varripsurë. **5.** U poshtua ndë pis, të tretën dit u ngjallë ka [192] të dekurit. **6.** U hip ndë qiell e ulet tek e djathta e të Jatit i fōrëmadh. **7.** Atena kā të vinjë të judhikonjë të gjallëtë e të vëdekurit. **8.** Kamë bes mbë Shpirtin Shëjt, **9.** Qishën katóllike, Bashkërīnë e Shëjtëvet, **10.** Ndëlemën e mbkatëvet, **11.** Të ngjallturit e të mishit, **12.** Gjellën e stoneonëme. Amin.

Pj. Kush e njëmendëti *Kamë Besin*?

Më. Dimbëdhjet apostolit. Andaj janë dimbëdhjet artikul.

Pj. Çë thonë mbë serpos këta artikul?

Më. Thonë gjith atë çë kem të kemi bes të tīnë Zoti Theosit e të shëjtes Qish.

Pj. Theosi poka qe ai çë kriosi qiellin e dhenë?

Më. Ëh, zot.

Pj. E kush ësht Theosi?

Më. Ësht një shpirt i trīthjellëm, i trīmadh, çë munden gjith, dī gjithsej, kreosi gjithien e, pa të lekundet ai, e tundën, e dreqtōnë e ndë gjellën e të së qënures të saj e mbanë.

Pj. Ku rrī Theosi?

Më. Ndë qiell, ndë dhē e ndë gjith vendet.

Pj. E Zoti Krisht ku rrī?

Më. Ndë qiellë e ndë trīshëjtin Sakramend t' Evkaristies. [193]

Pj. Tij, kush të kreosi?

Më. Inë Zot.

Pj. Prë cilin ligj të kreosi?

Më. Po të e dua je të e shërbenjë ndë ktë gjellë e prana të e shoh e të e trashigonjë tek jetëra.

Pj. Ësht poka nj' etërë gjellë pas ksaj, e vjuorë prë nē?

Më. Ëh, zot.

Pj. Kurë vemi tek ajo gjellë?

Më. Kurë vëdesëmi.

Pj. Ç' ësht vëdeqja?

Më. Ësht e zgjidhura të shpirtit ka kurmi.

Pj. Ku vete kurmi i njeriut pas çë vëdes ai?

Më. Ndë varrin, e pjuhuroset.

Piejt. E shpirti?

Përgj. Përpara tīnë Zoti.

Pj. Ç' i bënë īnë Zot shpirtit?

Më. E judhikōnë e, ndose bëri mīrë, i jep parrajsin; ndose lig, e dërgōnë ndë pis.

Pj. Ç' ësht parrajsi?

Më. Ësht një vend hareje, ku me pamen lumsore të tīnë Zoti trashigohen gjith të mirat pa mos të kenë serpos.

Pj. Ç' ësht pisa?

Më. Ësht një vend ku të dëmtuorit [194] lëngonjin tue dhuruorë gjith vllepet, sëmundat e të ligat çë mund pandehjen, pa të mund shohën kurraj faqen e tënë Zoti o të metanosen e të priren tek ai, tue dalurë atena.

Pj. Ësht ndonj' etërë judhikuome pas asaj, çë bënë Theosi ka njëj shpirti?

Më. Ëh, zot, e ësht ajo judhikuome çë vjenë të bënjë Jesu Krishti ndë prasëmat hera të motit tek llaka e Josafatit, ndaj horën e Jērsallimit, ku mbllidhen me shpirtin e me kurmin të gjallëtë e të vëdekurit të jenë të judhikuorë e të kenë pisën o parrajsin, si vjenë të i ngas prë të dreqtat o prë të të shtrëmburat çë bëtin.

Pj. Pas ditën e të judhikuomes poka njerëzit venë ndë parrajs o ndë pis me shpirt e kurm?

Më. Ëh, zot.

Pj. E kurmi ahiera qëndronë dreq si e kemi nani na, me skise të rënda e të trasha?

Më. Jo, zot, pse hollohet e ndërronet prë fuqien e Jesu Krishtit.

Pj. Nëng sosën poka vetëm besa të mund verë ndë parrajsit njeriu?

Më. Jo, zot. [195]

Pjj. Ç' duhet mẽ?

Më. Duhen bëmat e mira e të dreqta.

Pj. Kush thot njeriut ndose bëmat e tija janë të mira e të dreqta?

Më. Ia thot lexha e tīnë Zoti.

Pj. Na dha poka një lexh īnë Zot?

Më. Ëh, zot.

Pj. Prë names të kuj?

Më. Prë names të Mojsesit e të Jesu Krishtit, cili, si Theos, e njohu e je kufirmarti.

Pj. Çë thot kjo lexh?

Më. Na jep dhjet Kumanduome.

Pj. Cilëtë janë këto Kumanduome?

Në. Njota. **1.** U jamë Zoti Theos ït. Mos të kēç përpara meje të jetërë Theos. **2.** Mos thuoj ëmërin e Theosit prë faregjẽ. **3.** Kulëto të shëjtëroç krëmëtet e të dialat. **4.** Nderoj tët ātë e tët ẽm. **5.** Mos vrit njerī. **6.** Mos bëj bëma të turpura mishi. **7.** Mos vidh gjẽ njeriu. **8.** Mos bëj martirī mbë të rreme. **9.** Mos dishëro gruanë e tjerëvet. 1**0.** Mos dishëro petëkun e tjerëvet.

Pj. Çë mbjedhën këto dhjet Kumanduome?

Në. Gjith atẽ çë kēm të bënjëmi e të mos bënjëmi, të duami mīrë Theosin e afërin tënë, njeriun. Andaj zëmëra e ksosh kumanduomve ësht karitata, cila [196] na urdhërōnë namurin e tīnë Zoti mbal gjith kafshat e namurin çë kēm të kemi prë afërin tënë do çë të jetë si namuri çë kemi prë vetëjuen.

Pj. Na lipset mẽ gjẽ të mund jemi mẽ të mīrë e të dreqtë?

Në. Ëh, zot. Na lipsen virtutat.

Pj. Sa janë theollogjishtat[89]?

Në. Janë këto: besa, ellpiza e karitata.

Pj. Si kallëzohet besa?

Në. Kështu. Zoti īmë, u kamë bes pa mosnjë rīshtrënguome, ndërruome, o lekundī gjith atë çë besën shëjtja Qish katóllike, vet pse ja kallëzōve e ja e porsite ti çë jē vërteta mbë vetëhënë, vërtet cila së mund na gënjenjë o të jetë e gënjierë. U prana jo vet se besinjë këto vërteta çë më tha pa ëhojo, moj dua të jap gjellën e të shprishinjë gjakun prë të shëjten bes.

Pj. Ellpiza si kallëzohet?

Në. Ashtu. Theos imë, u ellpizonjë ndë lipisien tënde e ndë Gjakun të Jesu Krishtit, cili vëdiq e je shprishi prë shëndetën e të shpirtit tīmë. Andaj ellpizonjë se ti prë nderë t' atij më jep ndëlesën e mbëkatëvet e doksen e të parrajsit çë më takse. [197]

Pj. Si kallëzohet karitata?

Në. Me thëna e me pune. Me thëna ësht kjo. Theos īmë, pse ti jē prë me u dashurë mbal gjith të mirat, u të adhoronjë e të dua mīrë me gjith fuqīen të shpirtit e të kurmit tīmë e prë nderë tënde dua mīrë edhe afërin tīmë si vetëhënë time.

Pj. Si kallëzohet karitata me bëna?

Në. Kallëzohet me bëmat çë janë të lipisjare.

Pj. Sa janë bëmat o punet lipisjare?

[89] theollogjishtat] theollogjijtat.

Në. Janë katërëmbëdhjet: shtat shpirtulore e shtat kurmërishte.

Pj. Cilat janë kurmërishtet?

Në. Janë shtat. **1.** Jip të hanë atirëve çë kanë ū. **2.** Jip të pīnë atirëve çë kanë et. **3.** Vesh të xheshurit. **4.** Jip shtëpī të ghonovarëvet. **5.** Ec gjëj të sëmurmit. **6.** Ec shih të filaqisurit. **7.** Gropso të vëdekurit.

Pj. Thuoj shpirtuloret?

Në. Këto janë nj' etërë shtat. **1.** Këshillo ata çë udhobnjin. **2.** Porsij ata çë nëng dīnë. **3.** Qarto ata çë mbëkatërohen. **4.** Levro të helëmuorit. **5.** Ndëlej ata çë të fëtesëtin o të shajtin. **6.** Dhuro me paçenxje ata çë të tandonjin e të llastimisënjin. **7.** Lus tënë Zot prë të gjallëtë e p[r]ë të vëdekurit. [198]

Pj. Sa janë virtutat kardinallishta?

Në. Janë katërë. **1.** Prudhenxja. **2.** Justixja. **3.** Temberënxja **4.** e Fuqia.

Pj. Sa janë rrighalet o dhënat e të Shpirtit Shëjt?

Në. Janë shtat. **1.** Urtëria. **2.** Ndilëgimi. **3.** Kushilli. **4.** Fuqia. **5.** Të xënurit. **6.** Lipisia. **7.** Trëmbima e tīnë Zoti.

Pj. Qisha Kathóllike ësht e këshilluorë ka Shpirti i Shëjt e ka īnë Zot e ndihurë?

Në. Ëh, zot.

Pj. Kush ësht Kreu i të Qishsë?

Në. Ësht shëjti Pap.

Pj. Mund na kumandonjë gjẽ Qisha?

Në. Ëh, zot, e na dha njer' nani pes kumanduome, e janë: **1.** Të gjegjëmi Meshën ndë të diallat e ndë të tjerat krëmëte. **2.** Të agjëronjëmi ndë kreshëmit e ndë parakrëmtet të shëjtëvet e ndë katërë Motet; s' kemi të hami mish të prëmëten e të shtūnë, ndose jemi të lëtinjë; të mërkurën e të prëmëten, ndose jemi ghreq. **3.** Kemi të skamallisemi allmonu një herë ndë vit e të kungohemi ndë Pashqit e të ngjallurit të Jesu Krishtit. **4.** S' kemi të vëmi kurōrë ndë mote të proibirëme, dua të thomë ka e para e diallë të së ardhurit të tīnë Zoti njera ndë Pefanie, ka e para dit të kreshmëvet njera ndë [199] të parën e diallë pas Pashqëvet. **5.** Kemi të paguonjëmi dhjetëmat si ësht zakoni.

Pj. Ç' ësht Mesha?

Në. Ësht një urat, tek cila na mbërparën sa bëri, sa psoi, sa tha, sa dhurōi Jesu Krishti çë kurë leu njera ndë vëdeqen e tij. Ësht një Sakrifix keq i fōrmadh e i mistikosëm çë bënet mbë nderë të Theosit me Kurmin e me Gjakun të Jesu Krish[t]it.

Pj. Prë cilat kafç mund ofëriret kī sakrifix?

Në. Prë shum e mẽ tepërë prë trī: prë të nderuorë e prë të hiripsurë Theosin, prë të mund kemi ndëlemën e të mbëkatëvet e prë të na jap īnë Zot ato hariste çë na lipsen prë shpirtin e prë kurmin.

Pj. Mund mbahet njeriu pather pa mbëkat?

Në. Jo, zot, pse duhet një hariste keq e madhe çë të e ruonjë, si ruojti[90] Sh. Marien e pak të tjerë shëjtëra.

Pj. Njeriu poka bie ndë mbëkat o do o nëng do?

Në. Jo, zot, pse Theosi e bëri të dreqtë, të mīre e pafëtes e të leftērë e, ndose ai bie, bie me duanien e tij e lefterisht, po si rā Adhami, jati i gjith njerzëvet. [200]

Pj. Poka, kurë njeriu bie ndë mbëkat, zbierë dreqtien e armikoset me tënë Zot?

Në. Ëh, zot.

Pj. E si rrëvōnë të mikërohet mẽ me të?

Në. Me sakramendin e Metanies.

Pj. Si bëhet kī sakramend?

Në. Tue skamallisurë fëtesat çë bëtim përpara një prifti, cilëvet[91] i dha fuqien Theosi të mund na i ndëlenjin mbëkatat prë pjes së tij.

Pj. E të bënjëmi një Skamallī të mīrë sa kafça duhen?

Në. Pes kafça e janë: **1.** Kem të kulëtonjëmi mīrë mīrë mbëkatat. **2.** Kemi të metanosemi me dhëmbime të madhe fëtesashit. **3.** Kemi të taksëmi me zëmërë e me bes të mos i bënjëmi mẽ. **4.** Kemi të ja kallëzonjëmi skamallerit dreq si i bëtim, sa herë i kemi bërë, përpara kuj, ndë cilat vende e ndose prë zakōnë i bëtim. **5.** Kemi të bënjëmi penitenxjen çë na jep skamalleri.

Pj. Si mund kulëtohen mirë e dreqtë fëtesat?

Në. Tue lusurë hirën e Theosit, dritën e të Shpirtit Shëjt, ndihëmen e ëngjëll kustodhit e të avoketëvet e tue thërriturë [201] më trū mbëkatat gjith, tue zënërë ka e prasëma skamallie, ndose ajo kā qẽnë e mīrë.

Pj. Si vjenë të mos jetë e mīrë Skamallia?

Në. Ndose ai çë skamalliset nëng kā metanie fëtesashit, nëng taksën të mos mbëkatërohet më o fshehën ndonjë mbëkat me ligërī e me të rreme o bënë ndonjë fëtes të rënde tue u skamallisurë.

Pj. Poka gjith herat çë skamalliset një e lẽ të thetë ndonjë mbëkat skamallia nëng vëlënë?

---

[90] ruojti] riuojti.

[91] Ardito passaggio dal singolare al plurale.

Më. Jo, zot. Ndose lẽ mbero ndonjë mbëkat të lez, skamallia ësht e mīrë, pse mbëkatat të leza rrī mbë lefterien tënë ndose duomi t' i skamallisëmi. Ndo prana lẽ ndonjë mbëkat të rënde prë harruome, e skamallia ësht e mīrë edhe e kemi të skamallisëmi vetëm mbëkatën çë harruom tek jetëra skamallie. O mbëkata e lënurë nëng qe prë harruome, moj prë mallixje, prë turp o prë ndonj' etërë tendacjon, e ahiena skamallia nëng vëlënë e kemi të e përtërīrëmi ndë gjith e prë gjith, tue thënë edhe skamallien mbëkatëruome çë bëtim.

Pj. Çë duhet mẽ të jetë e mīrë kulë[t]uomja e të mbëkatëvet? [202]

Më. Lipset të kulëtonjëmi sa herë i bëtim mbëkatat të rënda, cilësë do speçje të jenë, ashtu sa nëng sosën të thetë një: Bëra bē mbë të rreme, moj kā të thetë: një, di, trī o sa herë qe.

Pj. Sa të keqe bënë mbëkata e rënd?

Më. Bënë di të liga: prëshānë tënë Zot e dëmësōnë shpirtin tënë.

Pj. Pse prëshānë tënë Zot?

Më. Pse ndërrōnë namurin e Theosit me namurin e të dheut, nëng gjegjën lexhën e duanien e tij e kundërë porsimet e të ligjës ndërrōnë ārin me balëtën.

Pj. Si vete çë dëmsōnë keq shpirtin tënë?

Më. Pse bën e zbierëmi hirën e Theosit, parrajsin, e bën e meritonjëmi pisën.

Pj. Sa shortashi janë mbëkatat?

Më. Di shortashi. Njera ësht mbëkata çë bëri Adhami, cila ngjatet e përhapet ndë njerëzien, e ja thonë mbëkata e të zëmes, e kjo nxiret me pagëzimin, po si thamë. Të tjerat janë ato çë bënë gjith ditën njeriu, e këto janë edhe di shortashi, të rënda e të lea.

Pj. Cila ësht poka mbëkata e të zëmes?

Më. Ësht ajo me të cilën lehemi gjith na.

Pj. Cila ësht mbëkata e rënde? [203]

Më. Ësht ajo çë bënet kundërë namurit të tīnë Zoti e t' afërit tënë e ësht e rënd e thuhet vëdekore, pse bën e vëdes shpirti, tue i nxjerrurë hirën e tīnë Zoti.

Pj. Cila ësht mbëkata e lez?

Më. Ësht ajo çë nëng bën e bierë shpirti hirën theosore e monu e xarrisën ndë pis, moj ftohën[92] mbero vapën e të karitats, pse nëng vete dreq duanies të tīnë Zoti, e kjo o kē t' jetë e qajturë këtu mbi dhē me metanie o ke t' jetë e qëruorë me zjarrin e të përghatuorit.

[92] ftohën] ftonjën.

Pj. Sa janë krerat e mbëkatavet?

Më. Janë shtat. **1**. Subervja. **2.** Avarixja. **3.** Lusurja. **3.** Dirja. **5.** Golja. **6.** Vidhja. **7.** Purtonmja.

Pj. Pse thuhen krera të mbëkatëvet këto?

Më. Pse ksove dalën shum të tjera, po si bilat ka të jëmat. Ashtu kush ësht suberv mbanë se mosnjerī mund e gjas o të e qasinjë, prëshānë të afërit e tij, prëtëndōnë të ketë gjith doksën e nderën e të dheut prë vetëhēnë, do t' xẽrë shërbiset e të tjerëvet, mbahet keq prëlārt pa mosnjë ligj e vete tue kërkūorë pather gjëna të rea. Kush ësht i mūndurë avarixjes s' mund shoh të vobqit, xheshën të nëmurit e të dëtirëmit; s' kā lipisī, [204] s' kā dreqtī o karitat; ngurën zëmërën e nëng bënë mīrë njeriu. Kush ësht i lusūrëm kërkōnë pather bëna të shtrëmbura e me gruanë e tij e me gruan' e tjerëvet, nëng njeh të dreqtën, i errësohen trūtë e cado herë lërënë edhe besën e tīnë Zoti po të verë pas gravet e pëlqemëvet të qelëbura të mishit. Kush ësht grikmādh bënë mbëkata gjith shortashi o këllet mbrënda o nxierë jasht. Kush ësht i dīrëm mallkōnë, vret, zëhet, shānë, turprōnë e bënë një mil të liga, si dejti kurë monostrofet. Kush kā vidhje së mund shoh të mīrën e tjerëvet, harepset prë të keqen e të afërit e nodhjonë kuazi gjith njerzit. Kush ësht i përtuom ndë shërbemen e tënë Zoti ftohet pather mẽ prej shpirtit, nëng uratën, nëng lusën [n]e kā tramaksie prë vëdeqen e prë pisën e të tjera mbëkata bënë.

Pj. Gjënden mẽ të tjera fëtesa mbi këto?

Më. Ëh, zot, e janë mbëkatat kundërë Shpirtit Shëjt, ato çë thërresën mënit përpara tīnë Zoti e mbëkatat çë bëhen me trū.

Pj. Cilat janë mbëkatat kundërë Shpirtit Shëjt? [205]

Më. Janë gjasht. **1**. Kurë një sellpizōnë të mund sallvohet **2.** O ellpizōnë të sallvohet pa bẽrë bëme të mira e pa të e meritonjë. **3.** Kurë rremsōnë vërtetën e njohurë. **4.** Kurë kā vidhje ka hiri i të tjerëvet. **5.** Kurë nguret ndë mbëkata **6.** E kurraj metanoset mbëkatashit.

Pj. Sa janë fëtesat çë thërresën mënit përpara tīnë Zoti?

Më. Janë katërë. **1**. Vramja e ndonjeriu me të gjith duanien. **2.** Mbëkatja e mishit kundërë naturësë: **3.** Shtrëngōmja e të vobkëvet. **4.** Mospaguomja e t' atirëvet çë na shërbienë.

Pj. Cilëtë janë mbëkatat trūshi?

Më. Janë ato çë bëhen me penxerin e këto janë di shortashi. E para ësht kurë një penxōnë e kā duanie të bënjë ndonjë gjẽ të mbëkatërisht, e dita ësht kurë një duanirisht mënōnë tue penxuorë një gjẽ të mbëkatëruom pa duanie të e bënjë vërteta.

Pj. Njeriu, mbë serpos, si mund fëtesinjë?

Më. Me bëma, me thẽna e me penxjere.

Pj. Më parë se të rrëfienjë mbëkatat priftit, çë kā të bënjë i ftesuri? [206]

Më. Kā të thetë Skamallinë me fjāl, si ësht e njohurë ka shëjtja Qish.

Pj. Thuoj Skamallinë.

Më. Njota. Skamallisinjë tënë Zoti, Theos çë mundën gjithsej, së lumes Marie pather Virgjërë, së lumit Mikēll Arkëngjëll, së lumit Janjë Pagzoserë, shëjtëvet apostul Pjetërit e Palit, gjith shënjëtëvet e tij, o jātë, pse fëtesa shūm me penxërë, me thẽna e me bẽna. Fëtesa e nani metanosemi thellë e fōrt. Andaj parkalesinjë të lumen Marie pather Virgjërë, të lumin Mikēll Arkëngjëll, të lumin Janjë Pagzoserë, shënjëtit apostul Pjetërin e Palin, gjith shënjëtit e tij, jātë, se të lusëni prë mua Theosin Zotin tënë. Amin.

Pj. Kush e bëri Skamallīen?

Më. Njeriu i fëtesurë kurë vate të skamallisej e të thoj mbëkatat e tij skamallerit.

Pj. Kush bëri mbëkata kā të bënjë penitenxje?

Më. Ëh, zot.

Pj. E si bëhet penitenxja?

Më. Tue u metanosurë mbëkatashit.

Pj. Si buftohet prë jashta metania e të mbëkatavet? [207]

Më. Tue pasurë dhëmbime.

Pj. Sa shortashi ësht dhëmbima?

Më. Fjalëshi e zëmërje.

P{iejtura} Thuoj dhëmbimen me fjal.

Më. Njota. Zoti īmë, Theos īmë, u metanosemi me gjith zëmërën pse fëtesa e dhëmbemi e më shpëlqënë mbë gjith të tjerat liga pse fëtesa e prëshajta e shpëlqeva tij çë jē mīria prë vetëhenë, jē i trīlart, e i trīlipisjarë. O, të keshënja vëdekurë e mos të t' keshënja fëtesurë, Zot i lipisjarë e keq prë me u dashurë! U të jap bes nani se çë sod e pārë dua të ndërronjë gjellë e dua të vëdes mẽ shpejt një mil herë e jo të t' fëtesinjë mẽ kurraj.

Pj. Sosën kjo dhëmbime po të mund sallvohemi?

Më. Ëh, zot. Ndose ësht e thënurë me zëmërën, edhe jasht skamallies, kurë mbero së mund kemi mosnjë modhi skamallerin.

Pj. E kurë një metanoset ka mbëkatat vetëm pse fëtesi tënë Zot e andaj zbuori parrajsin, sallvohet?

Më. Ëh, zot, moj kā të skamalliset e ka të jetë i zgjidhurë mbëkatashit ka prifti. Ndo ç' prana ka dhëmbime të madhe vetëm [208] pse fëtesi tënë Zot, sallvohet edhe pa skamallie.

Pj. Çë kēm të bënjëmi të mund gjegjëmi dhëmbime fëtesashit?

Më. Kemi të truhemi Theosit po të na e jap, Shën Maries e shëjtevet, cilëtë e gjegjëtin e je patin të madhe e të thelle, po si qe Shën Pjetëri, Shën Mëria Mathalenë, S[hën] Margharita, S[hën] Frangjisku i Shizit e aq të tjerë, e kēm të penxonjëmi të ligat e dëmet çë bẽmë tue fëtesurë.

Pj. Kemi të bënjëmi nje penitenxjen çë na jep skamalleri?

Më. Ëh, zot, kurë skamalleri na shëngoi motin. Ndo pra nëng tha gjẽ, ahiena mund e bënjëmi me lefterien tënë. Mẽ njëhere mbero e bënjëmi, mẽ mīrë ësht.

Pj. Një çë mīrë u skamallis e u dhëmb fëtesashit çë mund bënjë mẽ?

Më. Mund kungohet.

Pj. E po të bëhet dreq Kungimi, sa kafsha duhen?

Më. Duhen trī kafsha: pastruome shpirti, pastruome kurmi e trīmadhe dhivocjon.

Pj. Çë vjenë me thënë pastruomja e të shpirtit?

Më. Pse ai çë vete kungohet kā të ketë [209] shpirtin të thjellëm, dulirë e pa fëtes të rënda.

Pj. Çë do me thẽnë pastruomja e të kurmit?

Më. Pse çë ndë mjeznat njera mbë herën çë vete kungohet kā të ketë kurmin pa ngrẽnë e pa pīrë.

Pj. E pse duhet një trīmadhe dhivocjon?

Më. Pse kush do t' kungohet kā të ketë dhivocjon ajashtaz e ambrëndaz.

Pj. Çë vjenë me thẽnë dhivocjon' ajashtaz?

Më. Pse kush vete kungohet kā të verë me të veshura e me stolī të mira mẽ se mund i ketë, me llōrë të mbjedhura ndë krahnorin e me sītë t' ulëta.

Pj. Ku mbllidhet dhivocjona ambrëndaz?

Më. Ndë parkalese, ndë lusa e ndë urata çë kanë të bëhen Theosit, Jesu Krishtit, shën Maries, ëngjëlvet, shëjtevet e avoketëvet, tue i lipurë mbi gjith kafshat shëndetën stoneonëme të shpirtit, ndëlemen e mbëkatëvet, mburuomen e të hirëvet, lefteruomen e pisjes, harīnë e të parrajsit e shëndetën e të kurmit mbë serpos.

Pj. Cila ësht urāta çë mẽ tepërë kēm të thomi?

Pë. Ësht ajo çë na porsijti Zoti Krisht [210] me golën e tij, kurë ja kallëzoi apostulëvet, e ësht kjo: **1**. Jati ĩnë çë jē ndë qiell, qoft' i shëjtëruorë ëmëri it. **2.** Ardhëtë rregjëria jote. **3.** Qoft' e bẽrë duania jote, si mbi qiellë ashtu mbi dhē. **4.** Ëmëna sod bukën çë na nevojën gjith ditën. **5.** Ndëlej neve dëtirëtë tona, porsi na ndëlenjëmi dëtīrëmit tënë. **6.** Mos na lëre ndë tendacjona. **7.** Ligashit lefterojna. Amin.

Pj. Çë mbjedh e çë thot kjo urat?

Pë. Mblledh shtat të lipura çë kēm të bënjëmi ka dita tīnë Zoti.

Pj. Ësht ndonj' etërë urat e trīmirë?

Pë. Ësht tëfalmja e shën Maries e ësht kjo: Agëzuosh, o Marie çë jē pjote me hīrë; inë Zot ësht me tij. Ti jē e bekuora ndër gjith grā e i bekuorë ësht karpoi i barkut tënd, Jesusi. - Shëjtja Marie, Jëma e Theosit, parkales prë nē të mbëkatëruomit, nani e ndë herën e të vëdeqes tënë. Amin.

Pj. Të kuj janë fjalëtë e ksaj urat?

Pj. Dica i tha Arkëngjëlli Ghabriellë kurë tëfali Marien prë pjes të Shpirtit Shëjt. Dica janë të shëjtes Lizabet kurë vate të e gjënej Maria e je tëfali ajo, e të [211] prasëmat qenë thẽna ka Qisha e shëjtevet.

Pj. Truhe ti Theosit, Sh. Maries, ëngjëlvet e shëjteve?

Pë. Ëh, zot. Menatet, mjezdit e mbrëmënet shëngohemi me nishanin e të kriqes e thomë: Dokse paft' i Jati, i Bīrī e Shpirti i shëjt, si qe ndë të zëmen, nani, pather e ndë gjith jetën e jets. Amin. Pra thom *Jati ĩnë* eç. e *Agëzuosh o Marie* prë trī herë e mbaronjë tue thẽnë: "Qoft pather i bekuorë ëmëri i Jesusit e i Maries. Qoft pather laudhuorë trīshëjti Sakramend. Sod e prë pather e doksuome qoft trīshëjtja Trīnitat. Jesus, Zep, Marie, juve jap zëmërën e shpirtin tīmë. Ju më qofçi nd' anë kurë jam' e tëhelëqinjë e me jū i ambënisëm dalëtë shpirti ka kurmi īmë. Ëngjëll kustodh, ruojëm; shëjtëra avuket, ndihmëni. Amin".

KËSHĪLLË

Bīr' īmë, mba të mbjedhura e të mbllira skiset e të kurmit, çë janë sīte, veshëtë, hunda, gola e duortë; mba të qëruorë kurmin e shpirtin mbëkatashit; beko ka kred, ka koh e ka dit Theosin, bëj lexhën e tij e ti qëndrōnë i bekuorë ka Theosi, ka qielli e ka dheu. Ashtu qoft. [212]

SHKALLA E IV

TË PUNES TË
PESHPËKUT ZOTIT PJETËRË BOGDHANO
TIPOGHRAFISURË VENETĪ
KA GJIROLLAMI ALLBRICI
NDË VITIN 1691

Rīshkruojturë mbero me ghramatītë e këtij libri, pse tek ai janë ndrishe e nëng mund dhjavasen aq mīrë. U kalla këtu këtë Ligjërate të atij të bënë të xẽnë ata çë thomse nëng e dīnë se janë të tjerë livëre albëresh e ndonjë fjal çë vjenë të i duket e rē, pse nëng e adheturë ndë katundet çë gjënden ndë Litalljen, mos të mbanjin se u e nxora ka krieja ime, pse e mora tek ai, tas çë njoha se gjuha nëng ndrishën keq e, si fllitet nani këtu, fllitej atje 300 vjet prapa.

LIGJËRATE E PARË

SI U NGJALLË JESU KRISHTI TË TRETËN DIT

Mbeti shënjëti stāt aq i bukurë e i ndritëm, ashtu sa dielli dukej i errëtë e i shëmbtuen ndaj drits e shkëlqemit të yjnuemit[93] stātë të Jesu Krishtit. Prej [213] vorrit ndë çast duolli, pa trazuem rrasën çë e kish mbëshēllë, po si duolli krahenorit të së Virgjëres Jëm, pa dëm të ùngjinit të saj.

Dan. 6. U duk atë herë Dan'jelli dalurë leqenit[94] të luanjëvet pa ndonjë dëm asoj bishash[95] të egërash.

Jon. 2. U duk Jona të tretën dit, çë balleni, peshk dejti, e mbajti trī dit ndë barkut e prana e vuell mbë lëmānë të Ninives[96].

Esth.[97] 2. U duk Mardokeu, i xheshurë thesit[98] së vet e i veshurë petkashi së rregjëraç[99], e anemiku i tij Amani[100], tue mbeturë dobiturë, mbet[101] keq i vjerr mbë furkat të vetjuj e populli i tij mbet shpëtuem ka vëdeqja.

---

[93] yjnuemit. In quest'ultima parte la y del Santori (S) serve anche a rendere la y del Bogdani (B). Ho tenuto presente l'edizione del *Cuneus Prophetarum* curata da Anila Omari, Tirana 2002.
[94] leqenit (B). S: laqenit.
[95] bishash (B). S: bishkash.
[96] S cambia la sintassi rispetto a B. Il porto di Ninive è un'invenzione di B, senza alcuna traccia nella Bibbia.
[97] Esth. - B: Hest – S: Hest. Ho riportato questa e altre abbreviazioni latine dei testi biblici alla norma consolidata. Anila Omari considera *Hest.* un errore di stampa e, insondabilmente, lo corregge in *Hist*.
[98] thesit (B). S: thasit.
[99] B: së regjëneshash.
[100] B: Amoni.
[101] S elimina "dobitun, mbet", rendendo aleatoria la sintassi.

Exod. 2. U duk Mojsesi, ji nxjerr ujravesh të Nillit e ka shporta e thupravet[102], cili prana vrau Faraunin.

Gen. 4. U duk Josefi, dalurë ka burgu, me kript' e rruom ka vëdeknia e i veshurë të pavëdeknies e mbajturë mbë vend të Rregjit ndë gjith dheun e Misirit.

Po e përsīlljin gjith ata shpirtëra të shënjëtë. Ndë kaq i biri tīnë Zoti desh t' vej të shihij t' Ëmën të shënjëte të sij, tue dashurë ligja çë ajo çë pati mẽ të madhen[103] dhëmbime te jeta të ish mẽ e [214] para të e shihij e të përgëzohej. Rrij Virgjëra me mẽ të madhin dishërim, si përsipërë u tha, tue priturë kohën kurë kish prë të parë të Birin të ngjallurë prë vetëhenë. Ndër kaq po ndiejti se hinej ndë kamarët vet një kënëk qiellishte shum ëngjëlish çë po vijin tue kënduorë e tue bëmë përpara Rregjit të madh gazëmend. Hitin gjith bashk ku ish Ëma e tīnë Zoti e, tue rārë mbë gjunjë rreth asaj, kënduonë atë shëjte kënëke çë zẽ: "Rregjëresha e qiellvet, gëzou, Allelluja, pse ai çë qe e ndënji ndë barkun tënd, Allelluja, u ngjallë po si pat thẽnë. Allelluja". Atë herë gjith ata shënjëtë, patriark e profētë hitin e ju prëultin së Ëmës të tīnë Zoti. Ahiena i dashuri Biri i saj, tue ju dukurë përpara gjith i gëzuem, i bukurë e i ndritëm, ju fanārë me madhī e me krah të hapta. Kurë e lumja Virgjërë e pā, edhe ajo me krah të hapta i duell përpara e me dashurī muerë ngrikë[104] të birin vet Jesu Krishtin tue thënë: "O, Bir' īmë i zëmërës, jē ti Jesusi jīmë? Thomse jamë ndë gjum e[105] kështu ësht?". "Ëma ime, jam' u - tha Zot' īnë -. Le të mbarohenë lotët [t]ënde! Mos bëj mẽ, Virgjërë e ngushllueme, [215] po të të shof e shkushëllueme. Të keqat tënde çë qenë pjes[106] të timavet, nani u mbaruen. Këtej tutje gjith kafsha të[107] jetë e gazëmend". Përsëriu këtheu[108] e lumja Virgjërë e muerë ngrikë të Birin e prë të madhen harē mëxij sa monë të fllit, more derdhi shum lot prë të madhen dashurī.

U godijtin të trī Mëriat, çë qenë Mëria Mathalënë, Mëria Klleofe e Mëria Sallome, me të tjera grā të dashura ka Krishti, po të vejin ndë vorr me barërat të tire për të liem Jesu Krishtin, si qe thẽnë përsipërë, e mbë udhën fllisëjin, jo pa kujdhes, kush kish prë të çuem rrasën prej vorrit, tue mos dijturë se Pillathi e kish bẽnë me u miherlisurë. Moj Jesu Krishti kish dal vorrit pa mos çuem rrasën, po si kish bẽrë kurë leu Virgjëres Shënjëte e posi kurë hiri ndë shtëpī ku ishin dishipulit me dierë të mbëshellta.

Si mberrijtin prana Mëriat afërë, zdripi nj' ëngjëll ngiellshit e me një të madhe zanë çoi rrasën vorrit e aso zanje sholdetët çë e ruojin një herje u rrëzuanë mbi dhē si të dekurë. Mëriat, tue mos pasurë droe aso zanje, mberrijtin ka vorri e panë një ëngjëll mbë ftirë të një trimi të rī, [216] gjith i veshurë mbë të bardha, i cili po rrij prë mbi rrasët[109] çë vet çoi e i tha: "U bukurë e dī po se ju lipni

[102] S: dhupravet.
[103] S: madhem.
[104] ngrikë. B: ngrykë – S: ngriqe.
[105] e (B). S: o.
[106] pjes. S: prjes. B: qi janë ende të miatë.
[107] të] ti.
[108] S: këdheu. L'erronea trascrizione è ripetuta più volte.
[109] B: rrasët – S: rrase.

Jesu Krisht Naxarenin të kriqesuem. Ai u ngjallë e nëng ësht këtu. Hini e soditëni vendin ku qe vẽnë".

Hitin Mriat ndë vorrin i cili ish po si një kamarë e vogël ndë marmorë gërriem e mbë një ānë pakëz çuem trollit ish një ark sa një njerī, ndë të cilin kurmi i Krishtit pat qënë vūmë.

Mriat pānë di ëngjëlit tue ndënjurë ndë krie t' arks e kishin petëkat e tëra të bardha e të shkëlqeme, të cilëtë i thanë Mriavet: "Pse lipni ju atë ç' ësht i gjallë ndë të dekurit? Njota vendi ku qe vumë. Nëng ësht këtu. Mbanie mend, se tue qẽnë ai ndër Ghallillētë[110] tha se kish për t' u kriqesuem e se të tretën dit kish për t' u ngjallurë. Ecëni ndë çast e thoni gjith sa shifni dishipulvet së tij e mẽ tepërë Pjetrit".

Ato tue ndiem e tue pamë këto pune duelltin atej pllot me droe e gazmend. Ishin ramë sogjetarëtë[111] prë dheu e ato shënjëte grā, pa mos thẽnë gjẽ, shkuonë ndë hōrë e gjetin apostolit e dica dishipul ndë çenakullit të mblledhëtë, të cilëvet Mriat thanë gjith çë kishin pamë e gjegjurë. Moj Apostulvet ju duk [217] se Mriat fllitjin jasht vetëhej, aq ka gazëmendit çë kishin. Prandaj prë të bëmë mirëfilli[112] puneshit çë po ndiejin, vanë ka vorri. Sogjet ishin këthiem ndë vetëhē e ata, tue pasurë pamë këto mirekul, vanë të bëjin të dijin Muftītë gjithsej ç' ish godijturë.

Mberrijtin Shënjëtit apostol Gjoni[113] e Pjetëri mbë vorrit e Sh. Gjoni ngau rend mẽ parë se Pjetëri, ndonse nëng hiri, moj u ndal mbë derëtë, e ndënji[114] tue sodijturë se çë ish mbrënda, njera çë të e mbërrij Sh. Pjetëri, cili sa mberrijti, të di hitin, moj Sh. Pjetëri mẽ parë e Sh. Gjoni më ngjat. E panë mbë nj' anë llenxolet, mbë cilëtë kish qẽnë i mbështjelltë kurmi; pashtemali i kreut ndë të jetërën anë. Tue pasurë pamë këto pune, këthien[115] ndë hōrë, tue bukurë besuem të ngjallurit e Jesu Krishtit.

Mriat u ndaltin ndaj vorrit, Mathalēna u ndā së tjeraç me të madh dishërīm të shifij mjeshtërin vet. Përsëriu hiri Mathalena ndë vorrit e prësëriu pā ata ëngjël çë po rrijin ndë krie të arks, ku pat qënurë vëmë Shelbuési. Piejtin Mathalenën tue thënë: "Grua, pse qanë?". Tha ajo: "Pse më kanë marr Zotin [218] e Mjeshtërin tīmë e nëng dī se ku m' e kanë vumë". Duell ateja e pā Jesu Krishtin, po nëng e njofti, moj ju duk se ish një kopshtārë. Ai ji tha: "Grua, çë qanë?". Ajo përgjegji: "Zot, ndo e kē marr ti, thuojme ku e kē vumë të vete të e marr". Jesu Krishti i tha: " Mrie!". Ajo prë ndë zanëtë ndë çast e njofti e, tue u kthiem prej atij, desh t' më i puthij këmbtë tue thẽnë: "Mjeshtër' īmë!". Po Krishti i tha: "Mos u[116] avit, përse edhe nëng u jamë hipurë te[117] Ati īmë. Ec pra e thuej dishipulvet tīmë të dashurë se ti më kē pamë e se po hipinjë te Ati īmë mbë qiellt". Vate Mria Mathalena gjith gëzueme e mbërrijti të tjerat Mria, të cilat ishin të nisura prej hōrës. I tha si e kish

---

[110] S: Ghallitētë.
[111] S: soxhetarëtë.
[112] mirëfilli (B). S: mirrej filli. S non capisce l'idiomatismo e cambia a orecchio.
[113] Gjoni (B). S trascrive erroneamente sempre Xhoni.
[114] e ndënji (S). B: andyj = andej. Altro rifacimento a orecchio.
[115] B: kthyenë – S: kërcien.
[116] u (B). S: më.
[117] te. B: ke – S: ku. Così anche poco appresso.

pamë mjeshtërin vet ngjallurë. Ato rrijin keq tue ndigjuem sa po thoi Mathalena, sa ndë të pakultueme u duk atire Jesu Krishti, ashtu çë gjith e panë bukurë e ranë mbë gjunjë përpara atij e je adhoruenë me një të madh mallë, tue përziem lot e gazëmend bashk.

Lotëtë i vejin sumbulla faqes posht së gazmendit e droes çë kishin, mos ishin nd' ëndërra. Zoti ïnë, tue i pamë gjith të droezta, i tha të mos droejin, po të vejin shpejt te apostolit e dishipulit [219] e të i bëjin me dijturë çë të vejin ndë Galillëtë, se atje kishin për të e pamë.

U godit, thot Sh. Lluka, se, aso ditje çë Jesu Krishti u ngjāllë, di dishipul ka të tījtë, të cilëvet njeri kish ëmërin Klleofas, të jetërit ja thoshin Lluka, çë qe Vangjelisti, çë po vejin prë një kashtjeli çë ja thojin Emaus. Ish llarghu Jērsalimit pakzë mëngu se shtat mil. Këta po vejin tue ligjëruem mbë vetëhënë aso kafsheçi çë ishin godijturë ndë Jērsalimtë Mjeshtërit së tire, keq tue u mërekulum se si kish Zot' ïnë përmëtuem t' atillat pune ndë një njerī kaq të mire si qe Jesu Krishti e aso mixire shum të rënda të Muftīvet e tradhezītë[118] të Judhsë e së të padashurit të madh të gjith asaj gjind, tue je pasurë munduem aq fort. Moj mbal gjith kafshit mrekullohshin të së doqes butësī të Jesu Krishtit e të dhëmbimeshit çë mbajti, tue thẽne se ata shpërien se ai kish për të qẽnë vërteti Zoti ïnë, ndëpër mrekullīt së fōrta e pamase çë vepëroi tue urdhinuem dejt[it] e je gjegjij, të sëmurmit shëndohçin e u ngjalltin të dekurit, me të tjerë mrekul së të panjefuna, sa nëng dihej ndose [220] Zoti ïnë mund kish me bëmë mẽ shum e mẽ tepërë, ndose të kish ardh mbë dhē prë vetëhënë.

Kurë nje Shelbuési mbë shembelltirë të një udhtari ji huoj mberijti e, sa ju avit, i pjeti: "Çë dvoni[119] ndë vetëhē tue ecurë ashtu, çë po veni kaq të perkujdhesëm e të dhëmbtëm ? Njeri dishipulvet përgjegji: "A mun t' ishënje ti vet udhëtari i huoj ndër aq çë këso dit Pashqish janë ardhurë ndë Jerusallemtë e nëng kē ndiejturë sa ndë këto dit mbrënda asaj u godit?". Tha Krishti: "Çë pune janë qënë këto?". – "O, Zot' imë, nëng ësht edhe shkuer' e treta dit çë qenë bẽnë mẽ të fortat shminjenī e dhunī, çë kurraj njeriu mundëshin më je bẽnë, Jesu Naxarenit, njeriu fōrt i mīrë e i madh predhkaturë, e trī dit janë çë qe Muftīshit me u bëmë[120] kriqesuem. E na kultuem se sod ç' ësht e treta, kish' për t' u ngjallurë posi vet pat thẽnë. Janë vërteta dica grā të dhivoteshëme, të cilat sod ndë nat qenë ndë vorrin të Jesusit e thonë se panë ëngjëlit, të cilëtë i thanë se u ngjallë Jesusi".

Atëherë i tha Shelbuési: "O, të padijturë e të pllog ndë zëmërat tëja me besuem kafçet çë thanë profetit. Po edhe nëng dini [221] se u desh Krish[t]it me dekurë e ndëpër travaje të hij ndë ngushllim të vet?". Vate prana[121] tue i pomendurë shum profetī. - "Nje këto pune doj me thẽnë Mojsesi kurë urdhnoi çë ndë kto[122] dit Pashqje çë janë këto të sakrifikojin tinë Zoti një qëngj të bardh të palie, gjaku i të cilit, si të derdhej për mbi të besniqit e tij, i shpëtoj ka djalli (*Exod.* 2).

Nje këto pune desh me shembliem vet Mojsesi kurë bëri me çuem gjarpërin rrembje mbi një drū, cilin si të soditkeshin, gjith ata çë ishin të zënurë nga gjarpëri shëndohçin. E ësht shembëlltira e

[118] B: tradhëtijet.
[119] dvoni (B). S: duoni. S si aggrappa alla forma verbale più simile.
[120] S: me u bëmë. B: qe bām me.
[121] Vate prana. Aggiunta di S.
[122] kto. S: ikto.

Jesu Krishtit, gjarpëri tuçi i pa venërë, i cili, vum mbrë kriqtë[123] shëndoshën e shpëton[124] gjith ata çë e sodisënjin e, tue besuem mbë të, tue mbajturë urdhnimtë e tij, janë të lefteruom së zënit të mbëkatëvet. Kjo pune qe shëmbëlliem ndë vëdeqe të Aronit, Prift' i mādh, çë qe mbi një mal. Krishti, Prift' i mādh, vëdiq mbi malin të Kalvarit (*Num.* 20).

Njie këto pune qenë të shëmbëllieme ndë Sanxonin, cili qe vramë prë sherregjītë[125] e Dalidhes, së dashunësë[126] së tij. Ashtu edhe ju godit Krishtit prë sinaghoghën jevrejvet, herejet[127] aq e dashura (*Judic.* 16). [222]

Nje kso puneshi foli Davdhi ndë shum Sallm asoj çë shkruojti e mẽ tepërë ndë Sallmin 27, ndë cilin shkruojti kuvendin e të jevrejvet kundër Krishtit për t' e vrāmë; e ndë sallm të 3 tha si po doj me dekurë e me u ngjallurë, e ndë Sallm 15 tha se shpirti i Krishtit nëng kish prë të ndalej ndë pis e se kurmi i tij nëng kish t' kalbej.

Nje prë kto pune foli Isaia te krieja e 50, se ai kish prë të dhẽnë fëlqinjën[128] atij çë kesh t' ja rrihij e faqen atij çë kesh ja pushtij. Ashtu ndë krje 53 thot se sodijti mbë të e nëng i pā ndonjë bukurī, po ish si një i lakosëm e si një delez çë po e shpitnjin ndër kasap e çë nëng hapi gol me u rëkuem[129]. Ashtu edhe thot Jaremiu te krieja 11, thot edhe Exekje[lli] te krieja 24, Dan'jelli te krieja 13. Edhe Osea 23, Joelli 2, Amosi 2, Abdhia 1, Jona 1 [e] 2, Xakaria 11, i cili bukurë çel foli e tha se i pā këmbt e duort të dëpërtuem me lakos të idhuna ».

Këto profetī gjith e jedhe shum të tjēra qenë prej Jesu Krishtit shtjellura atire di dishipul[130], se qe nëvoj për të psūem Krishti, për të mbushëçin gjith profetīt e thoi me fjal aq t' ëmbla sa ata të di dishipul [223] po mrekullohçin. Moj kështu tue ligjërūem mberrijtin ndë kështjeltë.

Ish dielli mẽ mbë të pernduomit e Jesusi bëri kinëse[131] po të shkonej përpara, moj qe prej asi dishipuliç i ndal, tue ju luturë të buntej bashk me ta e atij i pëlqeu e ndali. Hitin pra ndë kështjel e, mbasi gjetin konak, ata të di dishipul rrijin fōrt të gëzuem pse u kishin pëjekurë mbë t' atilltë shoku. Pr' ashtu hitin m' e shërbiem e m' e përgëzuem.

Bën e gatin darkën e ndënjëtin mbë[132] tries. Jesusi muerë bukën me shënjëtet duorë të vetjiu, e bekoi, e ndajti e je dha të di dishipulvet. Atëhērë u çelëtin sītë e tire e njoftin kush ish ai e për nje si e njoftin ndreti ka sītë e tire.

---

[123] B: kryjt – S: krijtë.
[124] S pone i verbi all'imperfetto, B al presente.
[125] sherregjītë (B). S: sherrgjītë.
[126] së dashunësë (B) – S: shashure.
[127] herejet (B) – S: herejtë.
[128] fëlqinjën (B) – S: fëlshinjën.
[129] me u rëkuem. B: me u nëkuem.
[130] B aggiunge: tue ecun, tue i bam me ditunë.
[131] kinëse (B) - S: kines.
[132] mbë. Omesso da S.

Të cilën pune tue pamë, fōrt mrekullueshim mbetin. Prana si këthienë mbë vetëhēnë, njeri thoj të jetërit: "As na thoi zëmëra jonë udhës se ai ësht Mjeshtëri, kurë na kallëzōnej profetīt tue ecurë?". Nd' at koh e çast këthienë Jerësallemt.

Atje apostolit me të tjerëtë dishipul gjetin se po fllisëjin e po kuvendojn ndër vetëhē se Jesu Krishti për të njëmend ish i ngjallurë, e Sh. Thomazi, ndonse ish qënurë ndër gjith ato pune çë rrëfihçin e se [224] ju kish dukurë edhe Sh. Pjetërit, veç se atë çë thojin të di dishipulit të Emausit, si ai ju kish bẽrë shok prë ndë udhën e si e njoftin ndë konak mbë të thiemen e buks, Sh. Thomasi u ndā sish[133].

Gjith këto dëshminjenī[134] nëng qenë mejaft[135] me të bëmë me besuem të ngjallurën[136] e Jesu Krishtit. Kurë ata po mbajin diertë të mbëshellta për droe çë kishin judhinjëshit, u duk Jesu Krishti e mbet ndë mest atire gëzuem e pllot me ngushëllim e gjith i bukurë thonej: "U jamë, mos droni".

Apostolit e dishipulit çë së e kishin parë, mbasi qe ngjallurë, fōrt u mrekulluen. Ndër vetëhē kultojshin e thoin[137]: "Mos të jetë ai ndonjë frīmë o ndonjë hie?". Jesusi tha atire: "Pse drojni? Soditni duort' e këmbt' [t]ime, pse shpirti e frima nëng kā mish e nëng ësht po si shifni se jamë ure mishi e ashti. Avitmëni[138] e prekmëni. Soditëni lakomat çë kamë pasurë mbë kriqet".

Tue parë Shelbuési se ata veç se[139] ashtu drojin edhe, me faqe të gëzuem i piejti ndose kishin gjẽ prë të ngrẽnë. Ata i shpunë përpara një cop peshku me një thel mjal. Jesu Krishti hëngri përpara atire po të e shifjin se për të njëmend [225] ish i ngjallurë[140] e se nëng ish ndonjë hie. I çeli[141] ahiena mendëtë tue i dhënë drit e të[142] çel çë të mirrëjin vesh profetītë çë gjith thonë se qe nevoj çë[143] Krishti të psonej e të disij e të ngjallej e çë pr' ëmërin[144] e tij të predhikohej pendesa për të lijruemit e mbëkatëvet.

Frīti prana ndë ta tue thẽnë: "Mirrëni Shpirtin Shënjëtë e atire çë të ju rrëfienjin mbëkatët' e tire ju kini me i zgjidhurë e qofshim lijruem e ndëliem; e ata çë të mos lijroni ju, mbeçin lidhurë e pa ndëleme".

Nëng u gjet afërë shën Thomasi, kurë u duk Krishti. Cili mbasi u nda e shkoi, erth Sh. Thomasi, të cilit thanë apostolit se kishin pamë Jesu Krishtin të ngjallurë, pakuerë të bukurë e të ndriçim po si një diell e se i kish dhẽnë pushtet të madhe me zgjidhurë e me ndëlierë mbëkatat. Të cilëvet tha

---

[133] Il materiale del capoverso è diversamente disposto in B.
[134] dëshminjenī (B) - S: shëminjenī.
[135] mejaft (B) – S: majaft.
[136] ngjallurën (B) - S: ngjaturën.
[137] e thoin. Aggiunta di S – B non ha il discorso diretto.
[138] Avitmëni (S) - B: Avitëniu.
[139] se. Aggiunta di S.
[140] B: ishte ngjallurë – S: ish i gjallë.
[141] çeli (B) – S: uli.
[142] të. Omesso da S.
[143] B: qi – S: të.
[144] ëmërin. S: ijmërin.

Sh. Thomasi: "U prana ju thomë se, ndomos pāfsha me sītë time lakosat e tij e ndomos i preksha me gjishtet time e ndomos shtifsha këtë dorën time ndë lavomat të krahënorit së tij, nëng besonjë kurraj".

Ndë këso dorë ngurimi mbeti Sh. Thomasi prë tet dit, mbas të cilëvesh, tue qẽnë apostolit gjith bashk e Thomasi me [226] ta e tue qẽnë edhe diert të mbëshelta, Jesu Krishti hiri atje e mbet ndë mest atirevet, tue i falurë po si kish zakōnë: "Paqja qoftë me jū". Ahiena tue u këthiem prej Sh. Thomasit i tha: "Thomas, nje këtu[145] lavomat time te duert' e te këmbtë[146] e të krahnorit. Preki e mos bëj të pabesin, moj të bēsëmin".

Tue ndiem këto pune, Thomasi preku lavomat e, si mbet gjithsej temelitunë[147] prë të ngjallurit e Jesu Krishtit, i rā përpara këmbvet e tha: "Zoti īmë e Yji īmë! ". Të cilit Jesusi përgjegji: "Thomas, ti besove pse pē lavomat time çë të fōrcuen[148] prë të ngjāllurit tīmë. E ure[149] mbero të thomë se të lum kanë me qẽnë ata çë, pa mos më[150] pasurë pamë, kanë me më besuem", çë do me thẽnë se besa do shokruore me vepëra të mira prë të shelbuemit. Pr' ashtu tha Ghllosa 10 Heb: "Besa nëng meritōnë, ku njerī[151] kā të pamë me sī".

Shelbuési īnë Jesu Krishti, shum herë, tue lẽnë me u pamë ka shënjëtit apostul, forcoi të shënjëtin të ngjallurë të vet prë ndë katërdhjet dit çë shkuenë së ngjallurit së tij njera ndë të hipurën çë bëri ndë parrajsit[152]. Ndë të tjerat[153] kallëzōnë Sh. Gjoni, krie 20, [227] se Sh. Pjetëri, Sh. Thomasi, Sh. Jaku e vetjuj Sh. Gjoni kishin vatë me zẽnë peshq e me ta vate edhe Natanilli, bulārë i Kana Ghalillejs, me të tjerë dishipul e prë gjith një nat pat shtijin rrjetin shum herë pa zẽnë një peshk. Mbasi duell drita, panë Jesu Kris[h]tin ndaj zallit e së pari nëng e njoftin. I piejti Jesusi ndose kishin peshq. Ata thanë jo. I tha atire: "Shtīni rrjetin mb' anë të dhjathte të varks, se atje kini me gjeturë peshq".

Ashtu bẽnë e zunë aq shum, sa mxij se nxuertin rrjetin ka dejti mbrënda ndë vark[154]. Dishipuli i dashurë të Jesusit, Sh. Gjoni, tue pamë këto pune i tha Sh. Pjetërit: "Ai çë po rrī mbë zallt ësht Zoti[155]". Sh. Pjetëri, tue ndiemë kështu, u shtū[156] mbë uje e prë dashurīn' e fōrt me k' e duoj vate ka ish Jesu Krishti. Të tjetërit apostul vanë me varkën prej dheu e Krishti i lipi peshkut çë kishin zẽnë.

---

